AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

PASQYRAT FINANCIARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

PËR PERIUDHËN E PËRFUNDUAR MË 30 SHTATOR 2013

TABELAT E RAPORTEVE FINANCIARE

Raportet sipas nenit 20 të ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 20: Raportet, buxheti dhe llogaritë

Neni 20.1.1.2. pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim

29 TETOR 2013

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

PASQYRAT FINANCIARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

PËR PERIUDHËN E PËRFUNDUAR MË 30 SHTATOR 2013

TABELAT E RAPORTEVE FINANCIARE

Raportet sipas nenit 20 të ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 20: Raportet, buxheti dhe llogaritë

Neni 20.1.1.2. pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim

TABELA E PËRMBAJTJES

Nr.	Emri i raportit	Faqe
1.	Deklarata për Prezentimin e Pasqyrave Financiare	
2.	Raporti i aktiviteteve të Agjencisë Kosovare të Privatimit	1-54
3.	Pasqyra e gjendjes së llogarive bankare në BQK sipas llojit të fondeve në mirëbesim	1
4.	Pasqyra e gjendjes së llogarive dhe përmbledhja e rrjedhës së parasë së gatshme	2
5.	Pasqyra e Rrjedhës së Parasë së Gatshme për periudhën Korrik 2003 – Shtator 2013	3
6.	Pasqyra e Rrjedhës së Parasë së Gatshme për periudhën Janar – Shtator 2013	4
7.	Përmbledhje e hyrjeve dhe daljeve nga privatizimi	5
8.	Raporti i shitjeve sipas regjioneve	6
9.	Përmbledhje dhe detajet e hyrjeve dhe daljeve nga likuidimi sipas regjioneve	7
10.	Përmbledhje e pagesave për 20%-in e punëtorëve të Ndërmarrjeve Shoqërore	11
11.	Raporti i interesit të fituar në llogaritë bankare dhe numri i llogarive bankare	12

Nr.	Emri i raportit	Faqe
12.	Numri i transaksioneve për vitet e ndryshme fiskale	13
13.	Raporti PIM – Përmbledhje e Informatave për Menaxhmentin: krahasimet e vitit aktual me periudhat paraprake	15
14.	Raporti PIM – Raporti i krahasimeve vjetore	17
15.	Raporti PIM – Grafikonet e të dhënave kryesore vjetore	19
16.	Analiza e të hyrave të privatizimit sipas valëve dhe sipas statusit të kontratës	25
17.	Analiza e të hyrave të privatizimit sipas valëve dhe “spin off-it” të rregullt	27
18.	Analiza e të hyrave të privatizimit sipas valëve dhe “spin off-it” special	29
19.	Pasqyra financiare e llogarive të privatizimit	30
20.	Pasqyra financiare e llogarive të likuidimit	32
21.	Pasqyra financiare e llogarive të parave në mirëbesim të NSH-ve	35
22.	Pasqyra financiare e llogarive të komercializimit	37
23.	Pasqyra financiare e llogarive të parave në mirëbesim për 20% e punëtorëve	39
24.	Pasqyra financiare e llogarisë së depozitave (ofertuesit) të privatizimit	41
25.	Pasqyra financiare e llogarisë së tarifave (ofertuesit) të privatizimit	43
26.	Pasqyra financiare e llogarisë së depozitave (ofertuesit) të likuidimit	45
27.	Pasqyra financiare e llogarisë së tarifave (ofertuesit) të likuidimit	47
28.	Pasqyra financiare e llogarisë së ankesave në likuidim	49
29.	Pasqyra financiare e llogarisë së Kapitalit Themeltar të Agjencisë	50
30.	Pasqyra financiare e llogarisë së Fondit Rezervë të Agjencisë	51
31.	Pasqyra financiare e llogarisë së donatorit	53
32.	Pasqyra financiare e llogarisë së tarifës administrative të Agjencisë	54
33.	Pasqyra financiare e llogarive të depozitimeve kohore	55
34.	Raporti i detyrimeve	56

Nr.	Emri i raportit	Faqe
35.	Raporti i llogarive të arkëtueshme	57
36.	Raporti i detyrimeve kontigjente	64
37.	Detajet e Pasqyrës së Rrjedhës së Parasë së Gatshme për Korrik 2003 – Shtator 2013	65
38.	Detajet e Pasqyrës së Rrjedhës së Parasë së Gatshme për Janar – Shtator 2013	76
39.	Plani kontabël i fondeve në mirëbesim për vitet Korrik 2003-Shtator 2013, 2003-2012 dhe Janar – Shtator 2013	79
40.	Harmonizimi i të gjitha llogarive bankare në Bankën Qendrore të Kosovës	89-125
41.	Harmonizimi i të gjitha llogarive bankare në bankën Procredit	126-127
42.	Plani i zbatimit të rekomandimeve lidhur me Raportin e Auditimit të ZAP-së për Pasqyrat Financiare të Fondeve në Mirëbesim dhe AKP-së për Janar–Dhjetor 2012	1-7
43.	Shënimet Shpjeguese të pasqyrave financiare	1-11
44.	Rregullorja e kornizës raportuese për pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim	1-6

PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO
II
Nr. 3961
Nr. 219
Data / Datum / Date 31/10/13

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

598
31.10.13

DEKLARATË PËR PREZENTIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

Për: **Bordin e Drejtorëve, Agjencia Kosovare e Privatizimit**

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara të Fondeve në Mirëbesim, të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë edhe shënimet shpjeguese për këto pasqyra, për periudhën e përfunduar më 30 Shtator 2013 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik "Raportimi financiar sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme". Këto pasqyra financiare i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga "Rregullorja e Kornizës Raportuese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim" të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve më 23 Shkurt 2011 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezentimin e pasqyrave financiare të Fondeve në Mirëbesim për organizatën buxhetore **Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)** për periudhën e përfunduar më 30 Shtator 2013.

Ne konfirmojmë, për sa kemi njohuri dhe besim, që:

- Nuk ka pasur parregullësi lidhur me menaxhmentin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare;
- Informatat e dhëna dhe të prezentuara në pasqyrat financiare lidhur me identifikimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhur me Fondet në Mirëbesim janë të plota dhe të sakta;
- Informatat në lidhje me arkëtimin e të hyrave janë të sakta;
- Nuk ka llogari bankare që ndërlidhen me Fondet në Mirëbesim përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si më datën 30 Shtator 2013;
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullative të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare në rast se do të shkeleshin;
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare;
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose shpalosur në mënyrën e duhur;
- Të gjitha huatë për palët e jashtme janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas rrethanave;
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës raportuese i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara të Fondeve në Mirëbesim që janë të bashkangjitura paraqesin një prezentim të vërtetë dhe të drejtë të financave dhe të transaksioneve financiare të Fondeve në Mirëbesim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për periudhën e përfunduar më 30 Shtator 2013.

Në përputhje me kërkesën e Bordit të Drejtorëve, Bordit të Drejtorëve u paraqiten tabelat përmbledhëse kryesore financiare dhe shënimet shpjeguese, ndërsa detajet tjera të pasqyrave financiare gjenden në Sekretariatin Ekzekutiv të Bordit të Drejtorëve.

Shkëlzen LLUKA
Drejtor Menaxhues
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Avni J. JASHARI, CA, CFE, IS
Drejtor i Financave dhe Buxhetit
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Data: 29 Tetor 2013

RAPORT

Janar - Shtator 2013

RAPORT I AKTIVITETEVE TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

PËRMBAJTJA

I. HYRJE 3
II. NDËRMARRJET SHOQËRORE 4
III. TAKIMET E BORDIT TË DREJTORËVE....5
IV. DIVIZIONI I SHITJES....10
IV.1. DEPARTAMENTI I SHITJES 10
STATUSI I PAGESAVE 13
NËNSHKRIMI I KONTRATAVE ME BLERËSIT....13
SHITJET QË KANË NDALESA NGA DHOMA E VEÇANTË E GJYKATËS SUPREME 13
SHITJET ME PROBLEME TJERA....14
IV.2. NJËSIA PËR KONTROLLË DHE MBIKQYRJE....14
IV.3. NJËSIA E ADMINISTRIMIT DIREKT 22
V. DEPARTAMENTI PËR KOORDINIM TË LIKUDIMIT....28
NJËSIA E MONITORIMIT TË LIKUIDIMIT DHE FONDEVE TË MBETURA....28
NJËSIA E LIKUIDIMEVE NGA AKP-JA 30
NJËSIA PËR LISTAT E PUNËTORËVE PËR 20% 31
VI. NJËSIA E RIORGANIZIMIT DHE ADMINISTRIMI I NSH-VE 32
VII. DEPARTAMENTI I KOORDIMINIT RAJONAL....35
VIII. DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE BUXHETIT....37
IX. DEPARTAMENTI LIGJOR....42
X. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS 47
XI. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT....51
XII. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM....52
XIII. STRUKTRURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT....54

I. HYRJE

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr. 03/L-067) që ka hyrë në fuqi me 1 Korrik 2008 e ndryshuar me ligjin nr.04/L-034 që ka hyrë në fuqi më 21 Shtator 2011 (këtej e tutje "Ligji"). Ky ligj zbaton dispozitat përkatëse të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 Mars 2007 (Shtojca VII, Neni 2 prej saj), që është një pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Neni 145 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës).

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar si pasardhës i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) të themeluar sipas Rregullores së UNMIK-t Nr. 2002/12 "Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit" me ndryshime nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18 dhe parasheh që të gjitha asetet dhe përgjegjësit e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit për Ndërmarrjet Shoqërore transferohen tek Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit si një organ i pavarur publik kryen funksionet dhe përgjegjësitë e saj me autonomi të plotë. Agjencia posedon individualitet të plotë juridik dhe në veçanti kapacitet për të hyrë në kontrata, të siguroj, të mbaj dhe të rregulloj pronën si dhe të ketë të gjitha kompetencat e përfshira për të shkarkuar plotësisht detyrat dhe kompetencat që i janë dhënë me ligjin aktual; dhe të padit dhe të paditet në emrin e vet.

Bordi i Drejtorëve është organi më i lart i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve të AKP-së vazhdon të takohet në baza të rregullta në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij me ligjin aktual. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë prej të cilëve pesë (5) anëtarë vendor janë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe tre (3) anëtarë ndërkombëtarë të emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë në përputhje me Ligjin për Themelimin e Agjencisë.

Gjatë periudhës raportuese, aktivitetet e përgjithshme të Agjencisë janë menaxhuar nga Drejtori Menaxhues, Zëvendës Drejtori Menaxhues i Divizionit për Shitjet dhe Zëvendës Drejtori Menaxhues i Divizionit për Koordinimin e Likuidimit. Agjencia ka departamentet në vijim:

- Departamenti i Financave dhe Buxhetit;
- Departamenti i Koordinimit Rajonal;
- Departamenti i Shitjes;
- Departmanenti për Koordinim të Likuidimit;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti i Administratës; dhe
- Departamentin e Prokurimit.

Agjencia e ka të themeluar edhe Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe Sekretarinë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve. Agjencia ka zyrën qendrore në Prishtinë. Ka pesë (5) zyra rajonale (Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan) dhe tre (3) zyra satelitore (Graçanicë, Shtërpce dhe Leposaviq).

Struktura organizative e Agjencisë është paraqitur në fund të raportit të aktiviteteve.

II. NDËRMARRJET SHOQËRORE

Rreth 599 kompani në Kosovë janë identifikuar potencialisht si Ndërmarrje Shoqërore (NSH).

Sektori i NSH-ve ka punësuar 20,000 punëtorë, përderisa numri i njerëzve në listat e punëtorëve arrin 60.000 (për shembull 40.000 janë në pushim pa pagesë). NSH-të kanë funksionuar në sektorë të ndryshme duke përfshirë përpunimin e metalit, plastikës, letrës, hotele, miniera, agro-industri, bujqësi, pylltari, material ndërtimor, ndërtimtari, tekstil, verari dhe vreshtari, prodhimin e birrës, duhanit, shitjen me shumicë dhe pakicë.

Është vlerësuar që NSH-të zënë rreth 90% të industrisë dhe minierës në Kosovës, 50% të hapësirës për shitje komerciale me pakicë dhe më pak se 20% të tokës bujqësore duke përfshirë tërë tokën komerciale bujqësore dhe shumicën e pjesës malore të Kosovës.

Shumica e pronës industriale të Kosovës, tokës bujqësore, pyjet, tokës urbane komerciale dhe pronës komerciale janë pronë e NSH-së. Privatizimi i këtyre aseteve dhe tërheqjen e investitorëve të huaj dhe atyre nga Diaspora dhe rajoni, Kosova pritet që të kenë ndikim pozitiv në ekonominë dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

AKP-ja vazhdon me Privatizim nëpërmjet dy metodave:

“Spin-Of”- Asetet dhe numri i kufizuar i përgjegjësive të NSH-së barten tek shoqëritë e porsaformuara aksionare (“Ndër.e Re”) me aksionet e ndërmarrjeve të reja të tenderuara për shitje investitorëve privat. Detyrimet e mbetura dhe punëtorët mbesin me NSH.

“Likuidimi Vullnetar”- Asetet e NSH-ve do të likuidohen sipas ligjit dhe politikave operacionale të Agjencisë.

III. TAKIMET E BORDIT TË DREJTORËVE

Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve që nga themelimi i Agjencisë janë mbajtur si më poshtë:

1. në vitin 2008 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur gjashtë (6) takime;
2. në vitin 2009 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur njëmbëdhjetë (11) takime;
3. në vitin 2010 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur dymbëdhjetë (12) takime;
4. në vitin 2011 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur njëmbëdhjetë (11) takime;
5. në vitin 2012 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur gjithsejtë tetë (8) takime; dhe
6. në periudhën Janar – Shtator 2013 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur gjithsej tetë (8) takime të rregullta;

Në muajin Korrik 2013 Bordi i Drejtorëve ka aprovuar Raportin Vjetor për vitin 2012. Agjencia ka dorëzuar Raportin Vjetor në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe e ka vendosur në faqen e saj elektronike internetit.

Kuvendi i Kosovës ka emëruar pesë anëtarë të rinj të Bordit të Drejtorëve me 21 Shkurt 2013 dhe me këtë është plotësuar zbrazëtira institucionale që ka zgjatur shtatë (7) muaj.

Takimi i pesëdhjetë (50) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur më 28 Shkurt 2013. Në këtë takim Bordi i Drejtorëve ka mbajt një takim njoftues të anëtarëve te Bordit në përbërjen e re si dhe me qëllim njoftimin e Menaxhmentit dhe punëve në Agjenci.

Takimi i pesëdhjetë e një (51) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur më 21 dhe 22 Mars 2013. Në këtë takim Bordi ka marr vendim për konfirmim të mandatit të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë dhe poashtu njëri nga anëtarët e Bordit është zgjedhur Zëvendës Kryesues.

Bordi gjithashtu mori vendim për shpërndarjen e parakohshme të 20% për punëtorët me të drejtë legjitime të 21 N.SH.-ve, si në vijim:

1. NSH “Mekanizimi”- Prishtinë, ZR Prishtinë;
2. NSH Fabrika e Ngjyrave dhe Llaqeve “Extra” – Vushtrri, ZR Mitrovicë;
3. NSH “Jugobanka” – Mitrovicë, ZR Mitrovicë;
4. NSH KB “Ujmiri” – Ujmir, Klinë, ZR Pejë;
5. NSH ”Tregjet” – Pejë, ZR Pejë;
6. NSH KB “Moronica” – Junik, ZR Pejë;
7. NSH “Gurrakoc” – Istog, Pejë;
8. NSH “Marketing Export” – Prishtinë, ZR Prishtinë;
9. NSH KB “Sharrprodhimi” – Dragash, ZR Prizren;
10. NSH KB “Rakoshi” në Rakosh-Istog, ZR Pejë;
11. NSH KB “Shtime” – Shtime, ZR Prishtinë;
12. NSH “Podrima”- Rahovec, ZR Prizren;
13. NSH “Liria”- Budisalc, Klinë, ZR Pejë;
14. NSH KB “Kooperimi” – Suharekë, ZR Prizren;
15. NSH “Agrodukagjini” – ZR Pejë;
16. NSH Fabrika e Radiatorëve “Jugoterm” – ZR Gjilan;
17. NSH “Qumështorja Konsume” – Fushë Kosovë, ZR Prishtinë;
18. NSH Uzina e Përpunimit të Kromit “Deva” – Gjakovë, Pejë;
19. NSH “Gjeravica” – Deçan, ZR Pejë;

20. NSH "Fabrika e Letrës" – Lipjan, ZR Prishtinë; dhe
21. NSH "Prodhimtaria Bimore" – Irzniq, ZR Pejë;

Bordi ka formuar katër Komisione gjatë kësaj mbledhje, siç janë:

i) Komisioni për Terma të Referencës dhe nominim të Drejtorit të Trepçës;
ii) Komisioni Drejtues i Kontratës për Autoritet të Likuidimit;
iii) Komisioni për Hapjen dhe Komisionit për Pranimin e Ofertave në Ditët e Shitjeve; dhe
iv) Komisioni Vlerësues për Regjistrimin e Ofertuesve të Kualifikuar.

Në këtë takim Bordi ka vendos për lejimin e shitjes së koncentratit për vitin 2012 dhe vitin 2013 dhe për rritje të pagave për 5% të minatorëve minierës së Stan Tërgut. Gjate këtij takimi Bordi ka aprovuar transaksionet e Valës 56 të privatizimit, Shitjeve përmes Likuidimit 16, 17 dhe 18 dhe transaksionet e projekteve individuale Ndër. e Re Onix Banja e Pejës – Ilixhe Shëndetësore sh.p.k. dhe Ndër. e Re FBI Trepça Sh.P.K. Bordi ka miratuar Valët 57 dhe 58 të privatizimit.

Po ashtu në këtë takim janë liruar nga kushtet e marrëveshjes së zotimeve dy ndërmarrje siç janë:

1. Ndër. e Re Minex; dhe
2. Ndër. e Re Iliria/Sëiss Diamond Hotel.

Në periudhën ndërmjet mbledhjes së 21/22 Marsit 2013 dhe mbledhjes së 11/12 prillit 2013 nëpërmes formës së votimit me shkrim Bordi me datë 05 Prill 2013 ka vendos që të miratoj kërkesën për shtyrjen e afatit të përmbushjes së obligimeve Kontraktuale për angazhimin e Ofruesit të Shërbimeve për Likuidimin e Portfolios të Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës sipas kontratës Nr. 239/11/068/211, respektivisht Planin e Azhurnuar të Kontraktorit Deloitte – Tashko Pustina.

Takimi i pesëdhjetë e dytë (52) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur më 11 dhe 12 Prill 2013. Në këtë takim Bordi themeloi Komisionin për Ofrues të Shërbimeve Profesionale për Procesin e Riorganizimit të Trepçës dhe poashtu miratoi disa propozime për qiradhënie për disa asete të Trepçës.
Vendim tjetër ne këtë takim nga ana e Bordit ishte vendimi që ish komercializuesit të NSH FAPOL t'ia njoh të drejtën e parablerjes në bazë të raportit të auditimit. Gjithashtu u aprovuan pesë Raportet e radhës të Komisionit për Shitjen e Banesave në pronësi të NSH-ve.
Ndërsa vendim tjetër ishte për shpërndarjen e përkohshme të 20% për punëtorët me drejtë legjitime të 2 N.SH.-ve si në vijim:

1. NSH "Termovent" – Lipjan; dhe
2. NSH "Kluz" – Drenas.

Në po këtë takim Bordi poashtu miratoi MoU Agjencisë dhe Agjencisë Pyjore të Kosovës lidhur me shfrytëzimin e tokës pyjore e cila është e evidentuar si pronë shoqërore nga ana e Kompanisë "Kosovo Metals Group" J.S.C. Bordi poashtu ka miratuar qiradhënien e aseteve të caktuara të disa NSH-ve. Sa i përket Administrimit Direkt (AD) në këtë takim Bordi ka larguar nga AD NSH Emin Duraku, ndërsa ka emëruar Bordet Menaxhuese për ndërmarrjet XIM Strezovc dhe Fapol. Ndër të tjera u miratua edhe Rregullorja për përdorimin të vulave zyrtare të Agjencisë dhe Autorizimi për lejimin e përdorimit të vulave zyrtare të Agjencisë nga Autoriteti i Likuidimit.

Sa i përket Auditimit të Brendshëm u miratuan këto dokumente:

i) Amandamentimi i Statutit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB);
ii) Strategjia e NJAB-it për vitet 2013-2015;

iii) Plani i Punës së NJAB-it për vitin 2013; dhe
iv) u bë plotësimi i Komitetit të Auditimit me një anëtar.

Si pikë e veçantë e agjendës u bë edhe miratimi i transaksionit të Ndër e re Rilindja Zona Industriale sh.p.k. (Vala 56 e privatizimit).

Në periudhën ndërmjet mbledhjes së Prillit dhe Majit kanë dhënë dorëheqje Kryesuesi i Bordit Prof. Dr. Blerim Rexha dhe anëtaret e Bordit znj. Dardane Peja dhe znj. Bernadette Roberts. Pavarësisht nga kjo Bordi ka mbajtur kuorumin minimal per të mbajt mbledhje dhe të marr vendime, përveç disa vendimeve që ndërlidhen me votat e tre anëtarëve ndërkombëtarë sipas nenit 14.7 të Ligjit të AKP-së.

Në të njëjtën periudhë ndërmjet mbledhjes së 11/12 Prillit 2013 dhe mbledhjes së 23/24 Majit 2013 nëpërmes formës së votimit me shkrim Bordi me datë 20 Maj 2013 ka vendos që të miratoj propozimin për zëvendësimin anëtarëve të Komisionit vlerësues për regjistrimin e ofertuesve të kualifikuar. Kjo çështje ishte aprovuar në mbledhjen Bordit (21/22 Mars 2013) mirëpo për shkak të urgjencës së çështjes që doli si rezultata i disa ndodhive te paparashikuara në Agjenci dhe pasi që Komisioni humbi përbërjen e plote ndërsa duhej të fillonte punën menjëherë pas afatit për parakualifikim (Valët 57 dhe 58 të privatizimit)), që në këtë rast ishte 22 maj 2013 dhe nuk mund të pritej mbledhja e Bordit, sepse dita e ofertimit ishte caktuar për datë 29 Maj 2012.

Takimi i pesëdhjetë e tretë (53) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur më 23 dhe 24 Maj 2013. Në mungesë të Kryesuesit Bordi në këtë takim fillimisht në këtë takim Bordi autorizoi Zëvendës Kryesuesin që të nënshkruaj dokumentet në vijim: kontratat e shitjes, Raportin Vjetor të 2012-të, MoU me Administratën Tatimore të Kosovës (kur të miratohet). Sa i përket çështjeve të Trepçës Bordi aprovoi kërkesën e Trepçës Veri për shitjen e koncentratit për vitin 2013 dhe poashtu u miratua kërkesa e kompanisë KMG për përpunim të xehes. Në këtë takim Bordi miratoi Raportin Vjetor të Punës për vitin 2012. U miratuan poashtu edhe transaksionet e Shitjes përmes Likuidimit 19. Bordi mori vendim që të amadamentoj Udhëzuesin e Likuidimit, respektivisht të shtoj Aneksin për trajtim të kërkesave kolektive në procedurën e likuidimit. Pastaj u miratua edhe propozimi që 39 ndërmarrje të fillojnë procedurën e likuidimit. Ndërsa sa i përket AD-së Bordi emëroi Bordin Menaxhues për Hotelin Grand Prishtinë dhe largoi N.Sh Banja e Pejës Ilixhe nga AD dhe poashtu miratoi Rregulloren për përcaktimin e mënyrave të kompensimit për menaxherët si dhe punëtorët tjerë të NSH-ve nën mandatin e Njësisë së AD.

Në periudhën ndërmjet mbledhjes së 23/24 Majit 2013 dhe mbledhjes së 27 Qershorit 2013 nëpërmes formës së votimit me shkrim Bordi me datë 06 Qershor 2013 ka vendos që të miratoj kërkesën për futjen në Administrimin Direkt të AKP-së NSH ”Fapol” Podujevë.

Takimi i pesëdhjetë e katërtë (54) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur më 27 Qershor 2013. Në këtë takim Komiteti i Auditimit është plotësuar me dy anëtar dhe kjo si nevojë pas dorëheqjes së një anëtareje të Bordit/njëkohësisht anëtar Komiteti dhe një përfaqësuesi i Menaxhmentit anëtar Komiteti. Gjat kesaj mbledhje Bordi ka marr vendim që të rris shpenzimet që i ndahen BSPK-së në bazë të MoU në mes tyre dhe Agjencisë. Sa i përket çështjeve të Trepçës Bordi me urdhër të DhPGjS-së ka plotësuar Komisionin e Trepcës për tenderin për ekspert për TeR për mënyrën e shitjes së mbeturinave dhe për rehabilitim të deponive. Poashtu Bordi ka miratuar disa kërkesa të Trepcës Jug dhe asaj Veri dhe ka vazhduar disa kontrata. Janë miratuar transaksionet e Valës 57 dhe 58 të privatizimit. Në këtë takim Bordi ka miratuat Planin e Punës të Agjencisë 2013 deri 2015. Në po kete takim Bordi mori vendim për aprovimin e listave përfundimtare të 20% për punëtorët për 5 N.SH.-ve si në vijim:

1. NSH KB “Rugova” – Drelaj, ZR Pejë;

2. NSH "Zhupa" – Reqan, ZR Prizren;
3. NSH "Përparimi" – Podujevë, ZR Prishtinë;
4. NSH "Fonderia-Metaliku Emajl", Gjakovë, ZR Pejë; dhe
5. NSH "Ereniku – Industria, Fabrika e Lëngjeve" – Gjakovë, ZR – Pejë.

Gjithashtu Në këtë takim Bordi ka miratuar Buxhetin Vjetor për Vitin 2014. Sa i përket Administrimit Direkt, Bordi në këtë mbledhje largoi nga AD NSH Unimont. Gjatë këtij takimi Bordi themeloi Komisionin për ndërtime ilegale në pronat e NSH-ve. Bordi poashtu ka miratuar qiradhënien e aseteve të caktuara të disa NSH-ve. Poashtu u miratua edhe propozimi që 60 ndërmarrje të fillojnë procedurën e likuidimit.

Në periudhën ndërmjet mbledhjes së 27 Qershorit 2013 dhe mbledhjes së 18 Korrikut 2013 nëpërmes formës së votimit me shkrim Bordi me datë 12 Korrikut 2013 ka vendos që të miratoj kërkesën për aprovimin e buxhetit për pagesën e një pjese për vitin 2012 dhe vitin 2013 për anëtarët ndërkombëtar të Bordit të Drejtorëve.

Takimi i pesëdhjetë e pestë (55) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur më 18 Korrik 2013. Në këtë takim Bordi vendosi që të jap pëlqimin që ndërmarrja Sharrcem të bëj eksplorimin e xehes se mergeles në një pjesë të pronës të regjistruar në emër të Ekonomisë Pyjore. Sa i përket Trepçës Bordi e ka miratuar kërkesën për transport të punëtorëve të Stantërgut. Në këtë mbledhje Bordi ka miratuar transaksionet e Shitjes përmes Likuidimit 21 dhe poashtu ka miratuar Valën 59 të privatizimit. Eshte miratuar edhe vendimi për aprovimin e listës përfundimtare të 20% për punëtorët për N.SH.-në si në vijim:

i. NSH "Industria e Baterive IBG" – Gjilan, ZR, Gjilan.

Gjithashtu Në këtë takim Bordi miratoi Rregulloren e Brendshme për Rekrutim të Drejtorit Menaxhues, dy Zëvendës Drejtorëve Menaxhues dhe Drejtorit të Sekretarisë së Bordit dhe poashtu Rregulloren e Brendshme për Zhvillim të Punonjësve dhe ngritje të kapacitetit. Në këtë takim Bordi poashtu ka diskutuar kërkesën ë RTV21 për koncesion apo qiradhënie afatgjatë për lokalet e NSH "Rilindja Shtypshkronja" – PRN075. Në po të njëjtin takim u miratua Rregullorja e brendshme për sistematizimin e vendeve të punës dhe aprovimi pagave rregullores se pagave për punëtorët e NSH "Fapol" Podujevë.

Takimi i pesëdhjetë e gjashtë (56) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur më 29 Gusht 2013. Sa i përket çështjeve të Trepçës në bazë të urdhrit të DhPGjs-së dhe me propozim të Menaxhmentit Bordi miratoi Udhëzuesin e Prokurimit për Trepçën dhe themeloi Komisionin e Ankesave të Operatorëve Ekonomik ofertues në ndërmarrjen Trepça. Në këtë takim u miratua propozimi për investime të depozitave të fondit në mirëbesim në bankat komerciale.

Gjatë takimit janë tërhequr nga AD ndermarrjet:

1. NSH Lavërtaria-Blegtoria, Prizren;
2. NSH Vreshtaria – Prizren; dhe
3. NSH Kosovarja-Artizanati, Prishtinë.

Gjatë këtij takimi është miratuar Raporti i radhës i Komisionit për shitjen e banesave të NSH-ve. Ndër të tjera në këtë takim u amadmentuan Rregullat e Tenderit në privatizim dhe ato në likuidim. Poashtu sa i përket akteve nënligjorë në këtë takim u miratuan Rregullorja për procedurat dhe masat e nevojshme për sigurinë e personave që hyjnë dhe dalin në Agjenci dhe Rregullorja e brendshme të Agjencisë për Vlerësim të Performancës së Menaxhmentit.

Gjithashtu u amadamentua Rregullorja për përdorim të vulave zyrtare të Agjencisë dhe Autorizimit për lejimin e përdorimit të vulave zyrtare të Agjencisë nga Autoriteti i Likuidimit si dhe u morr vendim për aprovimin e listës përfundimtare të 20% për punëtorët për N.SH.-në si në vijim:

i. NSH Enti për Medicinë dhe Rehabilitim "Banja e Pejës" – Istog, ZR Pejë.

Në po këtë takim Bordi mori vendim që të amadamentoj politikën mbi pagesën e pjesshme për punëtorët, rrjedhimisht që punëtorët të paguhen 95% të shumës së 20% deri në pritje të vendimit final të DhPGjS-së dhe ky vendim ka fuqi retroaktive. Gjithashtu është amadamentuar Udhëzuesi i Likuidimit në disa pjesë.

Takimi i pesëdhjetë e shtatë (57) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur më 27 Shtator 2013. Sa i përket çështjeve të Trepçës, Bordi në këtë takim vendosi që miratoj TeR për Ofrues të Shërbimeve Profesionale për Riorganizim të Trepçës dhe udhëzoi Menaxhmentin që të ndërmerr hapat e nevojshëm që të filloj procedurën e angazhimit të OSHP-së. Bordi poashtu miratoi kërkesën e Trepçës për lejim të furnizimit me mjete mbrojtëse në punë dhe derivate të naftës. Gjate takimit u miratuan transaksionet e Shitjes përmes Likuidimit 21. Ndërmarrja XIM Strezovc u largua nga Administrimi Direkt dhe njëkohësisht Bordi vendosi që të filloj procedurat për likuidimin e kësaj ndërmarrje. U mori vendim edhe për aprovimin e listës përfundimtare të 20% për punëtorët për N.SH.-në si në vijim:

i. NSH "FBI Trepça" – Fabrika e Baterive Industriale – Pejë.

Në këtë takim Shpella e Mermertë Gadime u lirua nga autorizimet administrative të Agjencisë. Bordi poashtu ka miratuar qiradhënien e aseteve të caktuara të disa NSH-ve. Në propozimi për Riorganizim të kompetencës territoriale te zyrave rajonale ne kuadër te Agjencisë është miratuar gjithashtu . Pas disa muaj negociatash, Bordi poashtu miratoi MoU-në me Administratën Tatimore të Kosovës lidhur me barrët tatimore të vendosura në asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore. Gjate takimit poashtu u morr vendim që të amadamentohet Rregullorja e Brendshme për pagesën e anëtarëve të Bordit, respektivisht të shtohet pjesa që do të merrej me pagesën e anëtarëve ndërkombëtar të Bordit. Përveç tjerash në këtë takim u morr vendim që të bëhen ndryshimet e nevojshme të buxhetit të likuidimit të 12 ndërmarrjeve, si në vijim:

1. MIT015 NSH EXTRA Vushtrri;
2. MIT016 NSH Betonjerka Mitrovicë;
3. MIT019 NSH Kosova Ndërtimore Vushtrri;
4. MIT039 NShT LUX Mitrovicë;
5. MIT042 NSH Çyçavica Vushtrri;
6. MIT044 NSH Transkosova Mitrovicë;
7. MIT101 NSH Jugobanka Mitrovicë;
8. PEJ089 Zastava Ramiz Sadiku Pejë;
9. PRZ002 NSH "Kosovavera" Krusha e Vogël;
10. PRZ014 NSH "Ballkan" në likuidim;
11. PRZ0018 NSH "UNIMONT" Prizren; dhe
12. PRZ026 NSH "Farmakos" Prizren

IV. DIVIZIONI I SHITJES

Aktivitetet e Divizionit të Shitjes shtrihen në fushën e organizimit siç janë:

1. valëve të privatizimit, shitjen e aseteve me likuidim;
2. realizimin e administrimit direkt, vendosja nën kontrollë dhe mbikqyrje të ndërmarrjeve të komercializuara apo me kushte; dhe
3. organizimi i publikimeve, marketingut dhe vendosja e marrëdhënieve të mira me investitorë.

Rrjedhimisht Departamenti i Shitjes dhe Njësia e Administrimit Direkt, Njësia për Kontrollë dhe Mbikqyrje dhe Njësia për Marrëdhënie me Investitorë i raportojnë drejtpërdrejt Zëvendës Drejtoreshës Menaxhuese të AKP-së e cila është përgjegjëse për menaxhimin e ndërmarrjeve nën autoritetin administrativ të Agjencisë.

IV.1. DEPARTAMENTI I SHITJES

Privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) do të ketë ndikim të madh pozitiv në komunat e Kosovës nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë duke mundësuar rritjen dhe zhvillimin e sektorit privat. E rëndësishme është që ky proces të kryhet sa më shpejtë në mënyrë të drejtë dhe transparente dhe në përputhje me ligjin.

Departamenti i Shitjes përbëhet nga:
1. Njësia për Përgatitjen dhe Përmbylljen e Shitjes;
2. Njësia e Shqyrtimit të Dokumenteve të Shitjes; dhe
3. Njësia e Kadastrit.

Departamenti i Shitjes është përgjegjës për procesin e privatizimit dhe shitjes së Aseteve të NSH-ve përmes Likuidimit.
Qëllimi i Agjencisë është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore nëpërmjet mënyrave të cekura më poshtë:

“Spin-Of” - Asetet dhe një numër i kufizuar i detyrimeve të NSH-së barten tek shoqëritë e porsaformuara aksionare (Ndërmarrja e Re) me aksionet e Ndërmarrjes së Re dhe më pas tenderohen për shitje investitorëve privat. Detyrimet ndaj kreditorëve potencial mbesin obligime të Ndërmarrjeve Shoqërore dhe këto çështje zgjidhen me procesin e likuidimit.

“Likuidimi Vullnetar” do të mundësoj :

a) shitjen e aseteve që nuk janë shitur nëpërmjet privatizimit; dhe
b) shqyrtimin e ankesave të kreditorëve dhe shpërndarjen e fondeve të realizuara në përputhje me prioritetet e parapara me ligj.

Asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore do të likuidohen nëpërmjet procesit transparent të likuidimit.
Gjatë periudhës raportuese janë publikuar Valët 57 dhe 58 të privatizimit. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe AKP ka publikuar Shitjet e Aseteve nëpërmjet Likuidimit 19, 20 dhe 21.

Valët e privatizimit nëpërmjet Spin-ofit gjatë periudhës Janar deri në Shtator 2013 janë të paraqitura në tabelën më poshtë*:*

** Me konsolidimin e Bordit të Drejtorëve në Shkurt të vitit 2013, Vala 56 dhe dy Projekte Individuale janë të përfshira në tabelë. Dita e shitjes për këto ndërmarrje ka qenë në vitin 2012, por aprovimi nga Bordi i AKP-së dhe të gjitha procedurat tjera janë kryer në vitin 2013.*

Vala	**Data e Shitjes**	**Nr i Ndër.të Reja**	**Nr. i Ofertave të Pranuara**	**Gjithsej Vlera e Ofertave [EUR]**	**Tërheqjet, Anulimet [EUR]**	**Gjithsej Vlera [EUR]**	**Nr. i Ndër. të Reja të anuluara nga BiD, tërheqjet**	**Shitjet e realizuara**	**Shitjet e parealizuara – të mbetura**
Projektet individuale*	20 korrik 2012	02	03	8,135,000	-	8,135,000	-	2	-
56*	19 Shator 2012	34	137	13,993,949	5,797,953	8,195,996	20	13	1
57	29 Maj 2013	31	79	9,506,340	7,558,939	1,947,401	21	10	-
58	29 Maj 2013	23	54	5,188,345	3,763,355	1,424,990	18	5	-
Gjithsej	**4 valë**	**90**	**273**	**36,823,634**	**17,120,247**	**19,703,387**	**59**	**30**	**1**

Shitjet nëpërmjet likuidimit gjatë periudhës Janar deri në Shtator 2013 janë paraqitur në tabelën më poshtë:

**** Me konsolidimin e Bordit të Drejtorëve në Shkurt të vitit 2013, Shitja e Aseteve 16, 17 dhe 18 është e përfshirë në tabelë. Dita e shitjes për këto ndërmarrje ka qenë në vitin 2012, por aprovimi nga Bordi i AKP-së dhe të gjitha procedurat tjera janë kryer në vitin 2013.***
**** Shitja e Aseteve përmes Likuidimit 21 nuk është e përfshirë tërësisht, pasi që procedurat e kësaj vale kanë filluar në Tetor 2013.***

Shitja përmes Likuidimit	**Data e Shitjes**	**Nr i Asetev e**	**Nr. i Ofertave të Pranuar a**	**Gjithsej Vlera e Ofertave EUR**	**Tërheqjet, Anulimet EUR**	**Gjithsej Vlera EUR**	**Nr. i Aseteve të anuluara nga BiD, tërheqjet**	**Shitjet e realizu ara**	**Shitjet e pareali zuara – në proces**
16*	19 Shtator 2012	36	84	2,676,146	1,332,011	1,344,135	21	15	-
17*	17 Tetor 2012	62	104	5,563,768	3,665,936	1,897,832	40	22	-
18*	05 Dhjetor 2012	49	73	3,003,813	248,050	2,755,763	26	23	-
19	24 Prill 2013	30	83	5,402,469	2,169,882	3,232,587	11	18	1
20	03 Korrik 2013	74	120	2,623,291	666,184	1,957,107	41	33	-
21*	10 Shtator 2013	47	94	4,532,927	-	-	-	-	
Gjithsej	**6 valë**	**298**	**558**	**23,802,414**	**8,082,063**	**1,187,424**	**139**	**111**	**1**

STATUSI I PAGESAVE

- Nga "Fituesit e Përkohshëm" për Valën 56 vetëm për Ndërmarrjen e Re "Bankkos" Ferizaj, nuk ka përfunduar pagesa sepse ka pasur vonesa në verifikimin e historikut të blerësit të përkohshëm.
- Nga "Fituesit e Përkohshëm" për Projektet Individuale, Valët e Privatizimit 57 dhe 58 janë kryer të gjitha pagesat.
- Për shitjen e aseteve përmes likuidimit 16, kanë përfunduar të gjitha pagesat, por për Njësitë 13 dhe 35 nuk kanë përfunduar kontratat për shkak të vonesave në verifikimin e historikut të blerësit të përkohshëm.
- Në shitjen e aseteve përmes likuidimit 17 janë në proces të pagesave edhe dy Njësi:
    1. Njësia 38: Pagesa e 75 % deri me 29 tetor 2013.
    2. Njësia 55: Pagesa e 75 % deri me 11 tetor 2013
- Në shitjen e aseteve përmes likuidimit 18 kanë përfunduar të gjitha pagesat.
- Në shitjen e aseteve përmes likuidimit 19 është në proces vetëm një Njësi:
    1. Njësia 30 – blerësi i përkohshëm në verifikim historiku.
- Në shitjen e aseteve përmes likuidimit 20, janë në proces vetëm dy Njësi:
    1. Njësia 61 – pagesa e 75 % deri më 18 tetor 2013,
    2. Njësia 12 – blerësi ka paguar 100 % dhe ka kryer verifikimin e historikut por para dorëzimit të kontratës ka ardhur masë e përkohshme ndalese nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme.
- Shitja e aseteve përmes likuidimit 21 – Afati për të gjitha asetet është 30 tetor 2013 për pagesën e 25 % të shumës së blerjes dhe për verifikim historiku për blerësit e përkohshëm.

NËNSHKRIMI I KONTRATAVE ME BLERËSIT

- Gjatë periudhës Janar - Shtator 2013 janë nënshkruar dhe dorëzuar tek blerësit gjithsej 79 Kontrata (Likuidim 63, Spin-Off 16).
- Edhe një numër i konsiderueshëm i kontratave janë para përfundimit dhe dorëzimit.

SHITJET QË KANË NDALESA NGA DHOMA E VEÇANTË E GJYKATËS SUPREME

Për katër (4) shitje kemi ndalesa nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme dhe derisa nuk hiqen këto ndalesa nuk mund të vazhdohet me shitjen.

Ndalesat vlejnë për ndërmarrjet në vijim:

1. Ndërmarrja e Re "Farmakos Blue Factory Sh.P.K." – Vala 2;
2. Ndërmarrja e Re "AGROKOSOVA – Zyret Sh.P.K." – Vala 37;
3. Ndërmarrja e Re "KB Shtime Zyra Administrative Sh.P.K." – Vala 42; dhe
4. Ndërmarrja se Re "Punëtoria Iliria Sh.P.K." – Vala 43.

SHITJET ME PROBLEME TJERA

Një shitje është me probleme dhe kontrata nuk është kryer akoma:

1. **Ndërmarrja e Re "Kooperimi Toka Bujqësore Treboviq Sh.P.K."-Vala 42** – prona ka mbetur në emër të Institutit Bioteknik në Pejë, për shkak të mos azhurnimeve në komunën e Pejës.

*****Blerësit iu kanë kthyer mjetet deri ne vendimin e ardhshëm të Gjykatës.

IV.2. NJËSIA PËR KONTROLLË DHE MBIKQYRJE

Ky Raport përfshin aktivitetet Njësisë për kontroll dhe mbikëqyrje – Divizioni i Shitjes për periudhën nga 1 Janar 2013 deri 30 Shtator 2013.

Detyrat kryesore të Njësisë së Kontrollit dhe Mbikëqyrjes është mbledhja dhe sistematizimi i raporteve financiare nga Ndërmarrjet Shoqërore (NSH) që administrohen nga AKP si dhe sistematizimin, grumbullimin dhe krahasimin e raporteve financiare në mënyrë që të ruhet vlera e NSh-ve, të rritet vlera dhe për të ndërmarrë masa në kohën e duhur në rastet kur prona mundë të keq menaxhohet. Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes përgatitë dhe ekzekuton transferimin e detyrimeve nga NSh-të tek blerësit e këtyre ndërmarrjeve në pajtim me Politikat Operacionale të AKP-së.

Gjithashtu Njësia për kontroll dhe mbikëqyrje ka për detyrë që të monitorojë përmbushjen e kushteve, përfshirë pagesën e qirasë që kanë të bëjnë me Kontratat e Koncesionit të nënshkruara në mes të UNMIK-ut dhe Departamentit për Tregti dhe Industri për ndërmarrjet që iu nënshtrohen komercializimit, si dhe monitorimin e përmbushjes së zotimeve për investime kapitale, zotimit për punësim dhe vazhdim të aktivitetit të biznesit, sipas Marrëveshjes për Zotime për ndërmarrjet e privatizuara përmes metodës së Spin Off-it Special dhe Spin Off-et me kushte.

Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje bazuar në planin e biznesit për 2013 ka përcaktuar prioritetet e veta që kanë qenë si në vijim:

- Mbledhjen dhe analizimin e raporteve financiare të NSh-ve të kryera nga zyrtarët tanë për kontroll dhe mbikëqyrje në rajon dhe koordinimin e aktiviteteve me zyrtarët për objektivat e përbashkëta, vizitat në zyrat rajonale dhe NSh-të me qëllim të verifikimit të informatave lidhur me pronën e këtyre ndërmarrjeve, ruajtjen dhe rritjen e vlerës së pronës, si dhe identifikimin e rasteve ku keq menaxhimi i kësaj prone mund të ndodhë.
- Transferimi i detyrimeve të NSh-ve tek blerësit që i përkasin 12 muajve të fundit ose 3 muajve të fundit në varësi nga lloji i obligimeve që transferohen.

- Vizitat dhe kontaktet me institucionet tjera relevante në mënyrë që të kemi një komunikim më të mirë institucionet e interesit të përbashkët si dhe koordinimin e aktiviteteve me njësitë përkatëse përbrenda njësisë së Qeverisjes së Korporatave dhe departamenteve tjera brenda AKP.

Aktivitete tjera të veçanta lidhur me arritjen e objektivave të Departamentit dhe Agjencisë në tërësi.

Më poshtë është pasqyruar në mënyrë tabelore përshkrimi i aktiviteteve të arritura të njësisë për kontroll dhe mbikëqyrje për periudhën raportuese 1 Janar deri 30 Shtator 2013:

Tabela e aktiviteteve kryesore

Aktivitetet	Të arriturat gjate periudhës raportuese
Raportet Financiare të Pranuara nga NSh-të	67
Transferimi i detyrimeve të NSh-ve tek	15

Tabela e aktiviteteve tjera

Aktivitetet e tjera	**Të arriturat gjatë periudhës raportuese**
Takime me institucionet tjera	4
Njoftimet mbi detyrimet e dorëzuara tek institucionet e tjera	18
Takime me menaxhmentin e NSh - ve	5
Totali	**27**

Njësia për kontroll dhe mbikëqyrje siç u tha edhe me lartë bën edhe monitorimin e ndërmarrjeve te komercializuara , ndërmarrjeve te privatizuara me spin off special dhe ndërmarrjeve te privatizuara me kushte .Në vazhdim po paraqesim raportin mbi ndërmarrjet qe janë nën monitorim te NJKM.

Spin off-et Speciale

Që nga fillimi i procesit të privatizimit në Kosovë, e deri më tani janë privatizuar 26 ndërmarrje përmes metodës së Spin Off-it Special. Në anën tjetër 6 ndërmarrje te privatizuari me metodën e Spin Off-e Speciale kanë qenë në monitorim gjatë vitit 2013 prej të cilave dy ndërmarrje për shkak të plotësimit të kushteve të parapara me marrëveshjen e zotimeve janë liruar nga raportimi (Hotel Iliria dhe Minex) kurse

gjatë periudhës kohore Janar – 30 Shtator 2013, 4 ndërmarrje kanë vazhduar të jenë aktive, respektivisht në proces të përmbushjes së kushteve të Marrëveshjes për Zotime.

Më poshtë janë të listuara NSh-të e privatizuara përmes metodës së Spin Off-it Special të cilat kanë qenë në procesin e monitorimit gjatë periudhës Janar – 30 Shtator 2013:

- Hotel Iliria
- IDGJ Tobacco
- NBI Suhareka (Agrokosova Holding)
- MIM Golesh
- Minex
- Jugoterm

Ndërmarrjet e Reja "Hotel Iliria", dhe "Minex", Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje ka përgatitur Memorandumin për lirim në bazë të nenit 7.1.1 të Kushteve të Marrëveshjes së Zotimit për **Ndërmarrjet** e Reja "Hotel Iliria", dhe "Minex", pasi që Blerësit bazuar në të gjeturat e Auditorit i kanë përmbushur kushtet e Marrëveshjes, lidhur me këtë me datë 21 dhe 22 maj 2013 Bordi i Drejtorëve të AKP në Mbledhjen e mbajtur me datë 21 dhe 22 Mars 2013 ka marrë vendim që bazuar në nenin 7.1.1 të liroj nga Kushtet e Marrëveshjes së Zotimit Ndërmarrjet e Reja "Hotel Iliria" dhe "Minex".

Ndërmarrja e Re "IDGJ Tobacco" Ndërmarrja e Re "IDGJ Tobacco" Shpk, është privatizuar përmes metodës së Spin Off-it Special në valën e 11-të të shitjes, ndërsa periudha e përmbushjes së zotimeve të parapara në Marrëveshjen e Zotimeve ka përfunduar me datën 13 Gusht 2008. Me datë 27 Mars 2012 është aprovuar Marrëveshja për Përtëritje (Novacion) e Marrëveshjes së Zotimeve lidhur me Ndërmarrjen e Re "IDGJ Tobacco" Shpk nga Grupi punues i AKP-së. Kjo Marrëveshje është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 29 Mars 2012, si dhe është nënshkruar nga të gjitha palët e përfshira në këtë Marrëveshje me datë 12 Prill 2012., ku kusht për këtë Ndërmarrje gjatë periudhës dy vjeçare është të realizoj Investime prej 4,000,000.00 € dhe të plotësoj numrin e punëtorëve prej 14 punëtor në muajin e parë, 35 punëtor në muajin e dytë, 55 punëtor në muajin e tretë dhe 90 punëtor nga muaji i katërt e deri në përfundim të Marrëveshjes së Novacionit. Periudha e raportimit për këtë ndërmarrje përfundon me 10 Shtator 2014. Deri më tani kjo Ndërmarrje ka dorëzuar gjashtë Raporte tre mujore si dhe janë bere dymbëdhjetë vizita monitoruese tek kjo ndërmarrje.

Ndërmarrja e Re "Jugoterm International", është privatizuar përmes Spin Off-it Special në Valën e 15-të të shitjes, ndërsa ratifikimi i Kontratës është bërë me 17 Prill 2012. Zotimin për Investime duhet të e përmbushë brenda periudhës dy vjeçare në vlerën prej **2,760,000.00 €,** ndërsa zotimin për punësim **282 punëtor,** gjysmën e punëtorëve gjatë gjashtë muajve, ndërsa pjesën tjetër të punëtorëve deri në përfundimin e Zotimit në bazë të Kontratës. Deri më tani në këtë Ndërmarrje janë bere njëmbëdhjetë vizita monitoruese dhe nga raportet e dorëzuara nga Blerësi dhe vizitat e zhvilluara theksojmë se Blerësi është duke iu përmbajtur kushteve te marra përsipër me rastin e privatizimit te kësaj ndërmarrje. Blerësi i ri ka dorëzuar gjashtë raporte tremujore ku ka raportuar për investime dhe punësim.

Ndërmarrja e Re "Miniera dhe Industria e Magnezit Golesh" – është privatizuar me 11 Dhjetor 2007 nga Blerësi IMING d.o.o, përmes metodës së Spin Off-it Special në valën e 22-të të shitjes, ndërsa Marrëveshja

për Zotime ka përfunduar me datën 11 Dhjetor 2009. Sipas Marrëveshjes së Zotimeve blerësi është zotuar se do të bëjë investime kapitale në vlerë prej 16,200,000 euro si dhe të punësoj 178 punëtorë gjatë 6 mujorit të parë ndërsa në fund të vitit të parë numri i të punësuarve do të arrij gjithsej 355 punëtorë.

Në mars të vitit 2012, AKP ka angazhuar kompaninë vlerësuese "Aurelian Capital" L.L.C, që të bëje vlerësimin e investimeve të kryera në Ndërmarrjen e Re MIM Golesh. Nga të gjeturat e prezantuara në raportin e vlerësimit rezulton se blerësi ka bërë investime në **13,376,223.59€**. Në takimin e muajit mars Bordi i Drejtorëve të AKP ka vendosur që të pezulloj ekzekutimin e vendimit të Bordit të datës 16 Dhjetor 2011 për tërheqjen e aksioneve, ndërsa në mbledhjen e Bordit të mbajtur me datën 31 maj 2012 afati për përmbushjen e obligimeve për MIM Golesh zgjatet për dy vite nga data e nënshkrimit të kontratës. Gjate vitit 2013 Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje nuk ka zhvilluar asnjë vizite monitoruese në këtë ndërmarrje.

Ndërmarrja e Re "NBI Suhareka/Agrokosova Holding"- është privatizuar me 27 Gusht 2007 nga Blerësi "Gruppo Vinicolo Fantinel" dhe "QMI" përmes metodës së Spin Off-it Special në valën e 19-të të shitjes ndërsa periudha e përmbushjes së zotimeve të paraparë në Marrëveshjen e Zotimeve ka përfunduar me datën 27 gusht 2009. Sipas Marrëveshjes së Zotimeve blerësi është zotuar se do të bëjë investime kapitale në vlerë prej 8,600,000 euro si dhe të punësoj 173 punëtorë gjatë 6 mujorit të parë ndërsa në fund të vitit të parë numri i të punësuarve do të arrij gjithsej 345 punëtorë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese AKP ka angazhuar auditorë të jashtëm për të audituar përmbushjen e kushteve të marrëveshjes së zotimeve nga blerësit e Ndërmarrjes së Re "Agrokosova Holding". Sipas raportit të auditorit të jashtëm blerësi i ndërmarrjes së Re "Agrokosova Holding" ka përmbushur kushtin për investime kapitale në nivelin 88.87% ndërsa atë për punësim 39%. Në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të AKP të mbajtur me datën 20 korrik 2012 Bordi ka vendosur që vendimi i Bordit i datës 16 dhjetor 2011 për tërheqjen e aksioneve të mbetet në fuqi por të shtyhet ekzekutimi i këtij vendimi për 6 muaj dhe në ndërkohë të angazhohet një kompani që të bëjë vlerësimin e investimeve të bëra në këtë ndërmarrje dhe pastaj të rishikohet vendimi i Bordit për tërheqjen e aksioneve.

Në të njëjtën kohë Njësia për Monitorimit ka vazhduar të dërgojë faturat mujore për ndëshkime financiare për pesë ndërmarrjet e ndëshkuara për mospërmbushje të kushteve të Marrëveshjes për Zotime.

Për periudhën kohore 01 Janar 2013 – 30 Shtator 2013, shuma e përgjithshme e ndëshkimeve financiare:

Shuma totale e ndëshkimeve për 5 SSO-të		
Ndërmarrje Re	**01/01/2013 deri me 30 Shtator 2013**	Prej datës së fillimit e deri më 31 Dhjetor 2012
Ndërmarrja e Re Grand Hotel		8,822,314.97
Ndërmarrja e Re IDGJ Tobacco		4,573,649.11
Ndërmarrja e Re Xim Strezovc		7,298,170.76
Ndërmarrja e Re MIM Golesh		8,447,812.27
Ndërmarrja e Re Agrokosova Holding	38,284.12	3,569,997.53
Totali	**EUR 38,284.12**	**32,711,944.64**

Ndërmarrjet e Privatizuara me Kushte

Gjatë periudhës Janar – 30 Shtator 2013 , njëmbëdhjetë Ndërmarrje të privatizuara me kushte kanë qenë në procesin e monitorimit të përmbushjes së kushteve të kontratë – kryesisht vazhdimit të aktivitetit të njëjtë të biznesit.

Tabela përmbledhëse e ndërmarrjeve të privatizuara me kushte:

Nr.	Emri i Ndërmarrjes	**Statusi**
1	Ndërmarrja e Re "SharrCem"	Nën monitorim
2	Ndërmarrja e Re "Remont Servis"	Nën monitorim
3	Ndërmarrja e Re "Hotel Union"	Nën monitorim
4	Ndërmarrja e Re "Llamkos"	Nën monitorim
5	Ndërmarrja e Re "Famipa"	Nën monitorim
6	Ndërmarrja e Re "Amortizatorët"	Nën monitorim
7	Ndërmarrja e Re "Dubrava DF"	Nën monitorim
8	Ndërmarrja e Re "Emin Duraku-Edico"	Nën monitorim
9	Ndërmarrja e Re "Emin Duraku"- KI	Nën monitorim
10	Ndërmarrja e Re "Fabrika e Baterive Industriale Trepça"	Nën monitorim
11	Ndërmarrja e Re "Hotel Onix dhe Banja e Pejës"	Nën monitorim

Ndërmarrja e Re "Sharrcem" është privatizuar me 09. 12. 2010 për shumë 30.1 milion euro, Ndërsa sipas Marrëveshjes për Shitblerjen e aksioneve blerësi ka marrë përsipër që gjatë 5 viteve në vijim të bëjë investime në vlerë prej 35 milion euro si dhe të vazhdojë të punësoj gjatë 3 vitet e ardhshme të gjithë ish punonjësit e ndërmarrjes (numri i punonjësve 503).

Blerësi i Ndërmarrjes së Re "Sharrcem" gjatë periudhës 2 vjeçare ka raportuar një shume të konsiderueshme të investimeve kapitale mbi 17 milion euro ndërsa vazhdon të punësoj të njëjtin numër të punonjësve (503 Punonjës). Gjate vitit 2013 Njësi për Kontroll dhe Mbikëqyrje ka realizuar vizita të rregullta monitoruese (vizita mujore) në këtë ndërmarrje. Baze në raportet financiare të pranuara nga NJKM si dhe bazuar në vizitat monitoruese të realizuara gjatë kësaj periudhe munde të theksojmë se Ndërmarrja e Re "Sharrcem" është duke zhvilluar aktivitetin ne përputhje me kushtet e kontratës. Ndërmarrja e Re "Sharrcem" është e obliguar ti Raportoj AKP deri 09 Dhjetor 2015.

Ndërmarrja e Re "Remont Service" është privatizuar në valën 45A, ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar më 13 Qershor 2011. Kontrata e privatizimit për "Remont Service", përmban kushtin për punësimin e 43 punëtorëve për një periudhë dy vjeçare – kusht i cili është transferuar nga kontrata e koncesionit në kontratën. Ndërmarrja e re "Remont Servisi" është një nga ndërmarrjet e privatizuar me kushte e cila deri me tani me mjaft sukses ka arritur të plotësoj kushtet e kontratës, blerësi i ndërmarrjes deri me tani çdo tre mujor ka raportuar brenda afatit kohor të paraparë më kontratë dhe në disa raste ka raportuar se ka punësuar më shume punonjës së sa ka qenë i obliguar sipas kushtit të kontratës për punësim. Gjate vitit 2013 Njësi për Kontroll dhe Mbikëqyrje ka realizuar vizita të rregullta monitoruese (vizita mujore) në këtë ndërmarrje. Me datën 08 Shtator 2013 Ndërmarrjes së Re "Remont Service" i ka skaduar afati i marrëveshjes së zotimeve ndërsa AKP është në proces të përzgjedhës së auditorit që do të bëjë auditimin e plotësimit të kushteve të kontratës. Blerësi me datën 14 Tetor edhe formalisht ka bërë kërkesë për lirim nga kushtet e marrëveshjes.

Ndërmarrja e Re "Llamkos Steel" Sh.p.k, Ndërmarrja e Re "Llamkos Steel" Sh.p.k, është privatizuar në valën 6 të shitjes përmes Likuidimit, ndërsa ratifikimi i Kontratës së Shitjes është bërë me datën 25 Gusht 2011. Bazuar në Marrëveshjen e Shitblerjes se aseteve dhe Planin e Biznesit, blerësi i Ndërmarrjes së re Llamkos ka marrë përsipër që të punësoj 437 punonjës 6 muaj pas nënshkrimit të kontratës si dhe të bëjë investime ne vlerë prej 25 mil Euro vetëm gjate dy viteve të para të veprimtarisë.
Blerësi i ndërmarrjes gjithashtu merr përsipër të zbatoj edhe dy faza të tjera investimesh, gjate fazës së dytë (18 muaj pas përfundimit të fazës së parë) do të investohen edhe 45 mil Euro ndërsa gjatë fazës së tretë (18 muaj pas përfundimit të fazës së dyte) do të investohen edhe 30 mil Euro të tjera.

Gjate vitit 2013 Njësi për Kontroll dhe Mbikëqyrje ka realizuar vizita të rregullta monitoruese (vizita mujore) në këtë ndërmarrje. Bazuar në atë çfarë kemi parë gjatë vizitës monitoruese gjendja në Ndërmarrjen e Re Ndërmarrja e re "Llamkos" është relativisht e mirë ndërmarrja është duke vazhduar aktivitetin prodhues. Megjithatë duhet të theksohet se reparti për galvanizimin e llamarinës ënde është jashtë funksionit ndërsa në anën tjetër reparti për përpunimin e llamarinës (reparti për prodhimin kontejnerëve për mbeturina të madhësive të ndryshme, gypave për ajrosje etj) gjatë tërë kohës ka punuar me kapacitet të shtuar për shkak të kërkesave të mëdha në treg për këto produkte. Lidhur me punësimin e realizuar blerësi ka raportuar se vazhdon të realizoj punësim në pajtim me kushtet e kontratës që do thotë se ka punësuar 437 punëtorë me orar të plotë.
Raporti i radhës për investime dhe punësim pritet të pranohet me 25 Gusht 2014.
Raporti për vazhdim të aktivitetit 25 Shkurt 2014.
Ndërmarrja e Re "Llamkos" është e obliguar ti Raportoj AKP deri 25 Gusht 2016.

Ndërmarrja e Re "Famipa" Ndërmarrja e Re "Famipa" sh.p.k, është privatizuar në valën 49 të shitjeve, ndërsa Kontrata e Shitblerjes është nënshkruar me datën 13 Shtator 2011.
Shtojca 5 – Seksioni B i Deklaratës së bartjes të aseteve dhe detyrimeve parasheh që blerësi i Ndërmarrjes së Re "Famipa" do të vazhdoj aktivitetin e njëjtë në ndërmarrje (prodhimin dhe përpunimin e metaleve) si dhe nuk do të çmontoj dhe dislokoj pajisjet nga ndërmarrja të paktën deri në përfundim të kontratës.
Gjate vitit 2013 Njësi për Kontroll dhe Mbikëqyrje ka realizuar vizita të rregullta monitoruese (vizita mujore) në këtë ndërmarrje. Bazuar në atë çfarë kemi parë gjatë vizitës monitoruese gjendja në Ndërmarrjen e Re "Famipa" ka qenë jo e kënaqshme sepse blerësi ka pas vështirësi në plotësimin e kushtit të kontratës lidhur me vazhdimin e aktivitetit në ndërmarrje. Megjithatë gjatë dy vizitave të fundit monitoruese (shtator – tetor) vërehet një përmirësim i situatës në krahasim me periudhat paraprake, gjatë kësaj periudhe kemi parë se ka përparim dhe ndërmarrja ishte duke prodhuar kontakte elektrike dhe material (shufra) saldues për fabrikat nga rajoni . Ndërsa vazhdojnë përpjekjet për depërtim në tregjet tjera. Gjatë vizitës në ndërmarrjen e re "FAMIPA" kemi parë se janë të angazhuar gjashte punonjës.
Ndërmarrja e Re "Famipa" ka dorëzuar raportin e katërt 6 mujor me datën 06 Shtator 2013. Ndërsa raporti i radhës pritet të pranohet pas datës 13 Mars 2014.
Ndërmarrja e Re "Famipa" është e obliguar ti Raportoj AKP deri 13 Shtator 2014

Ndërmarrja e Re "Hotel Union" Ndërmarrja e Re Hotel Union është privatizuar në valën 11, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar me 02 Gusht 2006. Bazuar në Marrëveshjen e Zotimeve 541/2006, neni 2 dhe 3 blerësi i Ndërmarrje së Re është zotuar së do të restauroj dhe mirëmbajë pamjen e jashtme të ndërtesës në atë mënyrë që thellësisht do të ruaj stilin dhe karakterin historik të ndërtesës si dhe ti siguroj Aleancës së Shkrimtarëve të Kosovës një hapësirë prej 200 m2 për 13 vitet e ardhshme. Pas rinovimit the funksionalizimit të objektit të ndërmarrjes AKP ka organizuar një takim me blerësin e Ndërmarrjes se Re "Hotel UNION" dhe përfaqësuesit e LSHK për qellim të përcaktimit të lokacioni prej 200m2 që do ti jepet në shfrytëzim LSHK-s ashtu siç është përcaktuar me marrëveshjen e zotimeve. Gjate këtij takimi nuk është arritur marrëveshja për këtë lokacion ngase Blerësi kërkonte qe ky lokacion te jete jashtë hapësirave te Hotel Unionit kurse përfaqësuesit e LSHK kërkonin qe ky lokacion te jete brenda hapësirave te Hotel Unionit. Megjithatë përfaqësuesit e dy palëve kanë rënë dakord që të punojnë bashkarish në gjetjen e një zgjedhje të pranueshme për dy palët.

Ndërmarrja e Re ,, Hotel Onix Banja e Pejës dhe Banja e Shëndetit '' Pejë;
Ndërmarrja e Re "Hotel Onix Banja e Pejës dhe Banja e Shëndetit" shpk, është privatizuar si projekt individual përmes tenderit ndërkombëtarë ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar me datën 22 prill 2013. Bazuar në shtojcën 1, Marrëveshja për Zotime e cila është pjesë përbërëse e Marrëveshjes për Shitblerjen e Aksioneve të thjeshta në Ndërmarrjen e Re "Hotel Onix Banja e Pejës dhe Banja e Shëndetit" shpk, Blerësi është zotuar si në vijim: Të vazhdoj aktivitetin aktual të biznesit që nënkupton vazhdimin e veprimtarisë së njëjtë të Ndërmarrjes Shoqërore në banjë shëndetësore dhe hotel. Blerësi i Ndërmarrjes së Re siguron dhe garanton se do të vazhdoj dhe do të mbajë aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e Periudhës se Zotimit

Gjate vitit 2013 Njësi për Kontroll dhe Mbikëqyrje ka realizuar vizita të rregullta monitoruese (vizita mujore) në këtë ndërmarrje. Bazuar në atë çfarë kemi parë gjatë vizitave monitorues ndërmarrja ka vazhduar të ushtroj veprimtarinë e biznesit ashtu siç është zotuar me kontratë, ndërsa në anën tjetër me mjaft intensitet po punohet në rregullimin e infrastrukturës dhe ngritjen e kapaciteteve të reja për akomodim. Sa i përket ndërtimeve të reja të gjitha punët e vrazhda janë kryer dhe tani po punohet në rregullimin e hapësirave të brendshme si instalimi i rrymës, ujit, ngrohjes dhe punë të tjera. Me datën 14 22 Tetor 2013 blerësi i ndërmarrjes ka dorë raportin e parë 6 mujor. Bazuar në të dhënat e prezantuara në raportin 6 mujor blerësi gjatë tërë periudhës ka qenë në përputhje me kushtet e kontratës dhe për asnjë moment nuk ka ndërprerë veprimtarinë. Në anën tjetër blerësi ka raportuar se gjatë periudhës 6 mujore ka punësuar çdo muaj mesatarisht 134 punëtorë me orar të plotë. Po ashtu lidhur ne investimet e realizuara gjatë periudhës raportuese blerësi ka raportuar se ka investuar gjithsej 1.019.614,25€.

Ndërmarrja e Re "Fabrika e Amortizatorëve" - është privatizuar në valën 45A, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar më 31 Mars 2011. Ndërmarrja e Re "Fabrika e Amortizatorëve gjendet në Komunën e Prishtinës. Në bazë të marrëveshjes, si detyrim kontraktues Blerësi i ri ka marrë përsipër që të vazhdoj dhe mbaj aktivitetin aktual të biznesit. Deri më tani janë bere trembëdhjetë vizita monitoruese nga te cilat munde te përfundojmë se ndërmarrja zhvillon aktivitetin prodhues sipas kërkesave individuale por jo edhe ndonjë prodhim serik te amortizatorëve .
Periudha e Monitorimit përfundon me 31 Mars 2016.

Ndërmarrja e Re "Emin Duraku Kompleksi Industrial" Shpk, është privatizuar në Valën 45 A, ndërsa ratifikimi i kontratës është bërë me datën 03 Shtator 2012. Ndërmarrja e Re ""Emin Duraku Kompleksi Industrial" Shpk gjendet në Komunën e Gjakovës. Obligimin që ka marrë përsipër Ndërmarrja është vazhdimi i aktivitetit aktual të biznesit për periudhën prej 5 viteve, konkretisht deri më 03 Shator 2017. Deri me tani kemi bere nëntë vizita monitoruese nga të cilat shihet se Blerësi ka bërë lëvizje pozitive dhe ka lëshuar në prodhim linjën e tekstilit. Ne baze te marrëveshjes se shitjes Ndërmarrja ne vitin e parë duhet të raportoj çdo tre muaj, ndërsa gjatë viteve të tjera çdo gjashtë muaj.

Ndërmarrja e Re "Emin Duraku Edico" Shpk, është privatizuar në Valën 45 A, ndërsa ratifikimi i kontratës është bërë me datën 14 Gusht 2012. Ndërmarrja e Re "Emin Duraku Edico" Shpk gjendet në Komunën e Gjakovës. Obligimin që ka marrë përsipër Ndërmarrja është vazhdimi i aktivitetit aktual të biznesit për periudhën prej 5 viteve, konkretisht deri më 14 Gusht 2017. Gjatë kësaj periudhe duhet të raportoj tek Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes çdo gjashtë muaj. Deri me tani kemi nëntë vizita monitoruese, ku mund te theksojmë se Blerësi ka filluar aktivitetin ne ndërmarrje në fushën e tekstilit dhe ka lëshuar në funksion linjën e tekstilit.

Ndërmarrja e Re "Dubrava Dairy Farm" – është privatizuar në valën e 28 –të të shitjes, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar me 19 Dhjetor 2011. Ndërmarrja e Re "Dubrava Dairy Farm" gjindet në Komunën e Istogut. Në bazë të Marrëveshjes, si detyrim kontraktues Blerësi i Ri ka marrë përsipër që të vazhdoj dhe të mbaj aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e periudhës së detyrimit kontraktues, respektivisht deri më 19 Dhjetor 2016, (periudha prej 5 viteve). Detyrimi kontraktues që del nga kontrata është që Ndërmarrja e Re "Dubrava Dairy Farm" është e obliguar të mbaj të punësuar 17 punëtor, si dhe të mbaj 250

krerë gjedhe për ketë periudhë kohore në bazë të Kontratës. Bazuar në Raportet gjashtëmujore, Blerësi ka investuar në blerjen e 250 krerë gjedheve dhe ka punësuar 17 punëtorë në bazë të Kontratës. Deri më tani janë bere dymbëdhjetë vizita monitoruese.

Ndërmarrja e Re "Fabrika e Baterive Industriale Trepça" - Ndërmarrja e Re "Fabrika e Baterive Industriale Trepça" Sh.p.k, është privatizuar si projekt individual, ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar me datën 14 Qershor 2013. Me këtë Blerësi i Ri siguron dhe garanton se do të vazhdoj dhe do të mbaj aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e periudhës së Zotimit për tri vitet e ardhshme, konkretisht deri më 14 Qershor 2016. Deri më tani janë realizuar tri vizita Monitoruese, ku shihet se Blerësi i ri është duke bërë përpjekje që të mbaj vazhdimin e aktivitetit, bazuar në marrëveshjen e Zotimeve. Raporti i pare gjashtëmujor Blerësi i Ri është i obliguar të e dorëzoj në muajin Dhjetor 2013.

IV.3. NJËSIA E ADMINISTRIMIT DIREKT

Në rrjedhën normale të ngjarjeve, kontrolla dhe monitorimi i ndërmarrjeve është bërë nga Zyrat Rajonale të AKP-së. Masat e Administrimit Direkt janë implementuar në rastet specifike kur një NSh kishte ngadalësim apo ngecje në progres apo ishte në rrezikshmëri financiare për shkak të keqmenaxhimit apo dëmtimit të aseteve e që reflektonte në dëm të interesave të NSh-së dhe punëtorëve të saj. Kur Zyrat Rajonale të kenë shterur të gjitha mundësitë dhe opsionet për të gjeneruar ndikim pozitiv në NSh-në e cila shfaq një trend të rënies, atëherë propozohen masat e Administrimit Direkt nga Zyrat Rajonale të AKP-së për t'u implementuar në këtë ndërmarrje. Të gjitha NSh-të e vendosura dhe/ose të larguara nga AD janë të miratuara nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së.

Ndërmarrjet të cilat aktualisht janë nën Administrim Direkt:

1. Ndërmarrja e Re "Grand Hotel Prishtina" Prishtinë;
2. NSh "Pallati i Rinisë Kulturës dhe Sporteve", Prishtinë;
3. NSh "Ereniku-Industria" Gjakovë;
4. NSh "Boksitet e Kosovës" Klinë; dhe
5. NSh "Fapol" Podujevë.

Ndërmarrja e re "Grand Hotel Prishtina" Prishtinë

Ndërmarrja e re Grand Hotel është vendosur nën Administrim Direkt më 20 Korrik 2012. Gjendja e kësaj Ndërmarrje ka qenë shumë e vështirë. Në pjesën e dytë të vitit 2012 si dhe gjatë viti 2013, AD ka arritur këto rezultate:

- Administrimi Direkt, ka arritur të aktivizoj qasjen në ujësjellës, linja telefonike dhe në internet (vvireless);
- Ka arritur të nënshkruaj marrëveshje për riprogramim të borxheve me Ndërmarrje publike, KEK, PTK dhe TERMOKOS;

- Ka arritur që të shpërndajë pagat e punëtorëve të cilët nuk kishin marrë 8 pagat e fundit nga ana e ish-blerësit të kësaj Ndërmarrje;
- Ka arritur lëshimin me qira të disa aseteve (parkingu, zyre, lokale afariste, restorante dhe hapësira reklamuese) nga të cilat janë paguar borxhet e Ndermarrjes si dhe janë siguruar pagat për punëtorë. AKP në vazhdimësi po bën përpjekje për të kthyer imazhin e hotelit përmes njoftimeve për publikun, promovimeve të çmimeve te reja dhe mënyrave tjera të marketingut;
- Janë bërë renovime të sistemit të brendshëm të ngrohjes, sistemit elektrik, si dhe renovimi i disa pjesëve/hapësirave të dëmtuara nga ish-Blerësi.

Si rrjedhojë e kësaj, ndërmarrja ka një trend të ngritjes të vazhdueshme të të hyrave dhe zvogëlimit të shpenzimeve. Aktualisht nga qiradhënia e aseteve ka krijuar të hyra mujore në vlerë prej 31,400 € (tridhjetë e një mijë e katërqind euro).

NSH Fapol

Kjo Ndërmarrje ishte komercializuaer ne vitin 2001. Pas skadimit të afatit të kontratës së komercializimit më 30 Qershor 2012, NSh Fapol është kthyer nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit respektivisht Zyrës Regjionale të Prishtinës me qellim që ndërmarrja të përgatitet për privatizim.

Me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së kjo Ndërmarrja me datë 06 Qershor 2013 është vendosur nën Administrim të Drejtpërdrejt të AKP-së me qëllim të krijimit të një strukture të brendshme organizative, dhe me qellim të hartimit të skemës së pagave konform kërkesës për rritjen e tyre. Kjo Ndërmarrje menaxhohet nga Bordi i Përkohshëm Menaxhues i emëruar nga Bordi i AKP-së, dhe operon me gjithsejtë 92 punëtor duke përfshirë edhe 6 punëtor në asistencë financiare të cilët angazhohen herë pas here duke zëvendësuar ndonjërin nga punëtorët aktiv.

Pas futjes se Ndërmarrjes Shoqërore nën kontrollin të Njësisë së Administrimit Direkt, duke u mbështetur në ligjin e AKP-së dhe politikat operacionale, me qëllim të rritjes së vlerës dhe menaxhimit më të mirë të ndërmarrjes, u ndërmorën masat e menjëhershme si në vijim:

a) Inspektimi i hapësirës së Ndërmarrjes;
b) Inspektimi i aktiviteteve financiare dhe qasja në xhirollogaritë bankare të Ndërmarrjes;
c) Inspektimi i dokumenteve ligjore, përfshirë aktivitete e kontraktuara;
d) Regjistrimi i aseteve të Ndërmarrjes; dhe
e) Takimi me Menaxhmentin, Sindikatën e Punëtorëve dhe njoftimi me Ligjin dhe rregulloret e punës së AKP-së.

Duke konstatuar gjendjen në Ndërmarrje, pakënaqësinë e punëtorëve për paga të ulëta, Njësia e AD ka ndërmarr hapat e menjëhershëm për të hartuar rregulloren e brendshme për sistematizimin e vendeve të punës në Ndërmarrje, e cila është konsideruar si e domosdoshme për mbarëvajtjen më të mirë të punës dhe rritjen e pagave.
Si rrjedhojë me vendim të Bordit të drejtorëve të AKP-së me datën 18 Korrik 2013 është bërë rritja e pagave në vlerë prej 28.32%.

Aktualisht Ndërmarrja nuk ka detyrime të papaguara. Gjendja e llogarisë bankare deri më 30 Shtator 2013 është 820,114.00 €.

Ndërmarrjet të cilat janë larguar nga Administrim Direkt:

1. NSH ”Artizanati – Kosovarja” Prishtinë;
2. Ndërmarrja e re Miniera“XIM Strezovc” Kamenicë;
3. NSH “Lavërtaria dhe Blegtoria” Prizren;
4. NSH “Vreshtaria” Prizren; dhe
5. NSH “Unimont” Prizren;

NSH ”Artizanati – Kosovarja” Prishtinë

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë, duke u bazuar në dispozitat juridike nga nenit 6 të rregullores Nr. 2002/12 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit me datë: 20/06/2006, ka marrë vendim për futjen e kontrollit të drejtpërdrejt mbi Ndërmarrjen Shoqërore “Artizanati Kosovarja”, Prishtinë duke përfshirë llogaritë bankare dhe asetet, si dhe administrimin e këtyre llogarive dhe aseteve veçmas nga llogaritë e Agjencisë.

Njësia e Administrimit të Drejtpërdrejtë të AKP-së është ballafaquar me probleme të shumta në këtë Ndërmarrje e sidomos në aspektin financiar dhe ligjor.

Që nga viti 2006 ka vazhduar realizimi e pagave mujore duke përfshirë edhe pagesat e kontributit pensional dhe tatimit të mbajtur në burim të 13 (trembëdhjetë) punëtorëve të Ndërmarrjes nga marrëveshja e qerasë që kjo ndërmarrje ka me Ministrinë e Punëve të Brendshme në shumë prej 3,000.00 euro për muaj, plus TVSH-ja;

Njësia e AD, pas disa takimeve te zhvilluara me Zyrtaret përgjegjës te Drejtorisë Kadastrale në Prishtinë si dhe pas disa shkresave dhe vërejtjeve të dërguara, në vitin 2013 ka arritur që të detyroj Zyrën Kadastrale në Prishtinë, që të lëshoj certifikatën e re pronësore dhe kopjen e planit për asetin e Ndërmarrjes në Zonën Industriale Fushë Kosovë - me sipërfaqe 2050 m2, si dhe objektit prej 550 m2, (fleta poseduese numër P-71914059-01498-83), i cili është propozuar për shitje në valën 58 të Privatizimit.

Menaxhmenti i AKP-së, ka konsideruar se shkaqet të cilat e kanë sjell gjendjen e vështirë në Ndërmarrjen “Artizanati Kosovarja” në Prishtinë, përkatësisht futjen e Ndërmarrjes nën mbikëqyrjen e Njësisë së Administrimit të Drejtpërdrejtë, tanimë janë evituar, dhe si rezultat i kësaj nuk ekziston asnjë arsye që kjo ndërmarrje të qëndrojë nën mbikëqyren e kësaj Njësie brenda Divizionit të Shitjes të AKP-së.

Me propozimin e Menaxhmentin të AKP-së kjo Ndërmarrja Shoqërore “Artizanati Kosovarja”, Prishtinë është larguar nga mbikëqyrja e Njësisë së Administrimi i Drejtpërdrejtë të AKP-së, dhe është vendosur nën administrimin e Zyrës Regjionale të Prishtinës e cila do të vazhdoj me shitjen e aseteve te mbetura të kësaj Ndërmarrje.

Ndërmarrja e re Miniera“XIM Strezovc” Kamenicë

AKP me datë: 20/ 07/ 2012 ka marrë vendim për futjen e kontrollit të drejtpërdrejt mbi Ndërmarrjen e Re “Miniera Xim-Strezovc” duke përfshirë llogaritë bankare dhe asetet, si dhe administrimin e këtyre llogarive dhe aseteve veçmas nga llogaritë e Agjencisë.

Menaxhmenti i AKP-së, Njësia e Administrimit Direkt ka ekzekutuar vendimin e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vendosjen e Kontrollit të Drejtpërdrejt mbi Ndërmarrjen.

Pas takimeve të shumta, konsultimeve, dhe bashkëpunimit me Udhëheqësit e Ndërmarrjes, Sindikatën e Pavarur të Ndërmarrjes së re, dhe pas analizimit të dokumenteve relevante, dhe historikut të punëtorëve të kësaj Ndërmarrjeje, në pajtim me nenin 6 pika 1.1, 1.2 të ligjit të AKP-së, Menaxhmenti i AKP-së, ka propozuar listën me anëtarë të Bordit e cila është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datën

Veprimet e ndërmarra nga AD pas vendosjes së Ndërmarrjes nën Administrim Direkt

Emërimi i Menaxhmentit te Ri;
Regjistrimi i aseteve;
Debllokomi i llogaris bankare;
Qasje në llogarinë bankare prej dy Zyrtareve (Zyrtarit të Ndërmarrjes dhe Zyrtarit te AKP-se);
Përpilimin e procedurave për mbajtjen e arkës;
Përpilimin e procedurave të furnizimit;

Shitja e mbeturinave metalike (skrapit) me ç'rast janë rritur të hyrat dhe është paguar Bordi i ndërmarrjes.

Pasi që me Administrimin e Drejtpërdrejt është arritur stabiliteti i Ndërmarrjes ne aspektin e menaxhimit, ruajtjes se aseteve dhe rritjes se vlerës së Ndërmarrjes, si dhe duke u nisur nga fakti që në mungesë të aseteve te cilat ishin dëmtuar dhe asgjësuar nga ish Blerësi, si dhe në mungese të resurseve humane dhe financiare, kjo Ndërmarrje nuk ka qenë në gjendje të riorganizohet dhe të filloj aktivitetin e saj primar e as ndonjë aktivitet tjetër operacional nga i cili do te gjeneroheshin të hyra, dhe si rrjedhoje e kësaj gjendje të krijuar arsyeshmeria e vazhdimit te implementimit te masave te Administrimit Direkt kanë pushuar.

Pas tërheqjes së kësaj Ndërmarrje nga AD, Agjencia Kosovare e Privatizimit bazuar në ligjin 04/L-034 neni 8 pika 5 ka futur këtë Ndërmarrje në Likuidim.

NSH"Lavërtaria dhe Blegtoria" Prizren

Me vendim të Bordit të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit të datës 20.07.2006, NSH KBI "Progres" Lavërtaria- Blegtoria"-Drejtoria, Prizren, është futur nën Administrim Direkt duke përfshirë llogaritë bankare dhe asetet, si dhe administrimin e këtyre llogarive dhe aseteve veçmas nga llogaritë e Agjencisë. Aktiviteti primar i Ndërmarrjes është: kultivimi i rendimenteve Bujqësore dhe Blegtorale.

Ndërmarrja ballafaqohet me një problem të vazhdueshëm që e përcjell atë një kohë të gjatë, obligimet e larta ndaj ATK në vlerë prej 320.812,84 (treqind e njëzet mijë e tetëqind e dymbëdhjetë euro e tetëdhjetë e katër cent). Në pamundësi të shlyerjes së këtyre obligimeve NSh po ballafaqohet me masat e ndërmarra nga ATK që ka rezultuar me bllokim të llogarisë bankare. Që nga ajo kohë, gjendja financiare është vështirësuar dukshëm, duke pezulluar çdo aktivitet të NSh që nga ajo periudhë. Si pasojë e bllokimit, ndërmarrja nuk e ka ushtruar veprimtarinë e saj, mbjelljen e një sipërfaqeje të tokave të punueshme që posedon, nga e cila veprimtari kishte arkëtuar edhe mjete për pagesën e pagave për punëtorët. Aktualisht aktiviteti kryesor i ndërmarrjes është ruajtja e aseteve si dhe ndihma e AKP-së me dokumentacione relevante që shërbejnë për privatizim, si dhe përfaqësimi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme së bashku me zyrtarin ligjor të AKP-së, lidhur me kontestet pronësore të lartpërmendura.

Gjatë periudhës nën masat e Administrimit Direkt janë shitur disa asete të vlefshme të kësaj NSh:

- Ferma e lopëve në Arbanë;
- Toka bujqësore në Lubizhdë;
- Administrata e vjetër "Hotel Tirana"; dhe
- Ferma "Barutana"

Kjo ndërmarrje posedon toka bujqësore si dhe disa objekte përcjellëse te cilat janë potencial për privatizim.

Pasi që ndërmarrja nuk ushtron aktivitetin e sajë primar e që është: Kultivimi i rendimenteve Bujqësore dhe Blegtorale, dhe si rrjedhojë e kësaj nuk ka aktivitete financiare e as operacionale te cilat do te monitoroheshin dhe kontrolloheshin nga AD, është krejtësisht e panevojshme qe mbi këtë ndërmarrje të vazhdohej te ushtrohen masat e kontrollit te drejtpërdrejt. Asetet/tokat e pa privatizuari të cilat janë pa konteste do të mund të përgatiten për privatizim nga Zyra Rajonale e Prizrenit. Kontestet pronësore do të administrohen nga Departamenti Ligjor/Njësia për përfaqësime gjyqësore. Me vendim te Bordit të AKP-së kjo Ndërmarrje me datën me datën 29.08.2013 është tërhequr nga AD dhe ka kaluar në Administrim të Zyrës Rajonale të Prizrenit.

NSH "Vreshtaria" Prizren

Agjencia Kosovare e Privatizimit (e Mirëbesimit ne atë kohë), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë, me datë: 21/07/2004, ka marrë vendim për futjen e kontrollit të drejtpërdrejt mbi Ndërmarrjen Shoqërore "Vreshtaria" Prizren duke përfshirë llogaritë bankare dhe asetet, si dhe administrimin e këtyre llogarive dhe aseteve veçmas nga llogaritë e Agjencisë.

Njësia e Administrimit Direkt ka bërë përpjekje që Ndërmarrja të jete aktive dhe të shfrytëzohen pronat e kësaj Ndërmarrje për kultivimin e rrushit, mirëpo për shkak të mungesës së resurseve njerëzore si dhe pamundësisë së funksionalizimit të vneshtave, aktivizimi ishte i pamundur.

Në pamundësi që Ndërmarrja të filloj vete aktivitetin e saj prodhues, disa asete të kësaj Ndërmarrje ishin dhënë me qira në periudha të caktuara kohore.

Pasi që Ndërmarrja nuk ka zhvilluar ndonjë aktivitet ekonomiko/financiar, dhe roli i Administrimit Direkt në këtë NSH ka qenë shumë i vogël, asetet e mbetura të kësaj NSH-je do të përgatiten për privatizim nga Zyra Rajonale e Prizrenit, andaj lidhur me këtë, Menaxhmenti i AKP-së ka konsideruar se nuk ekziston ndonjë arsye ligjore e as operacionale që kjo ndërmarrje të qëndroj nën Administrim të drejtpërdrejt të AKP-së. Prandaj me vendim të Bordit të AKP-së NSH"Vreshtaria" është tërhequr nga Njësia e Administrimit Direkt.

NSH "Unimont" Prizren

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit Privatizimit me datë: 21/09/2006, ka marrë vendim për futjen e kontrollit të drejtpërdrejt mbi Ndërmarrjen Shoqërore "Unimont", Prizren duke përfshirë llogaritë bankare dhe asetet, si dhe administrimin e këtyre llogarive dhe aseteve veçmas nga llogaritë e Agjencisë.

Një Ndërmarrje e re (Administrata/Objekti i Drejtorisë) është privatizuar dhe është përmbyllur ratifikimi i kontratave me blerësit.

Aktualisht ndërmarrja nuk gjeneron të hyra të mjaftueshme as për mbulimin e pagave, ngase nuk e ushtron aktivitetin e saj primar. Prona e mbetur e sajë edhe pse kontestuese me Komunën e Prizrenit ndodhet në Hipotekë.

Industria në Krushë te Vogël ka qenë e tenderuar ne valën e 52 te privatizimit, por për shkak te kontestit me KK Prizren këto dy asete te ndërmarrjes janë tërheq prej kësaj vale te privatizimit.

Pasi që Ndërmarrja nuk zhvillon aktivitetin e sajë primar e as ndonjë aktivitet ekonomiko/financiar, ndërsa roli i Administrimit Direkt në këtë NSH është shume i vogël, si dhe duke konsideruar se objekti i drejtorisë është privatizuar dhe pengesave që na paraqiten për shitjen edhe të dy aseteve tjera të Ndërmarrjes, Menaxhmenti i AKP-së ka konsideruar se nuk ekziston ndonjë arsye operacionale që kjo ndërmarrje të qëndroj nën Administrim të drejtpërdrejt të AKP-së, respektivisht kanë pushuar së ekzistuari arsyet për kontrollin e drejtpërdrejt të Ndërmarrjes. Asetet e Ndërmarrjes do të vazhdojnë të sigurohen nga Kompania e kontraktuar e AKP-së për sigurimin e aseteve. Prandaj si rrjedhojë e kësaj me datën 12 prill 2013 me vendim të Bordit të AKP-së kjo Ndërmarrje është larguar nga Administrimi i Drejtpërdrejtë.

V. DEPARTAMENTI PËR KOORDINIM TË LIKUDIMIT

Departamenti për Koordinim të Likuidimit (DKL) si pjesë e Divizionit të Likuidimit (DL) përbëhet nga këto njësi:

1. **Njësia e Monitorimit të Likuidimit dhe Fondeve të Mbetura;**
2. **Njësia e Likuidimeve nga AKP-ja dhe**
3. **Njësia për Listat e Punëtorëve për 20%.**

Me qëllim të rrjedhjes sa më të mirë të procesit të pranimit të kërkesave të pretenduesve në procesin likuidimit nga menaxhmenti është vendosur që të gjitha kërkesat të pranohen në DKL e jo si më parë në zyrat respektive rajonale. Pas procedurave të tenderimit dhe nënshkrimit të kontratës më datë 10 korrik 2012, është angazhuar konzorciumi "Deloitte" dhe "Tashko&Pustina" për projektin "Ofrimi i Shërbimeve Profesionale për Likuidimin e Portfolios së Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës".
Në vazhdim do të shpjegohen në detaje veç e veç aktivitetet për secilën nga këto njësi të DKL për periudhën raportuese:

NJËSIA E MONITORIMIT TË LIKUIDIMIT DHE FONDEVE TË MBETURA

1. Fillimi i procedurave të likuidimit për Ndërmarrjet e reja

Gjatë periudhës raportuese 01 janar – 30 shtator 2013, kanë filluar procedurat e likuidimit për 102 Ndërmarrje Shoqërore ku janë emëruar edhe Autoritetet e Likuidimit për këto Ndërmarrje në Zyrat Rajonale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
Me fillimin e procedurave janë bërë njoftimet për kreditoret neper gazeta në Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi, siç është e paraparë me ligji. Gjithashtu Autoritetet e Likuidimit kanë dërguar njoftim tek kreditorë e njohur për fillimin e procedurave të likuidimit si dhe kanë filluar me shqyrtimin e kërkesave të kreditorëve brenda afateve ligjore.
Për 39 Ndërmarrjet Shoqërore tashmë është mbyllur afati për parashtrimin e kërkesave ndërsa 60 Ndërmarrje Shoqërore të tjera janë në proces të pranimit të kërkesave. Deri më tani nga pretenduesit e ndryshëm janë dorëzuar më shumë se 20,000 (njëzet mijë) kërkesa kreditore pranë zyrës për pranimin e kërkesave në DKL, ku pastaj në mënyrë periodike janë bartur tek Autoritetet e Likuidimit të Ndërmarrjeve përkatëse nëpër zyrat rajonale respektive.

2. Rezultatet e shqyrtimit të kërkesave

Në përputhje me Ligjin e ri Nr.04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) është angazhuar konzorciumi "Deloitte dhe Tashko&Pustina" për projektin e ofrimit të Shërbimeve Profesionale për Likuidimin e Portofolios së Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës.

Përveç 173 Autoriteteve të Likuidimit sa kanë qenë të emëruara, gjatë periudhës raportuese janë emëruar edhe 102 Autoritete të Likuidimit për NSh-të të cilat kanë filluar procedurat e likuidimit gjatë muajve qershor, korrik, gusht dhe shtator 2013.
Gjatë periudhës raportuese Autoritet e Likuidimit të këtyre ndërmarrjeve kanë arritur që të bëjnë shqyrtimin dhe të dërgoj 24,981 vendime tek pretenduesit të cilët kanë parashtruar kërkesa pranë Agjencisë. Autoritete e Likuidimit të këtyre Ndërmarrjeve Shoqërore në Likuidim kanë përgatitur edhe 34,008 draft vendime të cilat pas kalimit të procedurave të kontrollit të kualitetit edhe këto pritet që së shpejti të ju dërgohen palëve. Gjatë periudhës raportuese janë edhe 4,258 kërkesa për informata shtesë me formularët L51 dhe L52 të cilat janë dërguar te pretenduesit.
Autoritet e Likuidimit të këtyre Ndërmarrjeve Shoqërore në Likuidim kanë përgatitur raportet përfundimtare dhe raportet për shpërndarje për 22 Ndërmarrje Shoqërore të cilat i janë prezantuar Bordit të Drejtorëve të AKP-se për aprovim, ndërsa janë përgatitur edhe rreth 112 Raporte Preliminare të Likuidimit për po kaq Ndërmarrje Shoqërore në Likuidim.

3. Procedurat e likuidimit të përfunduara nga Autoritetet e Likuidimit

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve shoqërore të cilat janë nën procesin e likuidimit, vetëm për 4 NSh kanë përfunduar të gjitha procedurat e likuidimit.
Përderisa në anën tjetër, për pjesën tjetër të ndërmarrjeve (275) ende janë duke vazhduar procedurat e likuidimit, përkatësisht procedurat e parapara ligjore lidhur me shqyrtimi e kërkesave kreditore, përgatitjen e Raporteve Përfundimtare për përmbylljen e procesit të likuidimit si dhe shpërndarjen e fondeve tepricë në buxhetin e Republikës së Kosovës. Pritet që në muajt në vijim të shënohet progres në procesin e përfundimit të procedurave të likuidimit të këtyre ndërmarrjeve nëse emërohet edhe anëtari tretë ndërkombëtar në Bordin e Agjencisë dhe nëse Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës e përshpejton procesin e punës së vetë në raport me procesin e likuidimit.

4. Aktivitete të tjera:

Departamenti për Koordinimit të Likuidimit vazhdimisht ka mbajtur takime koordinuese me Udhëheqësit e Ekipeve të Likuidimit (UEL) në të cilat takime janë diskutuar çështje të ndryshme rreth procesit të likuidimit si:

- Koordinimi i punëve me Kontraktorin - Ofruesin e Shërbimeve Profesionale (OShP),Fillimi i procedurave të likuidimit për ndërmarrjet e aprovuara nga Bordi në mbledhjet e majit, qershorit; propozimet e reja për futjen e ndërmarrjeve në likuidim gjatë fund vitit etj.
- Përgatitjet për bartjen e disa NSh-ve nga Zyra Rajonale e AKP-së të Gjilan në atë të Prizrenit dhe nga Zyra Rajonale e AKP-së së Prishtinës në atë të Mitrovicës me qëllim të balancimit të numrit të ndërmarrjeve dhe numrit të ndërmarrjeve dhe të numrit të vendimeve.
- Janë diskutuar edhe çështje si: kërkesat e parashtruara pas afatit, mënyra e kalkulimeve të rrogave të kërkesat e pranuara së bashku me tatime, rastet kur dërgohet letra për arsyetim për vonesë në parashtrim të kërkesave, kërkesat të cilat vazhdojnë të pranohen edhe sot dhe trajtimi i tyre si dhe çështjet tjera të ndërlidhurave procesin e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore etj.

NJËSIA E LIKUIDIMEVE NGA AKP-JA

Bazuar në nenin 13 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, në rastet kur ndërmarrja shoqërore e cila është objekt i likuidimit nuk ka asnjë pasuri apo kundër së cilës nuk është parashtruar asnjë kërkesë kreditore në afat, atëherë në këto raste anëtarët e AL-së emërohen nga radhët e personelit të AKP-së, dhe i gjithë procesi i likuidimit të këtyre ndërmarrjeve realizohet nga Njësia përkatëse përbrenda agjencisë, gjegjësisht Njësia e Likuidimit të NSh-ve nga AKP-ja.

Gjatë periudhës raportuese 01 Janar 2013 -30 Shtator 2013, në Njësinë e Likuidimeve nga AKP-ja janë bartur 8 Ndërmarrje Shoqërore (pa asete ose pa kërkesa) për të cilat është punuar në procesin e përmbylljes së likuidimit konform procedurave ligjore të parapara në Shtojcën e Ligjit të AKP-së Nr. 04/L-034.
Në vijim janë të listuara NSh-të për të cilat është punuar në procesin e përmbylljes së likuidimit:

- Kooperativa Bujqësore "Likovci" – Skenderaj
- Kooperativa Bujqësore "Liria" – Skenderaj
- Kooperativa Bujqësore "Klina" – Skenderaj
- SHAM "Semafori" – Suharekë
- Kooperativa Bujqësore "Ozdrim" – Pejë
- Kooperativa Bujqësore "Vitomirica" – Pejë
- NSh SHAM "Ruzhdi Bytyqi" – Vushtrri
- NSh "Auto Moto" – Prizren

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës ka aprovuar Raportet Përfundimtare të procesit të likuidimit dhe në të njëjtën kohë ka lejuar përmbylljen e procesit të likuidimit për 2 Ndërmarrje Shoqërore (pa asete ose pa kërkesa kreditore). Në vijim janë ndërmarrjet për të cilat është përmbyllur procesi i likuidimit:

Emri i Ndërmarrjes:	**Data e Vendimit të DhPGjS:**
Kooperativa Bujqësore "Likovci" – Skenderaj	11/01/2013
Kooperativa Bujqësore "Liria" – Skenderaj	31/01/2013

Gjithashtu, si rezultat i përfundimit të procedurave të likuidimit është përgatitur Raporti Përfundimtar i procesit të likuidimit për NSh SHAM "SEMAFOR" – Suharekë, dhe i njëjti me datën 28 qershor 2013, është dërguar pranë DhPGjS për aprovim të përmbylljes së likuidimit të kësaj ndërmarrje.
Në anën tjetër, AKP-ja është në fazën përfundimtare të procesit të likuidimit dhe përgatitjes së Raportit Përfundimtare për ndërmarrjen Kooperativa Bujqësore "Klina" – Skenderaj, përderisa edhe për ndërmarrjet tjera të renditura më lartë është duke u punuar në mënyrë që të procedohet në përmbylljen e likuidimit të tyre.

NJËSIA PËR LISTAT E PUNËTORËVE PËR 20%

Njësia e listave të punëtorëve është përgjegjëse për pranimin nga menaxhmenti i NSh-ve, verifikimin dhe përgatitjen për publikim të listave fillestare dhe finale të punëtorëve të kualifikueshëm si dhe shpërndarjen e fondeve të 20%-it nga çmimi i shitjes i aseteve të NSh-ve për ish punëtorët e atyre NSh-ve të cilat janë përfshirë në procesin e shitjes së aseteve përmes privatizimit apo shitjes përmes likuidimit.

Njëri prej aktiviteteve kryesore të kësaj njësie është shpërndarja e pjesshme e 20 % nga shitjet e NSh-ve dhe shpërndarjen nga shitjet e mëpastajshme të aseteve. Ky aktivitet ende mbetet një nga aktivitetet me prioritet i AKP-së. Përgatitja dhe publikimi i Listave fillestare dhe Listave finale po ashtu është trajtuar me prioritet të lartë. Gjatë periudhës raportuese Janar – Shtator 2013, kjo njësi ka arritur që të publikoj gjithsej 38 Lista të punëtorëve edhe atë 8 Lista fillestare dhe 30 Lista Finale si dhe ka bërë shpërndarjen e pjesshme të 20 % për punëtorët e kualifikuar për 34 Ndërmarrje Shoqërore dhe shpërndarjen nga shitjet e mëpastajshme të aseteve.

Shuma e fondeve të shpërndara për këtë periudhë raportuese është € 7,261,783 ndërsa numri i përfituesve nga shpërndarja e këtyre fondeve është 4,400 punëtor.

Në këtë shumë bënë pjesë edhe shpërndarja e fondeve për shitjen e mëvonshme të aseteve të NSh-ve të cilat janë privatizuar në fazat e mëhershme të privatizimit.

Prej fillimit të procesit të privatizimit e deri më tani janë paguar rreth 33,000 punëtorë të Ndërmarrjeve Shoqërore.

VI. NJËSIA E RIORGANIZIMIT DHE ADMINISTRIMI I NSH-ve

Gjatë nëntëmujorit 2013, Njësia e Riorganizimit të Trepçës (NjRT), përveç mbikëqyrjes së punëve në "Trepçë", dhe raportimit tek Bordi i Drejtorëve (BiD) për të njëjtat, ka përcaktuar edhe mënyrat e komunikimit dhe raportimit ndërmjet AKP, Menaxhmentit të Trepçës, dhe institucioneve kompetente në vendimmarrje për dhe rreth çështjeve të Trepçës.
Gjatë kësaj periudhe, Trepça i ka hyrë procesit të riorganizimit në mënyrë më dinamike, proces ky i mbikëqyrur në mënyrë direkt nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (DhPGjS), i rregulluar dhe i përcaktuar në tërësi nga Ligji për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të caktuara përmes cilit AKP përcaktohet si Administratore e kësaj ndërmarrjeje.
Me këtë ligj, AKP-së si administratore - i përcaktohen edhe obligime konkrete të cilat kanë afate strikt ligjore.

Duke u nisur nga rëndësia strategjike e projektit, Agjencia është kujdesur që të kryejë të gjitha obligimet ligjore sipas mandatit që ka me Ligjin e Riorganizimit, sipas të cilit AKP obligohet të rishpall afatin për dorëzimin e kërkesave kreditore me 1 Nëntor 2013. Gjithashtu, Agjencia është e obliguar të sigurojë që Plani i Riorganizimit për Trepçën të dorëzohet në DhPGjS për aprovim më së voni deri në korrik 2014. Andaj, Agjencia duhet që menjëherë të fillojë procedurën e prokurimit të shërbimeve përkatëse, në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik.

Me 18 prill 2013, në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës është aprovuar rekomandimi përmes së cilit i kërkohet Qeverisë Republikës së Kosovës të procedojë projektligjin për Trepçën për miratim në Kuvend.

Në frymën e koordinimit ndërinstitucional për një proces kaq madhor, AKP ka informuar Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik se është para finalizimit të përgatitjeve për procesin tenderues për angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve Profesionale (OShP), të cilët do të jenë në mbështetje të AKP, si Administratore gjatë procesit të Riorganizimit të Trepçës, duke e informuar se sipas planifikimeve të bëra, dhe në përputhje me ligjin në fuqi dhe afatet ligjore, ky tender parashihet të shpallet në muajin Shtator 2013.
Andaj AKP ka kërkuar që të jetë e informuar konkretisht nëse Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka filluar hartimin e ligjit në fjalë, dhe nëse po, deri në cilën fazë është arritur.

Në pritje të një përgjigjeje konkrete nga MZhE, AKP ka shtyrë miratimin e Termave të Referencës për angazhim të OShP, deri në votimin e Projektligjit të Ri që do të duhej të bëhej nën patronatin e MZhE në korrik, 2013. Mirëpo, me mos ndryshim të Ligjit për Riorganizim, përgjegjësia ligjore për respektim të afateve strikt ligjore e obligonte AKP-në të vazhdojë me përgatitjet për procesin e riorganizimit, dhe duke marr parasysh se AKP nuk ka kapacitet për kryerjen e të gjitha detyrave të nevojshme për Riorganizimin e Trepçës, vazhdimi i procesit të tenderimit për angazhimin e OSHP-së ishte i domosdoshëm për kryerje të detyrave përbrenda afateve ligjore dhe në nivel profesional të duhur.

Andaj, në mbledhjen e mbajtur në Shtator 2013, Bordi i Drejtorëve i AKP-së duke e çmuar si esenciale për Agjencinë në mënyrë që ti përmbushen obligimet dhe objektivat e përcaktuara sipas ligjit për Riorganizim, miratoi Termat e Referencës për angazhimin e OShP në procesin e Riorganizimit të Trepçës.

NjRT gjatë ushtrimit të administrimit të Trepçës ka pasur disa sfida gjatë kësaj periudhe siç janë:

- Në maj, 2013, AKP është vënë në dijeni nga mediet elektronike lidhur me marrëveshjen për bashkëpunim afarist dhe teknik ndërmjet Konzorciumit NGP dhe përfaqësuesve të Trepçës, e sponzoruar nga Ministria e Minierave dhe resurse natyrore e Republikës së Serbisë, për të cilën marrëveshje AKP nuk është informuar, si dhe nga AKP nuk është kërkuar pëlqim paraprak. Andaj, marrëveshja eventuale është konsideruar në kundërshtim me dispozitat ligjore te aplikueshme ne Republikën e Kosovës, dhe si e tillë cenon autoritetin administrativ te AKP-së. Agjencia i është drejtuar me shkrim menaxhmentit të Trepça veri, duke kërkuar informim zyrtar për marrëveshjen eventuale, dhe ka kërkuar dokumentacion për çfarëdo marrëveshje/kontratë eventuale të nënshkruar, duke rikujtuar Menaxhmentin Veri se çfarëdo marrëveshje e arritur e cila është ne kundërshtim me ligjet e aplikueshme dhe vendimin e moratoriumit do të anulohet.
  AKP nuk posedon me marrëveshje, dhe rrjedhimisht nuk mund te pohojë ose mohojë se një marrëveshje e tillë për bashkëpunim teknik dhe investim është lidhur për minierat, flotacionin apo shkritoren e plumbit - që gjenden në veri të territorit të Republikës së Kosovës.
  AKP si administrator, në të njëjtën kohë ka njoftuar edhe DhPGjS për rastin në fjalë. Njoftimin, AKP e ka bërë në përputhje me obligimet e saja ligjore, duke u nisur nga fakti se DhPGjS si institucion gjyqësor është mbikëqyrës i zbatimit të procesit te riorganizimit dhe garantues dhe mbrojtës i interesave të kreditorëve dhe pasurisë se ndërmarrjes.

- Pas interpretimit nga DhPGjS se procesi i prokurimit në "Trepça Ndërmarrje në Administrim të AKP" nuk duhet bazuar në Ligjin për Prokurim Publik, AKP është obliguar të hartojë Draft udhëzuesin për prokurim në Trepçë, dhe të njëjtin ta dorëzon për miratim në Dhomë të Posaçme. AKP ka draftuar udhëzuesin për Prokurim dhe ka dorëzuar atë në DhPGjS për miratim. Deri në momentin e raportimit, udhëzuesi në fjalë ende nuk është miratuar.

Në ndërkohë, operacionet ditore në Trepçë janë duke u zhvilluar në mënyrë të rregullt. Në vazhdim do të pasqyrojmë rezultatet e prodhimit në "Trepça - Ndërmarrje në Administrim të AKP".

<u>Prodhimi</u>:

Prodhimi i xehes në minierat e Trepçës në pjesën jugore në vitin 2013 ka vazhduar në trend pozitiv të rritjes. Në vitin 2011,2012 dhe 2013, eksploatimi i xehes në minierat e Trepça Jug është rritur në krahasim me vitet e mëparshme kur Trepça ka rifilluar prodhimin. Prodhimi gjatë periudhës 1 Janar 2013 - 30 Shtator 2013 është më i lartë nëse krahasohet me periudhën e njëjtë të viteve të mëparshme. Prodhimi total i minierave të Trepça Jug nga 01/01/2013 deri më 30/09/2013 është 144,216 t. xehe, e që krahasuar me periudhën Jan-Sht. 2012, (119,601 t.) është 20% më i lartë.

Miniera e Stantërgut

Janar - Shtator	2009	2010	2011	2012	2013
Prodhimi (ton)	61,153	70,394	83,110	93,764	103,394

Miniera e Artanës

anar -Shtator	2009	2010	2011	2012	2013
rodhimi (ton)	20,976	7,265	7,419	5,837	0,822

Prodhimi në Stantërg nga 01/01/'13 – 30/09/'13 ka arritur në 103,394 ton xehe. Krahasuar me periudhën Jan-Shta 2012, (93,764 t) është për 10% më i lartë, gjithashtu është më i lartë krahasuar edhe me periudhën e njëjtë të viteve tjera.
Prodhimi në Artanë nga 01/01/'13 – 30/09/'13 ka arritur në 40,822 ton xehe. Krahasuar me periudhën Jan-Shtat 2012, (25,837 t) është për 58 % më i lartë, gjithashtu është më i lartë krahasuar edhe me periudhën e njëjtë të viteve tjera.

Prodhimi total i Trepça Jug: Miniera Stantërg dhe Artanë

Janar -Shtator	2009	2010	2011	2012	2013
Prodhimi në ton (t)	82,129	97,659	120,529	119,601	144,216

Prodhimi total i minierave të Trepça Jug nga 01/01/'13 deri më 30/09/'13 është rritur duke arritur një prodhim prej 144,216 ton xehe. Krahasuar me periudhën nëntëmujore të vitit 2012, prodhimi i xehes është më i lartë për 20%.

Prodhimi total i Trepça Veri: Miniera Cërnacit dhe Belo Bërdo

Prodhimi i xehes në minierat e Trepçës që gjenden pjesën veriore për periudhën 01 Janar - 31 Shtator 2013 ka ngritje prej 10% në krahasim me periudhën e njëjtë në të vitit të kaluar.

Miniera	**Cërnac**	**Belo Brdo**	**Total**
Periudha 01 Janar - 31 Shtator 2012	87,550	24,750	112,300
Periudha 01 Janar - 31 Shtator 2013	84,225	39,792	124,017

VII. DEPARTAMENTI I KOORDIMINIT RAJONAL

Departamenti i Koordinimit Rajonal bën mbikqyrjen e punës së Zyrave Rajonale të AKP-së. AKP-ja ka pesë Zyra Rajonale (ZR) në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjilan dhe Mitrovicë dhe tri zyra satelitore në Leposaviq, Shtërpce dhe Graçanicë, pra është i mbuluar i gjithë territori i Republikës së Kosovës. Këto zyre përgjegjësi kryesore e kanë grumbullimin e informatave lidhur me NSH-të në rajonet përkatëse si dhe implementimin e privatizimit, likuidimit dhe aktivitetet e qeverisjes korporative.

Mandati i ZR është zbatimi i funksioneve administrative të AKP-së lidhur me NSH-të për të siguruar që AKP-ja në mënyrë të duhur kryen obligimet e veta. ZR janë përgjegjëse për të gjitha detyrat të cilat AKP-ja ka nevojë t'i zbatoj për të siguruar realizim të suksesshëm të mandatit të vet që nuk janë rezervuar në mënyrë ekskluzive nga zyra qendrore e AKP-së apo caktuara njësive tjera funksionale të AKP-së.
Departamenti i Koordinimit Rajonal përmes pesë zyrave rajonale dhe tre zyrave satelitore, gjatë kësaj periudhe ndër të tjera ishin përgjegjëse për:

- Përgatitjen e Ndërmarrjeve të Reja dhe shitjen e aseteve përmes likuidimit sipas Biznes Planit të vitit 2013;
- Grumbullimin e shënimeve relevante për NSH-të dhe arkivimin dhe ruajtjen e tyre;
- Ndërlidhjen në mes komunave, organizatave, agjencive dhe bashkëbisedues tjerë mbi çështje që kanë të bëjnë me AKP-në;
- Çështjet financiare: monitorimi i rregullt dhe kontrolli i pasqyrave financiare të NSH-ve aktive;
- Çështjet ligjore: monitorimi i rregullt, ndihma dhe paraqitja ligjore e NSH-ve në gjykatat e rregullta kurdo që kërkohet;

Gjatën kësaj periudhe Drejtoresha e Departamentit të Koordinimit Rajonal së bashku me Menaxherët e Zyreve Rajonale përkatëse deri më tani kanë mbajtur takime me 22 Komuna të rajonit të Prishtinës, Pejës, Mitrovicës dhe Prizrenit. Takimet janë mbajtur me Drejtoritë për Pronë, Urbanizëm dhe Kadastër me ç'rast janë diskutuar/ shtjelluar aktivitetet qe e ndërlidhin punën e AKP-së dhe komunën respektove.

Në bashkëpunim me Departamentin ligjor është përgatitur Memorandumi lidhur me riorganizimin e kompetencës territoriale të zyrave rajonale në kuadër të Agjencisë Kosovare te Privatizimit ku ne baze te këtij propozimi: e para, propozohet që kompetenca e zyrës rajonale të Prizrenit të shtrihet edhe mbi ndërmarrjet shoqërore dhe asetet ne pronësi shoqërore te cilat gjenden ne Komunën e Shtërpcës. E dyta, propozohet që kompetenca e zyrës rajonale te Mitrovicës te shtrihet edhe mbi Ndërmarrjet Shoqërore dhe asetet në pronësi shoqërore të cilat gjenden në Komunën e Drenasit, dhe të hiqet nga kompetenca territoriale e zyrës rajonale të Prishtinës. Ky riorganizim hyn në fuqi duke filluar nga data 01 Janar 2014.

Privatizimi
Departamenti i Koordinimit Rajonal në mënyrë të suksesshme ka përmbushur Biznes Planin lidhur me procesin e privatizimit edhe pse është ballafaquar me probleme të ndryshme (disa prej të cilave janë cekur më poshtë).

Zyrat Rajonale kanë përgatitur dhe tenderuar 94 Ndërmarrje të Reja me "Spin Off" të Rregullt. Përgatitja e dokumenteve për tri (3) Valë të privatizimit ka përfshirë: 94 Ndërmarrje të Reja të cilave kanë përfshi

dokumentet si: Dokumentet për Informim të Bordit, Të Dhënat e Ndërmarrjeve, Miratimet për Privatizim, Memorandum Informimi, Rreziqe të Caktuara Ligjore dhe të Tjerë dhe Dhomën e të Dhënave.

Likuidimi

Me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të rifillimit të procesit të likuidimit, Zyret rajonale kanë vazhduar punën me verifikimin e të gjitha kërkesave të regjistruara në databazë, skanimet e tyre, rregullimet e arkivave si dhe insertimin e dokumenteve në databazë.

Gjate kësaj periudhe njëqind e dy (102) ndërmarrje iu janë nënshtruar procesit të likuidimit ku janë përgatitur të gjitha dokumentet dhe janë prezantuar në Bord, me që rast zyrtarët rastit kanë vazhduar punën me përgatitjen e vendimeve të lëshuara nga AL, regjistrimin e kërkesave te reja ne databazë, verifikimin e të gjitha kërkesave të regjistruara në databazë, skanimet e tyre, rregullimet e arkivave si dhe insertimin e dokumentet në databazë për të gjitha ndërmarrjet në likuidim.

Zyrat Rajonale kanë përgatitur tërë dokumentacionin për katët (4) valë të shitjes së aseteve me likuidim të cilat përmbanin 197 asete. Këto Valë të likuidimit përmbanin 197 Dokumente me të Dhëna mbi Ndërmarrjet, Memorandume Informimi për Shitjen e Aseteve me Likuidim (MIShAL), Dhomën e të Dhënave dhe CLOR.

Shqetësimet / problemet me të cilat është ballafaquar ZR gjatë periudhës raportuese

Zyrat Rajonale janë ballafaquar me disa çështje dhe probleme gjatë procesit. Disa nga çështjet ishin:

- Mungesa e dokumenteve të pronësisë dhe dokumenteve tjera të rëndësishme, të cilat vështirësonin përcaktimin e statusit të ndërmarrjes. Ky është një hap i rëndësishëm në procedurën e privatizimit;
- Mungesa e dokumenteve kadastrale si dhe shënimeve të vjetra kadastrale. Zyrat Kadastrale Komunale nuk kanë qenë mjaft bashkëpunuese me Zyrat Rajonale të AKP-së dhe vazhdimisht kanë refuzuar të azhurnojnë shënimet e veta kadastrale. Kjo drejtpërdrejtë ndikon në përgatitjen e procedurave të privatizimit;
- Ndërrimi i titullarit të pronave shoqërore – prona të cilat janë nën mandatin a AKP-së;
- Mungesa e bashkëpunimit me të ashtuquajturat enklavat e Mitrovicës veriore. Kjo drejtpërdrejtë ndikon në procesin e privatizimit pasi që aty ekziston një numër i madh i NSH-ve;
- Ndërmarrjet e uzurpuara nga institucione të ndryshme ndërkombëtare, është edhe një pengesë për Departamentin e Koordinimit dhe njëherit për privatizim dhe likuidim.

VIII. DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE BUXHETIT

Detyrat në vijim janë kryer me sukses nga Departamenti i Financave dhe Buxhetit për periudhën Janar – Shtator 2013:

Pasqyrat financiare

- Pasqyrat financiare të të Hyrave të Dedikuara, të Buxhetit të Kosovës dhe fondeve të donatorëve për vitin fiskal 2012 janë përgatitur dhe janë dorëzuar me 24 Janar 2013 në Ministrinë e Financave;
- Pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim për vitin fiskal 2012 janë përgatitur dhe janë dorëzuar më 17 Janar 2013 në Sekretariatin e Bordit të Drejtorëve dhe më 24 Janar 2013 në Ministrinë e Financave;
- Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës ka shqyrtuar dhe aprovuar Raportin Vjetor Financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës që ta aprovoj Raportin Vjetor Financiar të Agjencisë;
- Pasqyrat financiare 9 mujore sipas rregullores nr. 06/2011 për të Hyrat e Dedikuara, buxhetit të Kosovës fondeve të donatorëve për periudhën Janar – Shtator 2013 janë përgaditur dhe do të dorëzohen më 31 Tetor 2013 në Departamentin e Thesarit MF;
- Pasqyrat financiare 9 mujore për Fondet në Mirëbesim për periudhën Janar – Shtator 2013 janë përgaditur dhe do të dorëzohen më 31 Tetor 2013 në Departamentin e Thesarit MF;

Buxheti

- Bordi i Drejtorëve në Qershor 2013 ka aprovuar buxhetin vjetor për vitin 2013 dhe atë:
  - Nga të hyrat e dedikuara (kodi 23) buxheti i aprovuar është EUR 7,345,873 për
    - Paga dhe mëditje EUR 3,500,000
    - Mallëra dhe shërbime EUR 3,605,873
    - Subvencione dhe transfero EUR 80,000
    - Investime kapitale EUR 160,000.
  - Nga Buxheti i Kosovës (kodi 10) buxheti i aprovuar është EUR 4 milion.
- Me datën 11 Shtator 2013 në dëgjimet buxhetore të mbajtura në Ministrinë e Financave kemi prezantuar dhe mbrojtur kërkesën buxhetore për vitin 2014 si dhe parashikimet e hershme për vitet 2015-2016.
- Është dërguar një letër Ministrit të Financave me të cilën e kemi njoftuar se gjatë vitit 2014 parashihet që të transferohen rreth 50 milion euro në Buxhetin e Kosovës dhe atë:
  - Rreth 20 milion nga fondet tepricë të likuidimit dhe
  - Rreth 30 milion si rrjedhojë e zbatimit të memorandumit të mirëkuptimit me Administratën Tatimore të Kosovës për barrët tatimore të vendosura në asetet e ndërmarrjeve shoqërore.
- Në bashkëpunim me mbajtësit e buxhetit kemi përgatitur Kornizën Afat Mesme të Shpenzimeve (KASH) për tri vitet e ardhshme 2014-2016. KASH është dërguar në MF me datën 12 Prill 2013 të përkthyer në tri gjuhë (shqip, serbisht dhe anglisht);
- Më datën 10 Qershor 2013 në Ministrinë e Financave kemi dorëzuar kërkesën për rishikimin gjysmë vjetorë të buxhetit për vitin 2013.

- Gjatë procesit të rishikimit gjysmëvjetor të buxhetit Agjencia ka pasqyruar kursimet në shumë prej 1,079,360 për mallra dhe shërbime si dhe 7,250 për kapitale dhe transferin në programin e Administratës Qendrore në kategorinë Mallra dhe Shërbime në shumë prej 210,000.00€. Përfshirja e të dhënave nga ana e Thesarit është bërë në fillim të muajit Tetor 2013 pas dekretimit të ligjit të rishikimit gjysmëvjetor të buxhetit 2013 në fund të muajit Shtator 2013;
- Agjencia më 7 Tetor 2013 ka njoftuar Ministrinë e Financave se deri në fund të vitit 2013 Agjencia do të kursej edhe mjete që nuk planifikohen të shpenzohen.
- Këto kursime buxhetore nënkuptojnë se me zbritjen e alokimeve deri në fund të vitit 2013, buxheti i AKP-së do të jetë EUR 6,629,837.

Pagesat

- Procesimi i 2,250 transaksioneve (974 zotime dhe 1276 pagesa) përmes buxhetit vjetor të Agjencisë përmes buxhetit të të hyrave të dedikuara;
- Procesimi i 2,502 transakcioneve dalëse të fondeve në mirëbesim në BQK dhe harmonizimi i 5,074 transaksioneve (hyrëse dhe dalëse) nga fondet në mirëbesim.

Raportimet periodike

- Harmonizimi i raporteve mujore për pasqyrat financiare të Hyrave të Dedikuara me Departamentin e Thesarit, Ministria e Financave si dhe raportimi ndaj Menaxhmentit dhe Mbajtësve të Buxhetit. Raportimi në baza mujore përfshinë përiudhën Janar deri më 30 Shtator 2013. Gjithashtu raportet mujore janë paraqitur dhe në uebfaqen e AKP-së (në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze);
- Harmonizimi i raporteve mujore për pasqyrat financiare për Fondet në Mirëbesim me Bankën Qendrore të Kosovës si dhe dërgimi i Raporteve Përmbledhëse të Llogarive të Likuidimit dhe Kartelave bankare për llogaritë e Likuidimit për Zyrat Rajonale dhe Autoritetet e Likuidimit. Raportimi në baza mujore përfshinë periudhën Janar deri më 30 Shtator 2013. Raportet janë paraqitur dhe në uebfaqen e AKP-së (në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze);
- Përgatitja mujore e Përmbledhjes së Sistemit të Menaxhimit të Informatave (SMI) dhe raportimi i rregullt tek Menaxhmenti;
- Raportimet mujore në Ministrinë e Financave për faturat e papaguara;

Investime e fondeve në mirëbesim

Sa i përket investimeve të fondeve në mirëbesim, Agjencia Kosovare e Privatizimit është e orientuar në tregun e investimeve afatshkurtra siç janë depozitat deri në dymbëdhjetë muaj (12) në Bankën Qendrore të Kosovës, në bankat komerciale të Kosovës dhe në letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës (bonot e thesarit).

Afatizimi i mjeteve në Bankën Qendrore të Kosovës

Interesi i fituar gjatë kësaj periudhës Janar – Shtator 2013 është ZERO, kjo si rrjedhojë e mos investimit të mjeteve që nga Maji 2012 e deri më datën 23 Shtator 2013 në mungesë të ofertave. Kjo ka ndodhur, sipas raportimeve nga BQK, për shkak të krizës financiare e cila ka prekuar dhe tregun evropian të investimeve të parasë. Deri në Qershor 2013, Banka Qendrore nuk ka ofertuar për shkak të normave negative të kthimit të investimit.

Nga 19 Qershori 2013, BQK ka filluar të dorëzoj oferta në AKP për afatizimin e mjeteve ku pesë (5) prej tyre janë refuzuar për shkak të normave negative të interesit apo normave tepër të ulëta të kthimit të investimit. AKP-ja e ka pranuar ofertën e datës 20 Shtator 2013 të dorëzuar nga BQK për afatizimin e mjeteve në shumën prej EUR 20 milion për periudhën gjashtëmujore (24 Shtator 2013 – 21 Mars 2014) me interes vjetor prej 0.12%. Pas maturitetit të depozitit më 21 Mars 2014, interesi i fituar nga ky afatizim do të jetë gjithsej EUR 11,866.67.

Afatizimi i mjeteve në Bankat Komerciale të Kosovës

Inicimi i procedurave për vendosjen e një pjese të fondeve në mirëbesim në bankat komerciale ka filluar që nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më datën 29 Prill 2010. Versioni i parë i termave të referencave ishte përgatitur në Maj të vitit 2010, ndërsa versioni i fundit ishte dorëzuar për shqyrtim dhe aprovim nga Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e Qershorit të vitit 2010-së. Bordi në atë kohë nuk e ka aprovuar rezolutën e propozuar dhe as nuk e kishte shtyrë për në mbledhjet e ardhshme, por me rekomandimin e Departamentit të Financave dhe Buxhetit çështja është kthyer sërish për diskutim në Bordin e Drejtorëve gjatë vitit 2013. Si pjesë të hulumtimit AKP ka mbajtur takime konsultuese dhe ka pranuar informata nga bankat komerciale për mundësinë e investimeve në depozita kohor të fondeve në mirëbesim në bankat komerciale.

Në Gusht 2013 i është propozuar Bordit miratimi për investimin e një pjese të fondeve në mirëbesim dhe tarifës administrative në bankat komerciale të Kosovës. Bordi i Drejtorëve ka marrë vendim që jo më shumë se 10% e fondeve në mirëbesim të investohet në bankat komerciale në rastet kur bankat i plotësojnë kriteret financiare të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve.

Agjencia ka zbatuar procedurat përkatëse duke dorëzuar ftesat në të gjitha bankat komerciale, ka mbajtur raundin e parë të ofertave me bankat komerciale. Agjencia u ka mundësuar bankave që të ofertojnë për shumat 5 milion, 10 milion dhe 15 milion për periudhën 12 mujore. Raundi i parë i ofertimit ka përfunduar pa sukses pasi banka fituese është tërhequr nga oferta. Gjatë muajit Nëntor 2013 do të mbahet raundi i dytë i ofertimeve me bankat komerciale që plotësojnë kriteret financiare të përcaktuara nga Agjencia.

Investimi i letrave në letra me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës (bonot e thesarit)

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e datës 21 Qershor 2012 ka marrë vendim që menaxhmentit t'i lejohet diskutimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit me Ministrinë e Financave dhe Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës në menyrë që të mundësohet investimi i fondeve në mirëbesim në tregun primar dhe tregtimi në tregun sekondar të letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria.

Nuk është bërë ende ndonjë investim ose pjesëmarrje në ofertim të letrave me vlerë të Qeverisë për shkak se nuk është përfunduar me sukses përpjekja e Agjencisë për këto investime për arsyet të cilat nuk i janë të njohura Agjencisë.

Në mbledhjen e 31 Tetorit 2013, Bordi i Drejtorëve do të shqyrtoj propozimin e Departamentit të Financave dhe Buxhetit për investimin përmes bankave komerciale në letra me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Aktivitete tjera

- Më 29 Tetor 2013 Agjencia ka nënshkruar memorandumin me Administratën Tatimore të Kosovës lidhur me barrët tatimore të Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Harmonizimin e pagave për periudhën Janar – Shtator 2013 me Ministrinë e Administratës Publike;
- Janë dorëzuar në Sekretariat dy memorandume për Bordin e Drejtorëve sa i përket këshillave për pagesën e tatimit në të ardhura personale për anëtarët e Bordit për pagesat e pranuara nga AKP si dhe çështjen e pagesës së kompensimit për periudhën 21-28 Shkurt 2013;
- Procesimi i faturave për telefoni mobile për periudhën Janar – Gusht 2013 si dhe dërgimi me e-mail tek personeli i Agjencisë që kanë tejkaluar shpenzimet për telefoni mobile;
- Gjatë periudhës raportuese Janar – Shtator 2013, AKP ka faturuar INA-në në periudha mujore për periudhën nga 20 Shtator 2012 e deri më 20 Shtator 2013 në shumën prej EUR 264,000.00. Faturimi është për qiranë mujore në shumën prej EUR 22,000.00 për shfrytëzimin e depove në Bardhosh. Shuma e pa paguar nga INA është EUR 22,000.00 për periudhën mujore 20 Gusht 2013 – 20 Shtator e faturuar më datën 5 Shtator 2013. Deri në periudhën raportuese, janë paguar tatimet prej EUR 21,780.00 në Administratën Tatimore të Kosovës për të hyrat e realizuar nga qiraja në shumën prej EUR 242,000.00.

Pasuritë

Pasuritë e Agjencisë të blera nga fondet e buxhetit dhe pasuritë e dhëna donacion janë mbajtur në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 21/2009 të Ministrisë së Financave. Detaje lidhur me pasuritë janë shpalosur në tabelat financiare dhe shënimet shpjeguese.

Auditimet

- Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka dorëzuar raportin e auditorit për Pasqyrat financiare vjetore të vitit 2012 për buxhetin vjetor dhe për fondet në mirëbesim. ZAP-i ka dhënë opinion të kualifikuar lidhur me cështjen e pagesave për procesin e likuidimit. Agjencia ka paraqitur me shkrim ZAP-it argumentet dhe mospajtimet lidhur me këtë opinion.
- Njësia e Auditimit të Brendshëm të AKP-së (NJAB) ka kryer auditimin e Departamentit të Financave dhe Buxhetit për periudhën Korrik 2011-Shtator 2012. Raporti Final është dorëzuar, përderisa është përpiluar Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të NJAB-së;
- Njësia e Auditimit të Brendshëm ka filluar auditimin në Departamentin e Financave dhe Buxhetit prej 1 Tetor 2012 e deri më 30 Shtator 2013;

Pagesat ndaj Ofruesit të Shërbimeve Profesionale për likuidimin e NSH-ve:

Që nga Tetor i vitit 2012 kanë filluar pagesat ndaj "Deloitte" e cila e është kontraktuar për të ofruar shërbime profesionale si pjesë e Autoritetit të Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Janë dy lloje të pagesave: fikse (kuartale) dhe variabile sipas vendimeve të shqyrtuara të kreditorëve.

Kostoja fikse:
Shuma totale e kostos fikse për pagesë ndaj "Deloitte" deri në përfundim të kontratës është EUR 4.9 milion. Kjo shumë do të paguhet nga secila NSh në likuidim sipas metodës fikse të përshkallëzuar e të aprovuar nga Komiteti Drejtues i Projektit për kontratën me OSHP-në për likuidimin e NSH-ve.

Gjithsej shuma e paguar deri në datën raportuese është EUR 1,964,814.40 dhe atë:
- gjatë vitit 2012 shumën prej 1,228,009 (982,407.20 pagesë pas dorëzimit të raportit fillestar dhe për kuartalin e parë Shtator – Dhjetor 2012 janë paguar 245,601.80); dhe
- gjatë përiudhës Janar – Shtator shumën prej 736,350.40 për tre kuartale (secili nga 245,601.80).

Fillmisht kostoja fikse paguhet nga llogaria e tarifës administrative së Agjencisë dhe më pastaj mjetet i kthehen tarifës administrative nga secila llogari e NSh-së në likuidim pas përcaktimit të numrit të kërkesave të kreditorëve dhe shumës së shitjeve për secilën ndërmarrje. Për të gjitha pagesat e realizuara nga llogaria e tarifës administrative, mjetet e kthyera në tarifën administrative nga llogaritë e NSh-ve në likuidim janë gjithsej EUR 117,750.

Kostoja variabile:
Ofruesi i shërbimeve profesionale "Deloitte" e kontraktuar nga Agjencia ka shqyrtuar vlefshmërinë e kërkesave të kreditorëve dhe për të cilat deri në datën raportuese ka faturuar për 15,125 vendime (pranim/refuzim të kërkesave të kreditorëve) për të gjtha llojet e kërkesave të kreditorëve (sipas ligjit të AKP-së me nr. 04/L-034, neni 40). Shuma e paguar për shqyrtimin e këtyre kërkesave gjatë periudhën Janar – Shtator 2013 është gjithsej EUR 1,234,700 dhe atë :

1) Neni 40.1.5, kërkesa për pronësi të aseteve shumën prej EUR 17,940 për 75 vendime të marrra;
2) Neni 40.1.6.1 kërkesa për paga të pa paguara shumën prej EUR 770,854 për 9,733 vendime të marra;
3) Neni 40.1.6.2 kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës shumën prej EUR 288,605 për 3,644 vendime të marra;
4) Neni 40.1.7 kërkesa të pasiguruara shumën prej EUR 120,226 për 1,518 vendime të marra; dhe
5) Neni 40.1.8 kërkesa e pronarëve apo aksionarëve shumën prej EUR 37,076 për 155 vendime të marra.

Sipas kontratës, së pari faturohet dhe paguhet vetëm 80% e shumës së kontraktuar dhe pjesa prej 20% paguhet pasi që të ketë kaluar afati kohor për ankesë në Dhomës e Posaçme të Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës. Për ato ankesa të cilat janë dorëzuar kërkesa brenda afatit kohor, 20% paguhet pas përfundimit të shqyrtimit të kërkesës nga DhPGjSK.

Detaje tjera lidhur me aktivitetet financiare të Agjencisë

Detaje tjera lidhur me aktivitetet financiare të Agjencisë janë shpalosur në tabelat financiare dhe Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare të Buxhetit Vjetor dhe në tabelat financiare dhe Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim.

IX. DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor (DL) i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ("Agjencia") siguron organizim efektiv dhe efikas duke e ndarë punën në njësi të veçanta, të cilat janë nën zbatimin e ligjit dhe rregulloret e përgjithshme të Agjencisë, duke përfshirë këtu udhëzimet e Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit në përgjithësi. DL siguron që puna dhe aktiviteti i këtij departamenti janë ushtruar në pajtim me mandatin dhe objektivat e Agjencisë. Për të realizuar me sukses punën dhe detyrat e saja, departamenti është ndarë në njësi punuese, duke organizuar dhe ndarë punët dhe përgjegjësitë në njësi përkatëse. DL ofron shërbime ligjore për aktivitetet e Agjencisë përfshirë privatizimin, likuidimin, prokurimin dhe rastet specifike të Trepçës.

DL ofron organizim efektiv duke ndarë punët e saja në njësitë e saja të veçanta.

Në vijim janë sqaruar aktivitetet bazuar në sipas njësive në Departamentin Ligjor:

1. Njësia për Përfaqësime në Gjykatë(NjPGj);
2. Njësia për Opinione Ligjore(NjOL);
3. Njësia për Regjistrimin e Ankesave (NjRA);
4. Njësia për Shqyrtimin e Ankesave të 20% (NjShA); dhe
5. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të Punëtorëve (KShALP).

DL shërben si departament ombrellë për Komisionin Shqyrtues për Ankesat e Listave të Punëtorëve (KShALP), megjithëse ky komision vepron në mënyrë autonome dhe i raporton vetëm Bordit të Drejtorëve të Agjencisë.

1. Njësia për Përfaqësime në Gjykatë(NjPGj)

1.1. Në vazhdim po ju paraqesim raportin gjithëpërfshirës të lëndëve dhe veprimeve procedurale si vijon:

- Numri i përgjithshëm i lëndëve të pranuara: 351
- Veprimet procedurale të ndërmarra në lëndë:
  - Përgjigje në urdhër gjithsej 81;
  - Pjesëmarrje në seancë gjyqësore gjithsej 21;
  - Ankesa gjithsej 11;
  - Mbrojtje në padi gjithsej 283;
  - Përgjigje në ankesë gjithsej 41;
  - Përgjigje në urdhër paraprak gjithsej 53;
  - Përgjigje në përgjigje gjithsej 70;
  - Parashtresa gjithsej 55;
  - Kërkesë për mbrojtje te ligjshmërisë gjithsej 1;
  - Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë gjithsej 1; dhe
  - Kërkesë për veprim gjithsej 1.

1.2. Në vazhdim paraqesim raportin e lëndëve dhe veprimeve procedurale të ndërmarra nga njësia e përfaqësimeve gjyqësore, në çështjet lidhur me listat e punëtorëve:

- Numri i përgjithshëm i lëndëve të pranuara: 824
- Veprimet procedurale të ndërmarra në lëndë:
  - Përgjigje në urdhër, gjithsej 61;
  - Pjesëmarrje në seancë gjyqësore, gjithsej 6;
  - Ankesa, gjithsej 10;
  - Aktgjykim, gjithsej 37;
  - Përgjigje në ankesë, gjithsej 666 (677 ankues);
  - Parashtresa, gjithsej 5;
  - Aktvendim, gjithsej 22; dhe
  - Pjesëmarrje në Seanca: 7 në Podgoricë.

2. Njësia për Opinione Ligjore(NjOL)

Përgjatë periudhës raportuese (janar 2013 – shtator 2013), kjo njësi ka ushtruar aktivitetet në vijim:

- Ka ofruar opinione ligjore për 41 Kërkesa për Veprim dhe kërkesa tjera të njësive dhe departamenteve brenda Agjencisë.
- Njëkohësisht sipas nevojave dhe kërkesave, kjo Njësi në mënyrë aktive ka marrë pjesë në draftimin e përgjigjeve të ndryshme në letra dhe kërkesa të ndryshme të institucioneve publike dhe personave fizik dhe juridik, në analizimin e ndryshimin e rregullativës së brendshme juridike të Agjencisë, në shqyrtimin juridik të kontratave të ndryshme dhe akteve tjera juridike. Numri i përgjithshëm i këtyre veprimeve juridike është: 37 të veprime të tilla juridike.

Përveç përformancës në përmbushjen e rregullt të detyrave të përcaktuara me vendin e punës zyrtarët e NJOL kanë qenë të angazhuar edhe në një varg të Komisioneve brenda Agjencisë dhe Grupeve Punuese të kohëpaskohshme.

Zyrtarët e NjOL-it janë anëtarë të këtyre komisioneve:

1. Komisioni për Komasacion:
2. Komisioni Vlerësues për Regjistrimin e Ofertuesve të Kualifikuar: dhe
3. Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave për Përcaktimin e Statusit të Ndërmarrjeve (KPS):

Kjo Njësi sipas nevojës dhe kërkesave ka realizuar takime zyrtare në vazhdimësi me institucione të ndryshme publike dhe gjyqësore.

Nga Zyrtari kompetent i angazhuar me shqyrtimin e KPS-ve në bashkëpunim me Drejtorin e DL janë shqyrtuar 19 KPS dhe të cilët janë aprovuar dhe 12 KPS janë paraqitur në Bordin e Drejtorëve për aprovim final, për të cilët ka qenë e domosdoshme që të publikohen dhe të njoftohen të gjithë kreditoret te njohur.

3. Njësia për Regjistrimin e Ankesave (NjRA)

Njësia për Regjistrimin e Ankesave (NjRA Janar- Shtator 2013 ka regjistruar 3,740 parashtresa, të cilat janë dorëzuar nga palët e ndryshme dhe gjykatat e Kosovës, lidhur me kërkesa apo lëndë gjyqësore të drejtuara kundër Agjencisë dhe NSH-ve të administruara prej sajë.

Në NjRA gjatë kësaj periudhe Janar- Shtator ka regjistruar dhe proceduar mbi 2.465 kërkesa/lëndë të reja dhe 1,285 dokumente/parashtresa shtesë lidhur me lëndët e regjistruara më herët; pra të dhënat në total janë pranuar dhe proceduar, gjithsej prej 3,740 parashtresa.

Përpos regjistrimit dhe procedimit të lëndëve, në këtë njësi janë kryer dhe aktivitete në vazhdim:

- janë pranuar mbi 140 Njoftime të palëve sipas nenit 29 dhe 30 të Ligjit të AKP-së, mbi qëllimin e tyre për inicim të procedurave gjyqësore kundër AKP-së dhe NSH-ve të ndryshme;
- 949 kërkesa lidhur me likuidimin ose ndaj NSH-ve në likuidim;
- 17.371 kopje fizike të lëndëve të ndryshme janë radhitur sipas regjistrimit në system;
- 732 Dërgesa me postë dhe 1.207 dërgesa janë dorëzuar tek personat direkt;
- Informata palëve dhe aktivitete të tjera në ndihmë të njësive dhe departamenteve të Agjencisë;
- Rreth 11.2015 lende/ kërkesa qe kanë të bëjnë me 100 NSH në likuidim, të ndara në 2 grupe, (Grupi i pare me 4 nëngrupe dhe Grupi i dytë me 6 nëngrupe) janë përgatitur dhe dorëzuar tek Autoritetet e Likuidimit deri ne fund te Shtatorit 2013;

Më poshtë është tabela e kërkesave të reja të regjistruara në bazën e të dhënave të Njësisë për ankesa.

Select Date Logged Range: 1/1/2013 9/30/2013 Go

Drag a column header here to group by that column

#	Number of Claims	Claim Type
	9	A = Ownership of SOE
	360	B = Ownership of SOE asset
	757	Banesat
	1	C = Creditor (secured) of SOE
	288	D = Creditor (unsecured)-wages
	203	E = Creditor (unsecured)-other
	1	F = HPD - flats
	98	G = Other
	15	H = Rules of Tender
	733	I = Workers List
	Total Sum=2465	

4. <u>Njësia për Shqyrtimin e Ankesave të 20% (NjShA)</u>

Sekretariati i KSHALP-së vepron si njësi e veçantë e DL dhe është i përbërë nga Udhëheqësi i Sekretariatit, Zyrtarët për Lista te Punëtorëve dhe zyrtarët administrativë. Krahas veprimtarisë së përditshme, Sekretariati i KSHALP-së bënë shqyrtimin e ankesave dhe te kundërshtimeve te paraqitura ndaj Listës Fillestare të punëtorëve e cila liste shpallet nga Njësia e Listave te Punëtorëve ne kuadër te Departamentit te Koordinimit te Likuidimit. Sekretariati i KSHALP-së i paraqet rekomandimet kSHALP-se për vendimmarrje përfundimtare.

KSHALP-ja e ushtron aktivitetin e saj duke u bazuar ne legjislacionin ne fuqi ndërsa aspektet procedurale janë te rregulluara me Rregullat e Procedurës te KSHALP-se te aprovuara nga ana e Bordit te Drejtoreve te AKP-se.

Varësisht nga kapaciteti i publikimit të Listave Fillestare nga Departamenti i Likuidimit, për këtë periudhë raportuese KSHALP ka rishqyrtuar 944 ankesa për 16 NSH.

Gjatë periudhës raportuese, Sekretariati i KSHALP ka përgatitur draft vendime për refuzimin e ankesave për 16 NSH. Po ashtu gjatë kësaj periudhe janë mbajtur edhe seanca dëgjimore me Menaxhmentin e Ndërmarrjeve Shoqërore me arsyetim rreth funksionimit të ndërmarrjeve para privatizimit dhe rreth përgatitjes se Listave Fillestare për 13 Ndërmarrje te shqyrtuara në këtë periudhë ndërsa. Ndaj listave te punëtorëve për 3 Ndërmarrje Shoqërore nuk ka pasur fare ankesa në KSHLP.

5. <u>Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të Punëtorëve (KShALP)</u>

• KSHALP gjatë kësaj periudhe ka shqyrtuar ankesat për 16 NSH si në vijim:

a. Fabrika e Radiatorëve “Jugoterm” në Gjilan 6
b. Qumështorja Konzume në Fushë Kosovë,.....17
c. Uzina e Përpunimit të Kromit “Deva” në Gjakovë 1
d. Gjeravica në Deçan 201
e. Fabrika e Letrës – Lipjan.....234
f. Prodhimtaria Bimore- Irzniq.....0
g. Termovent- Lipjan.....3
h. Kluz- Drenas.....23

i. KB “Rugova”- Drelaj.....1

j. Zhupa- Reqan 2

k. Përparimi – Podujevë.....0

l. Fonderia-Metaliku Emajl në Gjakovë.....0

m. Ereniku-Industria, Fabrika e Lëngjeve -Gjakovë.....20

n. Industria e Baterive “IBG” – Gjilan.....314

o. Enti për Medicinë dhe Rehabilitim “Banja e Pejës” – Istog.....65

p. FBI “Trepça” Fabrika e Baterive Industriale në Pejë..... 57

Gjithsejtë: 944 ankesa

• Shqyrtimi i vendimeve për refuzimin e ankesave për 16 NSH-të e theksuara me lartë: 568 vendime.

• Mbajtja e seancave dëgjimore për ankuesit të cilët kanë kërkuar që të mbështesin ankesat e tyre me prova shtesë, e në përputhje me nenin 30, të Rregullave të Procedurës: 15 seanca.

X. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Me qëllim të ofrimit te kushteve sa më të mira infrastrukturore dhe mundësimin e arritjes së objektivave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Departamenti i Administratës ka ndërmarrë shumë hapa të rëndësishëm dhe ka realizuar një punë voluminoze.

Në kuadër të Departamentit të Administratës bëjnë pjesë këto Njësi:

1. Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme;
2. Njësia e Burimeve Njerëzore;
3. Njësia e Arkivit;
4. Njësia e Përkthimeve;
5. Njësia e Teknologjisë Informative; dhe
6. Zyra e Protokollit.

Më poshtë do paraqesim aktivitetet kryesore për këtë periudhë të raportimit

Njësia e Përkthimeve

Gjatë kësaj periudhe nga Njësia e Përkthimeve janë përkthyer 1,418 dokumente me gjithsej 7,627 faqe dhe asistimi në shumë përkthime të drejtpërdrejta, si në takime të ndryshme me palë të interesuara, në mbledhjet e Bordit si dhe në ditët e shitjeve;

Njësia e Protokolit

Që nga futja në funksion e Zyrës së Protokollit, janë regjistruar këto punë:

1. Janë pranuar si dokumente hyrëse në këtë zyrë 1,092 shkresa;
2. Shkresa dalëse janë regjistruar 995;
3. Të regjistruara në sistem hyrje/dalje dhe të skanuara janë 2,087;
4. Numri i pranimeve me postë 2,768;
5. Numri i dërgimeve me postë 712;
6. Numri i dërgimeve me Libër Personal brenda AKP-së 1,778;
7. Numri i dërgimeve me Libër jashtë AKP-së 50.

Njësia e Teknologjisë Informative

1. Instalimi i databazës për përgatitje të zyrës protokollare;
2. Pajisjet nga donacioni që janë në gjendje të rregullta janë kontrolluar për tu evidentuar;
3. Instalimi i disa pajisjeve për server nga malli i donacionit;
4. Certifikata elektronike e e-mail serverëve është kontraktuar nga AKP-ja dhe instaluar me validitet deri ne vitin 2016;
5. Akomodimi i zyrtareve gjatë ndërrimit të zyrave është një aktivitet shtesë qe vlen te përmendet;
6. Është nisur procedura për servisimin e Pajisjeve te TI-së ,fotokopjeve, dhe marrjes me qira të fotokopjeve;

7. Është iniciuar identifikimi i nevojave te pajisjeve te TI-se me te dhëna te freskuara nga gjendja aktuale ne Regjione;
8. Ka përfunduar procedura për servisimin e Pajisjeve te TI-së ,fotokopjeve, dhe marrjes me qira të fotokopjeve;
9. Janë identifikuar nevojave për furnizim pajisjeve të TI-së me të dhëna të freskuara nga gjendja aktuale në Regjione;
10. Është në përfundim plani për furnizim të pajisjeve të TI-së;
11. Janë konfiguruar fotokopjet me cilësi te skanerit (me funksionalitet te njëjtë me digjital sender) në te gjitha zyrat regjionale;
12. Upgrade i kompjuterëve në sistemin Office2007 në të gjithë kompjuterët;
13. Inicimi i procedurës për furnizim me pajisje të TI-së – pajisje me vlerë kapitale;
14. Është analizuar gjendja e softuerit të protokollimit të dokumenteve (që është instaluar qysh në janar) dhe konsultuar për ndryshimet që duhet përgatitur për të filluar puna e zyrës së protokollit;
15. Është plotësuar softueri për nevojat e zyrës protokollare. Kontraktori i shërbimeve ka realizuar trajnimin bazik për zyrën protokollare;
16. Është përcjellë dhe realizuar me sukses transmetimi i ceremonisë së shitjes në sallën e kuqe;
17. Inicimi i procedurës për furnizim me pajisje të TI-së;
18. Vazhdimi dhe zgjerimit të rrjetës për të minimizuar problemet me IP adresa;
19. Implementimi i plotë i rangut të ri të IP adresave me të cilën është eliminuar rreziku i mungesës së tyre dhe humbjes së rrjetit të përdoruesit;
20. Identifikimi i pajisjeve të IT-së që nuk janë të përdorshme dhe transferimi i tyre në stok;
21. Implementimi i FIBER koneksionit që do të përmirësojë lidhjet me regjione;

Njësia e Burimeve Njerëzore

1. Është bërë azhurnimi dhe konfirmimi si dhe janë dërguar për ekzekutim në baza mujore Listat e Pagave në Departamentin e Financave dhe Buxhetit;
2. Është finalizuar Procesi i Rekrutimit dhe Selektimit për 14 (katërmbëdhjetë) pozita të lira;
3. Në zhvillim e sipër Procesi i Rekrutimit dhe selektimit për 2 (dy) pozita;
4. Kanë dhënë dorëheqje 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës;
5. Është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve "Rregullorja për Zhvillimin e Punonjësve dhe Ngritje të Kapaciteteve" e përpiluar nga NJBNJ;
6. Për shkak të ndryshimit të rrethanave aktuale dhe zhvillimeve të brendshme në Agjenci sa i përket lëvizjeve/ transfereve të stafit, është rishqyrtuar dhe modifikuar Plani i Trajnimeve të Agjencisë për pjesën e dytë të vitit kalendarik 2013 dhe i njëjti do të dorëzohet për aprovim te Drejtori Menaxhues;
7. Është koordinuar pjesëmarrja në Trajnimet e mëposhtme:
   - Trajnim gjashtë (6) ditorë "Trajnimi hyrës për BE" (të sponsorizuar nga IKAP) për 2 zyrtarë të AKP-së;
   - Trajnim "Programi i Qeverisjes Korporative për 6 zyrtarë të Agjencisë. Trajnimi i ofruar nga RTC në partneritet me International Finance Corporation (IFC) përmban 4 module dhe do të organizohet në 8 seanca;
   - Trajnimi dy (2) ditorë në fushën "Administratë dhe Legjislacion" në temën "**Etika dhe Antikorrupcioni në administratë publike**" (të sponsorizuar nga IKAP) për 1 zyrtarë të AKP-së;

- Trajnimi katër (4) ditor: "**Trajnimi profesional për Arkivat**" të ofruar dhe sponsorizuar nga IKAP;
- Trajnim dymbëdhjetë (12) ditorë "Motion graphics/ Adobe after effect", i ofruar nga INNOVATION CENTRE KOSOVO (ICK) për 1 zyrtarë të AKP-së;
- Program Certifikues për Menaxhment i ofruar nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) dhe ËIFI Austria, për 3 zyrtarë të AKP-së;

8. Në përkrahje të programit " Trajnim dhe Praktikë për Studentët e dalluar të UP-së " i cili është një bashkëpunimi i USAID/KPEK dhe AFAS, është aranzhuar fillimi i praktikës për 25 studentë të këtij programi në të gjitha zyrat rajonale dhe departamentet e AKP-së;
9. Është menaxhuar procesi i Vlerësimit të Performancës për vitin 2012, Planet individuale të punës si dhe Planet Individuale të Zhvillimit për vitin 2013 të punonjësve (përpilimi i Udhëzuesit Intern të Agjencisë mbi Menaxhimin e Performancës, modifikimi i formularëve relevant, informimi/ këshillimi dhe pajisja e punonjësve me të njëjtat, kolektimi, selektimi, popullimi i bazës së të dhënave, kalkulimi i mesatares në baza individuale si dhe përgatitja e raportit vjetor;
10. Është përgatitur materiali prezantues mbi **Rregulloren e re Nr. 19/2012 Për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil,** i cili planifikohet gjatë këtij viti kalendarik të prezantohet tek punonjësit e Agjencisë përfshirë këtu edhe stafin menaxherial të Agjencisë;
11. Janë kryer të gjitha përgatitjet (modifikimi dhe adaptimi i formularëve) për fillimin e implementimit në vitin kalendarik 2013 të Rregullores së re Nr. 19/2012 Për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil;
12. Në muajin qershor ka filluar së aplikuari softueri për menaxhimin e Burimeve Njerëzore; (implementimi sipas moduleve, aftësimi/ trajnimi i zyrtareve të BNJ, popullimi i bazës së të dhënave, testimet, etj);
13. Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancat dhe është në proces të shqyrtimit të 2 (dy) lëndëve;
14. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka shqyrtuar gjithsejtë 5 (pesë) ankesa që i janë adresuar;
15. Është dërguar në Këshillin Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Pyetësori për Respektimin e Ligjit të LSHCK për vitin2013 nga AKP;
16. Komisioni për shqyrtimin e pagës së nëpunësve ka shqyrtua 2 (dy) raste;
17. Komisioni për azhurnimin e rregullores së personelit ka përfunduar punën dhe ka dërguar për Draft Rregulloren për komente te menaxhmenti;
18. Komisioni për hartimin e rregullores për pagat e nëpunësve të Agjencisë ka përfunduar punën dhe ka dërguar te Menaxhmenti për komente Draft Rregulloren e Pagave;

<u>Njësia e Arkivit</u>

1. Regjistrimi i dokumentacionit të AKM-së dhe AKP-së në softuerin e Arkivit;
2. Dokumentacioni i skanuar, regjistruar dhe arkivuar 185 regjistrator të Departamenteve të ndryshme të AKP-së;
3. Kutitë me oferta të Privatizimit, të skanuara, regjistruara dhe arkivuara, gjithsej 242 kutia;
4. Dokumentacioni i parakualifikimit, 25 regjistratorë të skanuar, regjistruar dhe arkivuar;

5. Kontratat e privatizimit të skanuara, regjistruara dhe arkivuara, gjithsej 87 kontrata si dhe të valës 16,17,18 dhe 19;
6. Kërkesat për dokumentacion, gjithsejtë 75 kërkesa;
7. Libra të protokollit të arkivuar, 14 libra, dhe 14 Libra të Postës;
8. 1 CD e arkivuar, Pasqyrat Financiare Janar-Dhjetor 2012, Departamenti i Buxhetit dhe Financave;

Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme

1. Dokumentacioni i azhurnuar, Njësia e Marketingut, gjithsejte 54 HQ
2. Përgatitja e Rregullores së Hyrje-Daljes në ndërtesën e AKP-së (kërkesë nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale)
3. Janë protokolluar 780 fatura nga të gjitha Departamentet dhe njësitë e AKP-së dhe janë dorëzuar në Departamentin e Financave për pagesë
4. Janë mbuluar 807 kërkesa për furnizim me material administrativ,
5. Janë mbuluar 1286 kërkesa zyrtare për transport me veturat zyrtare të AKP-së, si dhe riparimet e shumta të imta në objektet e AKP-së;
6. Gjatë periudhës Janar-Korrik 2013 janë pranuar në recepcion 4439 dokumente të cilat janë protokolluar dhe skanuar, po ashtu janë protokolluar dhe skanuar 392 dokumente të cilat kanë qenë dalje nga AKP;
7. Në mënyrë që të kemi material administrativ të nevojshëm për punën e përditshme, është iniciuar procedurën për furnizim me material administrativ, është nëNShkruar dhe furnizohemi në bazë të daljeve te stafi nga depo qendrore nga Shkurt 2013;
8. Është rregulluar Zyra e Pritjes për Anëtarët e Bordit të AKP-së;
9. Është iniciuar deklarata e nevojave për furnizim me pajisje për zyrë, me të cilat po ashtu jemi furnizuar dhe është bërë shpërndarjen sipas nevojave të zyrtarëve;
10. Është iniciuar deklarata e nevojave për furnizim me pajisje elektrike dhe sanitare për nevoja të AKP-së, me të cilat jemi furnizuar sipas kërkesës Maj 2013;
11. Është bërë organizimi administrativ për takimin e mbledhjes ekzekutive dy ditore të AKP-së në Maj 2013;
12. Është iniciuar deklarata e nevojave dhe është nënshkruar kontrata për ofrimin e pajisjeve për zerim dhe përkthim simultan Gusht 2013;
13. Është iniciuar deklarata për furnizimin me pajisje për rregullimin e zyrës së pritjes për palë dhe për gazetarë Gusht 2013;
14. Është iniciuar deklarata për furnizimin me naftë për ngrohje qendrore dhe Gjenerator për nevoja të AKP-së, presim nëNShkrimin e Kontratës nga Departamenti i Prokurimit Gusht 2013;
15. Është iniciuar deklarata e nevojave për servisimin dhe mirëmbajtjen e ngrohjeve qendrore dhe gjeneratorëve në zyrat e AKP-së Shtator 2013;
16. Është monitoruar ndërtimi i dy zyrave kontejner për ofruesin e shërbimeve duke u bazuar në kërkesës se Menaxhmentit.

XI. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Gjatë periudhës raportuese Janar – Shtator 2013 janë nënshkruar kontratat e mëposhtme:

1. Regjistrimi ,sigurimi dhe sigurimi Casco i automjeteve
2. Furnizim me material higjenik
3. Furnizim me material administrativ
4. Lidhja e kontratës për objektin me qira ne Leposaviq
5. Shërbime te jashtme te përfaqësimit ne DHPGJS
6. Mirëmbajtja e databazes se Njësisë për Ankesa te Departamentit Ligjor
7. Emetimi i TV Reklamave
8. Lidhja e kontratës me gazetën serbe dhe malazeze
9. Certifikata për Serverë SSL (Secure Socket Layer) për 3 vite
10. Furnizim me trëndafila për festen e 8 Marsit
11. Furnizim me pajisje dhe renovimi i zyrës
12. Prerja e grilave dhe vendosja e laurës ne hyrje te AKP-se
13. Pjesëmarrja ne panairin Citizens Information Fair – Prishtine
14. Furnizimi me pajisje sanitare,elektrike dhe të punës
15. Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve te TI-se, fotokopjeve dhe marrja shtese e fotokopjeve me qira
16. Furnizim me pajisje për zyrë
17. Blerja e rekuizitave për anëtaret e ekipit te futbollit qe përfaqësojnë AKP-ne ne Federatën Sportive te Punëtoreve te Kosovës
18. Lidhja e kontratës me Gazetën Ndërkombëtare " The Economist"
19. Lidhja e kontratës me zyrën satelitore ne Shtërpcë
20. Furnizim me tonerë
21. Xhirimi dhe emetimi i drejtpërdrejt i Ceremonisë se Dorëzimit dhe pranimit te ofertave
22. Shërbimet e shpejta postare
23. Mirëmbajtja e Air Kondicionerëve dhe furnizimi me Air Kondicioner
24. Furnizim me Pajisjet e TI-se
25. Vlerësimi i investimeve te bëra Neë Co"
26. Rezervimi i hapësirës për Uebfaqen, emri për faqen e AKP-se, emri për faqen e AKM-se, Arkiva, mirëmbajtja dhe përkrahja teknike
27. Furnizim shtese me tonerë, vlera 10 % e kontratës baze
28. Aneks kontrata 10% e kontratës baze Lidhja e kontratës me te gjitha gazetat ditore te Kosovës; Koha Ditore, Express, Kosova Sot, Epoka e Re, Zëri, Tribuna, Bota Sot dhe Lajmi
29. Servisimi dhe mirëmbajtja e Gjeneratorëve dhe Ngrohjeve Qendrore
30. Prodhimi dhe shtypja e biznes kartelave
31. Vazhdimi i kontratës për objektin me qira për Zyrën Graçanicë
32. Auditimi i ndërmarrjes se privatizuar me kushte Neë Co,, Llamkos ’’Vushtrri
33. Furnizim me shtypin ditor
34. Furnizim me radiator elektrik
35. Kontrate me revistën IP Magazina; dhe
36. Publikimi i reklamave/njoftimeve ne portale.

XII. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) më sukses ka arritur që të përmbushë planin e vet të punës për periudhën Janar-Shtator 2013, duke i ofruar menaxhmentit tw lartw rekomandime konkrete në drejtim të forcimit të kontrollit të brendshëm në AKP.

Gjatë këtij viti NJAB-ja pritet ta kryej edhe auditimin mbi përcjelljen e implementimit të rekomandimeve.

Në vazhdimësi paraqiten aktivitetet e NJAB-së gjatë kësaj periudhe:

1. **Auditimi i Njësisë së Burimeve Njerëzore:** Ky auditim është zhvilluar përgjatë periudhës Janar-Mars 2013. Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me procesin e rekrutimit të personelit, procedurat e vlerësimit të punëtorëve, mirëmbajtja e dosjeve të personelit, puna e Komisionit Disiplinor dhe Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, etj. Bazuar në të gjeturat e auditimit dhe konkluzionet e dhëna, ky auditim ka rezultuar me 22 rekomandime përkatëse.

2. **Auditimi i Divizionit të Shitjes:** Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar kryesisht në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me Divizionin e Shitjes, përkatësisht të njësisë së Administrimit Direkt dhe Njësisë së Kontrollit dhe Mbikëqyrjes. Auditimi në fjale kishte rezultuar disa të gjetura, për të cilat ekipi i auditimit ka dalë me rekomandimet përkatëse. Numri i rekomandimeve të dhëna në këtë auditim ishte gjithsej 10 rekomandime, ndërsa procesi i përcjelljes së implementimit të tyre do të vazhdojë gjatë vitit 2013.

3. **Auditimi i Departamentit të Koordinimit Rajonal (Zyra Rajonale e Prishtinës):** ky auditim është finalizuar në muajin Gusht. Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me procesin e dhënies së objekteve (lokaleve) me qira në ZRP, implementimin efektiv të vendimeve të Bordit dhe Menaxhmentit nga ana e Departamentit të Koordinimit Rajonal gjegjësisht Zyra Rajonale e Prishtinës si dhe aktivitetet tjera të ndërmarra nga kjo zyre. Rezultatet e dala nga ky auditim, konsistojnë në 11 rekomandime përkatëse, të cilat janë pranuar pothuajse në tërësi nga ana e menaxhmentit. Përcjellja e implementimit të këtyre rekomandimeve do të bëhet gjatë vitit 2013, ndërsa për rekomandimet të cilat ende nuk janë implementuar procesi i përcjelljes së implementimit të tyre do të vazhdoj edhe gjatë vitit 2014.

4. **Auditimi i Departamentit Ligjor**: Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar kryesisht në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me Departamentin Ligjor. Auditimi i Departamentit Ligjor kishte rezultuar me disa të gjetura, për të cilat ekipi i auditimit kishte dhënë gjithsej 5 rekomandime. Përcjellja e implementimit të këtyre rekomandimeve do të bëhet gjatë vitit 2013, ndërsa për rekomandimet të cilat ende nuk janë implementuar procesi i përcjelljes së implementimit të tyre do të vazhdoj edhe gjatë vitit 2014.

5. **Auditimi i Departamentit të Prokurimit**: duke u bazuar në planin e punës se NJAB-it, ky auditim ka filluar në muajin Shtator. Auditimi në fjalë është përqendruar në rishikimin e procedurave për aktivitetet e prokurimit publik, duke përfshirë përgatitjen e planit të punës, përgatitjen e dosjes së tenderit, vlerësimin e kontratave publike, specifikimet teknike, reklamimin dhe transparencën, udhëheqjen me procedurat e prokurimit dhe kërkesat mbi përshtatshmërinë, pagesat, përmbarimi i

kontratës, etj. Auditimi i Departamentit të Prokurimit është në fazën e Draft-Raportit, dhe i njëjti pritet që të finalizohet në fillim të muajit Nëntor.

6. **Auditimi i Departamentit të Financave dhe Buxhetit (DFB):** Duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it, ky auditim ka filluar në muajin Shtator. Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me procesin e planifikimit dhe realizimit të Buxhetit të AKP-së, besueshmëria e transaksioneve financiare dhe përputhshmëria e tyre me kërkesat ligjore, shpenzimi i parasë publike konform Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe rregullave financiare në fuqi. Auditimi në fjalë është në fazën e zhvillimit të testimeve, dhe i njëjti pritet që të finalizohet gjatë muajit Nëntor.

7. **Hartimi i Strategjisë (2013-2015) dhe Planit të Punës për 2013:** është rishikuar Strategjia e NJAB-it për vitet 2013-2015 dhe e njëjta është amandamentuar për vitet 2014-2016 si dhe është përgatitur Plani Vjetor i Punës për vitin 2014, këto dokumente pritet të aprovohen ne mbledhjen e radhës së Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

8. **Zyrtari i Standardeve Profesionale (ZSP):** përgjatë periudhës raportuese Zyrtari për Standarde Profesionale ka trajtuar disa raste kryesisht te iniciuara nga Menaxhmenti dhe nga departamentet përkatëse.

9. **Trajnimi i stafit të NJAB-së:** Në këtë periudhë në Njësinë e Auditimit të Brendshëm nuk ka pasur trajnime të stafit.

XIII. STRUKTRURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT



TABELAT E PASQYRAVE FINANCIARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

GJENDJA E LLOGARIVE NE BANKEN QENDRORE TE KOSOVES

raporti nënshkruar më 28 Tetor 2013
për periudhën 30 Shtator 2013

	Tabela 1: BILANCI I LLOGARIVE NË BQK SIPAS KATEGORISË	Llogaritë Rrjedhëse 30 Shtator 2013 1	Depozitat Kohore 30 Shtator 2013 2	Totali 30 Shtator 2013 3=1+2	31 dhjetor 2012 4	31 dhjetor 2011 5	31 dhjetor 2010 6	31 dhjetor 2009 7	31 dhjetor 2008 8	Sep 2013 - 2012 9=3-4	2012 - 2011 10=3-5	2012-2010 11=3-6	2012-2009 12=3-7	2012-2008 13=3-8
		SHUMA	SHUMA	SHUMA	SHUMA	SHUMA	SHUMA	SHUMA	SHUMA	SHUMA	SHUMA	SHUMA	SHUMA	SHUMA
1	Privatizim	192,605,675.34	4,644,190.52	**197,249,865.86**	210,850,705.17	279,466,900.17	278,534,086.79	259,719,544.20	261,147,259.93	(13,600,839.31)	(82,217,034.31)	(81,284,220.93)	(62,469,678.34)	(63,897,394.07)
2	Likuidim	300,550,993.35	7,355,809.48	**307,906,802.83**	273,474,557.72	267,860,644.59	214,480,470.25	175,188,793.48	123,626,811.21	34,432,245.11	40,046,158.24	93,426,332.58	132,718,009.35	184,279,991.62
3	Para të NSH-ve në mirëbesim	6,793,205.84	-	**6,793,205.84**	5,971,317.35	5,401,324.21	5,691,148.15	3,388,895.31	5,673,506.69	821,888.49	1,391,881.63	1,102,057.69	3,404,310.53	1,119,699.15
4	Komercializim	3,667,286.74	-	**3,667,286.74**	3,667,286.74	4,115,381.37	3,520,026.07	3,567,460.47	2,940,102.90	-	(448,094.63)	147,260.67	99,826.27	727,183.84
5	Llogaritë e parave në mirëbesim për punëtorët	29,165,699.13	-	**29,165,699.13**	30,926,510.64	20,963,568.04	9,662,835.63	132,985.84	147,085.46	(1,760,811.51)	8,202,131.09	19,502,863.50	29,032,713.29	29,018,613.67
6	Depozita nga tenderët e privatizimit	804,267.28	-	**804,267.28**	1,749,268.78	2,016,346.34	3,139,226.93	3,391,090.84	4,718,572.20	(945,001.50)	(1,212,079.06)	(2,334,959.65)	(2,586,823.56)	(3,914,304.92)
7	Tarifa për Dorëzimin e Tenderit në Privatizim	188,837.45	-	**188,837.45**	49,860.35	2,231,034.05	1,892,395.85	1,428,339.45	1,080,181.15	138,977.10	(2,042,196.60)	(1,703,558.40)	(1,239,502.00)	(891,343.70)
8	Depozita nga tenderët e shitjeve me likuidim	1,309,498.32	-	**1,309,498.32**	928,662.82	1,594,671.10	1,371,067.07	638,467.79	1,378,924.40	380,835.50	(285,172.78)	(61,568.75)	671,030.53	(69,426.08)
9	Tarifa e dorëzimit të ofertave në likuidim	150,136.24	-	**150,136.24**	74,416.64	308,096.25	195,845.66	49,642.22	50,007.37	75,719.60	(157,960.01)	(45,709.42)	100,494.02	100,128.87
10	Depozitat e Komisionit të Rishikimit të Likuidimit	25.00	-	**25.00**	0.00	9,915.21	8,518.88	-		25.00	(9,890.21)	(8,493.88)	25.00	25.00
11	Kapitali themeltar i AKP-së	1,109,549.39	-	**1,109,549.39**	1,109,549.39	1,105,721.63	1,095,677.63	1,094,206.81	1,091,134.19	-	3,827.76	13,871.76	15,342.58	18,415.20
12	Fondi rezervë i AKP-së	1,203,458.58	-	**1,203,458.58**	1,009,717.58	590,787.41	2,591,944.78	2,433,523.34	1,451,203.91	193,741.00	612,671.17	(1,388,486.20)	(1,230,064.76)	(247,745.33)
13	Donator	8,463.19	-	**8,463.19**	8,463.19	8,434.70	8,358.72	8,347.44	8,329.90	-	28.49	104.47	115.75	133.29
14	Tarifa administrative e AKP-së	10,854,416.88	8,000,000.00	**18,854,416.88**	19,583,042.56	-		-	-	(728,625.68)	18,854,416.88	18,854,416.88	18,854,416.88	18,854,416.88
15	Paratë e Llogarisë Rrjedhëse në llogari për depozita kohor	0.01	-	**€ 0.01**	0.01	€ 89,844.03	€ 1,696.12	-	-	(0.00)	(89,844.01)	(1,696.11)	0.01	0.01
16	Investimet në letrat me vlerë	-	-	**0.00 €**	-	0.00 €		-	-	-	-	-	-	-
17	**GJENDJA E FONDEVE NË MIRËBESIM**	**€ 548,411,512.75**	**€ 20,000,000.00**	**€ 568,411,512.75**	**€ 549,403,358.9**	**€ 585,762,669.1**	**€ 522,193,298.5**	**€ 451,041,297.2**	**€ 403,313,119.3**	**€ 19,008,153.8**	**-€ 17,351,156.4**	**€ 46,218,214.2**	**€ 117,370,215.6**	**€ 165,098,393.4**
18	**GJITHSEJ FONDET NË MIRËBESIM (depozita kohore dhe llogaritë rrjedhëse)**	**€ 568,411,512.75**												

Avni J. Jashari, CA, CFE, IS
Drejtor i Financave dhe Buxhetit
Agjencia Kosovare e Privatizimit

28 Tetor 2013

Adem Selishta
Kryesues i Njësisë për Menaxhimin e Fondeve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

28 Tetor 2013

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE BUXHETIT

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

GJENDJA E LLOGARIVE DHE RRJEDHA E PARASË NË BANKËN QENDRORE TË KOSOVËS

raporti nënshkruar më 28 Tetor 2013
per periudhën 30 Shtator 2013

		31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2012	**31 Dhjetor 2012**	Bilanci i Rrjedhës së Parasë Jan-Shtator 2013	Bilanci i Rrjedhës së Parasë Jan-Shtator 2013	Bilanci mbyllës **30 Shtator 2013**	Bilanci mbyllës **30 Shtator 2013**	**Bilanci mbyllës 30 Shtator 2013**
		Llogaritë Rrjedhëse 1	Depozitat Kohore 2	**Depozita Rrjedhëse dhe Kohore 3=1+2**	Llogaritë Rrjedhëse 4	Depozitat Kohore 5	Llogaritë Rrjedhëse 6=1+4+5	Depozitat Kohore 7	**Depozita Rrjedhëse dhe Kohore 8=6+7**
	KATEGORIA E LLOGARIVE NË BQK	**SHUMA**	**SHUMA**	**SHUMA**	**SHUMA**	**SHUMA**	**SHUMA**	**SHUMA**	**SHUMA**
1	Privatizim	210,850,705	-	210,850,705	(13,600,839)	(4,644,191)	192,605,675	4,644,191	**197,249,866**
2	Likuidim	273,474,558	-	273,474,558	34,432,245	(7,355,809)	300,550,993	7,355,809	**307,906,803**
3	Para të NSH-ve në mirëbesim	5,971,317	-	5,971,317	821,888	-	6,793,206	-	**6,793,206**
4	Komercializim	3,667,287	-	3,667,287	-	-	3,667,287	-	**3,667,287**
5	Llogaritë e parave në mirëbesim për punëtorët	30,926,511	-	30,926,511	(1,760,812)	-	29,165,699	-	**29,165,699**
6	Depozita nga tenderët e privatizimit	1,749,269	-	1,749,269	(945,002)	-	804,267	-	**804,267**
7	Tarifa për Dorëzimin e Tenderit në Privatizim	49,860	-	49,860	138,977	-	188,837	-	**188,837**
8	Depozita nga tenderët e shitjeve me likuidim	928,663	-	928,663	380,836	-	1,309,498	-	**1,309,498**
9	Tarifa e dorëzimit të ofertave në likuidim	74,417	-	74,417	75,720	-	150,136	-	**150,136**
10	Depozitat e Komisionit të Rishikimit të Likuidimit	0	-	0	25	-	25	-	**25**
11	Kapitali themeltar i AKP-së	1,109,549	-	1,109,549	-	-	1,109,549	-	**1,109,549**
12	Fondi rezervë i AKP-së	1,009,718	-	1,009,718	193,741	-	1,203,459	-	**1,203,459**
13	Donator	8,463	-	8,463	-	-	8,463	-	**8,463**
14	Tarifa administrative e AKP-së	19,583,043	-	19,583,043	(728,626)	(8,000,000)	10,854,417	8,000,000	**18,854,417**
15	Paratë e Llogarisë Rrjedhëse në llogari për depozita kohor	0		0	-	-	0	-	**0**
16	Investimet në letrat me vlerë	-	-	-	-	-	-	-	**-**
	GJENDJA E FONDEVE NË MIRËBESIM	**€ 549,403,358.95**	**€ 0.00**	**€ 549,403,358.95**	**19,008,154**	**(20,000,000)**	**€ 548,411,512.75**	**€ 20,000,000.00**	**€ 568,411,512.75**

Avni J. Jashari, CA, CFE, IS
Drejtor i Financave dhe Buxhetit
Agjencia Kosovare e Privatizimit

28 Tetor 2013

Adem Selishta
Kryesues I Njësisë për Menaxhimin e Fondeve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

28 Tetor 2013

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E RRJEDHËS SË PARASË SIPAS LLOJIT TË LLOGARISË

1 Korrik 2003 deri 30 Shtator 2013

	hyrje	dalje	gjendja
llogarisa rrjedhëse	1,357,338,058.6	788,926,545.9	568,411,512.7
në transit	-		
depozita kohore	5,576,612,012.4	5,596,612,012.4	(20,000,000.0)
current acc interest in time deposit		-	-
totali	**6,933,950,071.0**	**6,385,538,558.2**	**548,411,512.8**

kontrolli i gabimit	0 €	0 €

		30 Shtator 2013	30 Shtator 2013	30 Shtator 2013	30 Shtator 2013	30 Shtator 2013	30 Shtator 2013	30 Shtator 2013
		1 korrik 2003	**Rrjedha e Parasë 1 korrik 2003 deri në periudhën më lart**			**Rrjedha e Parasë 1 korrik 2003 deri në periudhën më lart**		**Llogaria Rrjedhëse**
		1	Llogaria Rrjedhëse	Llogaria Rrjedhëse	Llogaria Rrjedhëse	depozita kohore	depozita kohore	depozita kohore	
	Kategoritë e Llogarive në Bankën Qendrore të Kosovës	**HAPJA E BILANCIT**	**hyrje**	**dalje**	**gjendja**	**hyrje**	**dalje**	**gjendja**	**GJENDJA NE FUND TE PERIUDHES**
1	Privatizim	-	665,574,674	468,324,808	197,249,866	547,932,924	552,577,114	(4,644,191)	192,605,675
2	Likuidim	-	377,392,443	69,485,641	307,906,803	491,602,597	498,958,407	(7,355,809)	300,550,993
3	Para të NSH-ve në mirëbesim	-	15,445,170	8,651,964	6,793,206	9,968,638	9,968,638	-	6,793,206
4	Komercializim	-	5,507,395	1,840,109	3,667,287	7,584,308	7,584,308	-	3,667,287
5	Llogaritë e parave në mirëbesim për punëtorët	-	34,006,314	4,840,615	29,165,699	29,852,713	29,852,713	-	29,165,699
6	Depozita nga tenderët e privatizimit	-	174,454,396	173,650,129	804,267	2,939,647	2,939,647	-	804,267
7	Tarifa për Dorëzimin e Tenderit në Privatizim	-	4,066,335	3,877,498	188,837	2,019,310	2,019,310	-	188,837
8	Depozita nga tenderët e shitjeve me likuidim	-	32,597,788	31,288,290	1,309,498	1,165,822	1,165,822	-	1,309,498
9	Tarifa e dorëzimit të ofertave në likuidim	-	700,959	550,823	150,136	174,857	174,857	-	150,136
10	Depozitat e Komisionit të Rishikimit të Likuidimit	-	22,979	22,954	25	1,984	1,984	-	25
11	Kapitali themeltar i AKP-së	-	1,132,178	22,629	1,109,549	2,026,809	2,026,809	-	1,109,549
12	Fondi rezervë i AKP-së	-	8,973,599	7,770,140	1,203,459	2,542,115	2,542,115	-	1,203,459
13	Donator	-	8,475	12	8,463	14,988	14,988	-	8,463
14	Tarifa administrative e AKP-së	-	37,389,269	18,534,852	18,854,417	-	8,000,000	(8,000,000)	10,854,417
15	Depozita Kohore	-	-	-	-	4,478,785,301	4,478,785,301	(0)	(0)
16	Paratë e Llogarisë Rrjedhëse në llogari për depozita kohor		66,083	66,083	0			-	0
17	Investimet në letrat me vlerë		-	-	-	-	-	-	-
	GJITHSEJ	**€ 0.00**	**€ 1,357,338,058.62**	**€ 788,926,545.88**	**€ 568,411,512.73**	**€ 5,576,612,012.38**	**€ 5,596,612,012.35**	**-€ 20,000,000.0**	**€ 548,411,512.75**

Avni J. Jashari, CA, CFE, IS
Drejtor i Financave dhe Buxhetit
Agjencia Kosovare e Privatizimit

28 Tetor 2013

Adem Selishta
Kryesues i Njësisë për Menaxhimin e Fondeve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

28 Tetor 2013

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E RRJEDHËS SË PARASË SIPAS LLOJIT TË LLOGARISË

		31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2012	Rrjedha e Parasë Janar - Shtator 2013			Rrjedha e Parasë Janar - Shtator 2013			30 Shtator 2013	30 Shtator 2013	30 Shtator 2013
		Llogaria Rrjedhëse	depozita kohore	depozita rrjedhëse dhe depozita kohore	Llogaria Rrjedhëse	Llogaria Rrjedhëse	Llogaria Rrjedhëse	depozita kohore	depozita kohore	depozita kohore	Llogaria Rrjedhëse	depozita kohore	dep.rrjedh + dep. Kohore
		1	2	3=1+2	4	5	6=4-5	7	8	9=7-8	10=1+6+9	11	12=10+11
	CATEGORY OF ACCOUNTS IN CBK	**BALANCE**	**BALANCE**	**BALANCE**	**Inflows**	**Outflows**	**Balance**	**Inflows**	**Outflows**	**Balance**	**Balance**	**Balance**	**Balance**
1	Privatizim	210,850,705		210,850,705	19,177,740	32,778,580	(13,600,839)	-	4,644,191	(4,644,191)	192,605,675	4,644,191	197,249,865.86
2	Likuidim	273,474,558		273,474,558	38,923,049	4,490,804	34,432,245	-	7,355,809	(7,355,809)	300,550,993	7,355,809	307,906,802.83
3	Para të NSH-ve në mirëbesim	5,971,317		5,971,317	978,762	156,873	821,888	-	-	-	6,793,206	-	6,793,205.84
4	Komercializim	3,667,287		3,667,287	-	-	-	-	-	-	3,667,287	-	3,667,286.74
5	Llogaritë e parave në mirëbesim për punëtorët	30,926,511		30,926,511	2,321,649	4,082,461	(1,760,812)	-	-	-	29,165,699	-	29,165,699.13
6	Depozita nga tenderët e privatizimit	1,749,269		1,749,269	4,776,500	5,721,502	(945,002)	-	-	-	804,267	-	804,267.28
7	Tarifa për Dorëzimin e Tenderit në Privatizim	49,860		49,860	138,977	0	138,977	-	-	-	188,837	-	188,837.45
8	Depozita nga tenderët e shitjeve me likuidim	928,663		928,663	2,618,300	2,237,465	380,836	-	-	-	1,309,498	-	1,309,498.32
9	Tarifa e dorëzimit të ofertave në likuidim	74,417		74,417	95,192	19,472	75,720	-	-	-	150,136	-	150,136.24
10	Depozitat e Komisionit të Rishikimit të Likuidimit	0		0	25	-	25	-	-	-	25	-	25.00
11	Kapitali themeltar i AKP-së	1,109,549		1,109,549	-	-	-	-	-	-	1,109,549	-	1,109,549.39
12	Fondi rezervë i AKP-së	1,009,718		1,009,718	203,741	10,000	193,741	-	-	-	1,203,459	-	1,203,458.58
13	Donator	8,463		8,463	-	-	-	-	-	-	8,463	-	8,463.19
14	Tarifa administrative e AKP-së	19,583,043		19,583,043	117,750	846,376	(728,626)	-	8,000,000	(8,000,000)	10,854,417	8,000,000	18,854,416.88
15	Depozita Kohore	0		0	-	-	-	20,000,000	20,000,000	-	0	-	0.01
16	Paratë e Llogarisë Rrjedhëse në llogari për depozita kohor	-		-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
17	Investimet në letrat me vlerë	-		-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
16	5.5.3	34	Kompensimet (Pagat dhe mëditjet)	**Menaxhmenti i AKP-së të sigurojë që:** • Rekrutimi i punëtoreve dhe testimi i tyre të bëhet sipas ligjit të punës me konkurs të hapur duke ju dhënë mundësi të barabartë të gjithë të interesuarve të cilët përmbushin kriteret bazë të kualifikimit.	Njësia e Burimeve Njerëzore	31 dhjetor 2013	Zbatim i vazhdueshëm
17	5.5.3	34	Kompensimet (Pagat dhe mëditjet)	**Menaxhmenti i AKP-së të sigurojë që:** • Ristrukturimi i brendshëm të bëhet vetëm pas pëlqimit të marr nga MAP; dhe • Ndryshimi i nivelit të pagave të bëhet pas aprovimit përkatës nga MAP.	Menaxhmenti i AKP-së, Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Departamenti i Financave dhe Buxhetit	31 dhjetor 2013	Zbatim i vazhdueshëm
18	5.5.3	35	Kompensimet (Pagat dhe mëditjet)	**Menaxhmenti i AKP-së të sigurojë që:** • Të gjitha pagat të jenë në harmoni me Ligjin për pagat e shërbyesve civil. • Të gjitha pagat janë të aprovuara nga MAP;	Menaxhmenti i AKP-së, Menaxhmenti i AKP-	31 dhjetor 2013 31 dhjetor	Zbatim i vazhdueshëm, Zbatim i

Rekomandimi nr.	Neni në raport	Faqe	Referencë	Rekomandimi i ZAP-së	Departamenti Përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
				dhe • Të sigurohet se të gjithë të punësuarit i kryejnë punët në përputhje me kontratën.	së, Menaxhmenti i AKP-së dhe Njësia e Burimeve Njerëzore	2013 31 dhjetor 2013	vazhdueshëm, Zbatim i vazhdueshëm
19	5.5.4	36	Subvencionet dhe transferet	**Menaxhmenti i AKP -së të sigurojë:** • Në rast të dhënies së subvencioneve, të përcaktoj qartë kriteret për përfituesit si dhe të ofroj dëshmi përkatëse për rregullsinë e shpërndarjes së këtyre subvencioneve.	Menaxhmenti i AKP-së	30 korrik 2013	**Zbatuar**
20	5.6.1	38	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	**Menaxhmenti i AKP-së të sigurojë që:** • Të sigurohet që pasuritë e vlerësuara për shlyerje të largohen nga regjistrat kontabël; dhe • Të sigurohet që regjistrimi i pasurive të regjistrohet në përputhje me rregullat në fuqi dhe që zhvlerësimi për pasuritë të llogaritet saktësisht.	Departamenti i Financave dhe Buxhetit, Departamenti i Financave dhe Buxhetit,	31 dhjetor 2013 31 dhjetor 2013	Zbatim i vazhdueshëm Zbatim i vazhdueshëm
21	6	40	Sistemi i auditimit të brendshëm	**Menaxhmenti i AKP-së të sigurojë që:** • Planet për aktivitetet e përgjithshme të auditimi të brendshëm të bazohen në vlerësimin e rrezikut dhe të rishikohen së paku një herë në vit dhe njëherit planet operative të jenë në harmoni të plotë me planet strategjike. • Planifikimi kohorë i punës së NJAB të jetë i organizuar dhe konsistent; dhe • Ndryshimet në planet për aktivitetet e përgjithshme të auditimi të brendshëm të miratohen nga Bordi i Drejtorëve/KA dhe ZKA-ja.	Njësia e Auditimit të Brendshëm, Njësia e Auditimit të Brendshëm, Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Bordi i Drejtorëve të AKP-së	31 dhjetor 2013 31 dhjetor 2013 31 dhjetor 2013	**Zbatuar** (Zbatim i vazhdueshëm) **Zbatuar** (Zbatim i vazhdueshëm) **Zbatuar** (Zbatim i vazhdueshëm)

Rekomandimi nr.	Neni në raport	Faqe	Referencë	Rekomandimi i ZAP-së	Departamenti Përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
22	6	40		**Menaxhmenti i AKP-së të sigurojë që:** • Të funksionalizohet Komiteti i Auditimit dhe të adreson detyrat me kohë tek drejtoritë përkatëse me qëllim të përmirësimit të parregullsive të identifikuara si dhe të kontribuon në qeverisjen e mire të agjencisë.	Bordi i Drejtorëve të AKP-së	30 korrik 2013	**Zbatuar**

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

SHËNIMET SHPJEGUESE

TË PASQYRAVE FINANCIARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

Për periudhën e përfunduar më 30 Shtator 2013

Shënimi 1: Përmbledhje e metodave të rëndësishme të kontabilitetit:

1.1. Baza e përgaditjes së pasqyrave financiare:

Pasqyrat Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) janë përgaditur në pajtim me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik) e bazuar në para të gatshme - Raportimi Financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Këto pasqyra financiare i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga "Rregullorja e Kornizës Raportuese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim" aprovuar nga Bordi i Drejtorëve më 23 Shkurt 2011 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare janë pjesë përbërëse për kuptimin e pasqyrave financiare dhe duhet të lexohen së bashku dhe në ndërlidhje me pasqyrat financiare.

Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme përgjatë tërë periudhës raportuese.

1.2. Subjekti Raportues:

Agjencia Kosovare e Privatizimit shte themeluar sipas ligjit nr. 03/L-067 (në fuqi më 1 Korrik 2008), i ndryshuar me ligjin nr. 04/L-034 që ka hyrë në fuqi më 21 Shtator 2011. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) si organ i pavarur publik me zotësi të plotë juridike është pasardhëse (sa i përket Ndërmarrjeve Shoqërore) e ish-Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) që ka qenë e themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12, e ndryshuar me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/18.

Periudha raportuese e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në këto pasqyra financiare është prej 1 Janar 2013 deri më 30 Shtator 2013. Në këto pasqyra financiare janë paraqitur edhe raporte që paraqesin të dhënat financiare nga data 1 Korrik 2003 deri më 30 Shtator 2013. Raportet e pasqyrave financiare janë paraqitur në Tabelën e Përmbajtjes së Pasqyrave Financiare.

Pasqyrat Financiare janë për Fondet në Mirëbesim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP). Pasqyrat Financiare paraqesin subjektin raportues ashtu siç është specifikuar ne Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe nenin 20 të Ligjit për Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit kontrollohet nga Bordi i Drejtoreve te Agjencise Kosovare të Privatizimit. Agjencia Kosovare e Privatizimit i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës në baza vjetore.

Aktivitetet e AKP-së financohen përmes tarifës administrative të Agjencisë dhe fondeve të donatorëve nëse donatorët japin donacione. AKP-ja, gjatë vitit 2011 ka transferuar 1.8 milion eur për Buxhetin e vitit 2011, më 28 maj 2012 ka transferuar 8.2 milion eur për Buxhetin e AKP-së për vitin 2012 në llogarinë e dedikuar bankare të hapur nga Departamenti i Thesarit, Ministria e Financave që mundëson financimin e aktiviteteve të AKP-së për vitin fiskal 2012 nëpërmjet të Llogarisë së Vetme të Thesarit në Ministrinë e Financave.

Më 28 Dhjetor 2012 Agjencia ka transferuar 8,048,000 eur në llogarinë e dedikuar bankare të hapur nga Departamenti i Thesarit, Ministria e Financave që mundëson financimin e aktiviteteve të AKP-së për vitin fiskal 2013 nëpërmjet të Llogarisë së Vetme të Thesarit në Ministrinë e Financave.

Pra, nga hyrja në fuqi e ligjit të ri të AKP-së, gjithsej janë transferuar 18,048,000 milion eur në llogarinë e Thesarit. Pas përfundimit të vitit fiskal 2013, Thesari duhet të kthej në llogarinë (në Thesar) e të hyrave të dedikuara të Agjencisë ato mjete të cilat nuk janë shpenzuar gjatë viteve fiskale 2011, 2012 dhe 2013. Prandaj, sa i përket vitit fiskal 2014, pas konfirmimit nga Thesari për gjendjen e llogarisë së të hyrave të dedikuara në Thesar, Agjencia do të transferoj shumën e nevojshme nga tarifa administrative që do të mbuloj buxhetin e vitit 2014.

Në pajtim me ligjin mbi themelimin e AKP-së, aktiviteti kryesor i AKP-së është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) nëpërmjet të metodave të spin of-it, likuidimit dhe qiradhënies afatgjate.

Aktivitet tjetër i AKP-së është administrimi, ristrukturimi dhe likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore.

Agjencia Kosovare e Privatizimit menaxhon Ndermarrjet Shoqerore ne Kosove dhe i mban keto Ndermarrje ne mirebesim. Si administruese e besuar, AKP eshte e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerave te NSH-ve.

Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk kontrollon subjekte tjera të cilat janë/apo mund të jenë konsoliduar në aktivitetet e tyre në këto pasqyra financiare.

1.3. Raportimi i Transaksioneve përmes Llogarive të AKP-së:

AKP-ja udhëheq dhe i kontrollon shpenzimet dhe të hyrat e fondeve në mirëbesim përmes llogarive në mirëbesim të hapura në Bankën Qendrore të Kosovës. AKP-ja bën transferin e pagesave pasi të jetë bërë autorizimi i urdhër-transfereve bankare sipas Procedurave Bankare të AKP-së.

Shënime lidhur me llojet e llogarive në mirëbesim janë shpalosur në shënimin 4a.

1.4. Valuta raportuese:

Valuta raportuese është Euro (€). Të gjitha vlerat në pasqyrat financiare janë paraqitur në vlera aktuale e jo në mijëra ('000), përveç nëse është cekur ndryshe në raportin përkatës.

1.5. Data e autorizimit të pasqyrave financiare:

Pasqyrat Financiare të fondeve në mirëbesim janë autorizuar për lëshim më datën 29 Tetor 2013 nga: Shkëlzen Lluka, Drejtor Menaxhues dhe Avni J. Jashari, Drejtor i Financave dhe Buxhetit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

1.6. Softveri që përdoret për Pasqyrat Financiare dhe Raportet Financiare:

Avni J. Jashari, Drejtor i Financave dhe Buxhetit ka dizajnuar programin në Microsoft Excel për administrimin financiar të fondeve në mirëbesim, për të përgatitur raportet financiare si dhe Pasqyrat Financiare.

Personeli i AKP-së qe punon ne kete softver është:

- Avni J. Jashari, Drejtor i Financave dhe Buxhetit: dizajnon, freskon, zgjidhë problemet e softverit, mbikqyrë harmonizimin bankar;
- Adem Selishta, Kryesues i Njësisë për Menaxhimin e Fondeve: vendos të dhënat dhe kategorizon të gjitha transakcionet, harmonizon llogaritë bankare;
- Valon Fetahu, kategorizimi I transakcioneve dhe harmonizimi I llogarive bankare
- Melita Cana, Korab Lufi dhe Nora Budima: përgatisin transferet bankare.

Ruajtja e kopjeve të të të dhënave në softver: Ruajtja e raportit financiar behet me reference të dates (p.sh. referenca “130930-raporti i llogarive në BQK” duhet të lexohet siç vijon: Raporti i llogarive në BQK për datën 30 Shtator 2013). Ruajtjet tjera bëhen ne diskun kryesor ne dy kompjuterë të ndryshëm, ne serverin e teknologjisë informative të AKP-së në rrjetin e follderit te perbashket te Raporteve Financiare. Njësia e Teknologjisë Informative bën në mënyrë automatike (ang. “shadovv copy”) kopje të përditshme të të dhënave në server në formë elektronike si dhe kopje javore në formatin e shiritave magnetik. Tre kopje në CD (Compact Disc) bëhen pas dorezimit të Pasqyrave Financiare.

1.7. Tabelat e kontrollimit automatik të gabimeve:

Janë të dizajnuara 36 tabela te cilat automatikisht kontrollojne se a gjenerohen rezultate të njejta qe merren nga pika referuese te ndryshme. Ne rast se të dhënat regjistrohen gabimisht ne softver, keto tabela automatikisht gjenerojne ndryshimin ne rezultate dhe formatizohen me ngjyre te kuqe te qelizes dhe me formatizim te nxire ("bold").

1.8. Autorizimet në llogarite bankare:

Të drejtat e nënshkrimit në llogaritë bankare të fondeve në mirëbesim janë të përcaktuara me procedurat bankare të AKP-së të aprovuara më datën 1 Shtator 2008 e të ndryshuar më 28 Shtator 2011 pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri të AKP-së.

Zyrtari Certifikues i Agjencisë nënshkruan çdo transaksion pas verifikimit dhe pasi që të jetë siguruar se transaksioni në fjalë përmban të gjitha elementet e duhura në përputhje me ligjin, politikat dhe procedurat e Agjencisë. Gjatë periudhës raportuese znj. Sahare Miftari: Certifikimi i transfereve bankare; Zyrtar Alternativ Certifikues është Valon Fetahu.

Shënim 2: Llogaritë bankare të Fondeve në Mirëbesim të AKP-së:

Te gjitha llogarite e mirebesimit mbahen si llogari bankare te veçanta (të ndara) ne Banken Qendrore te Kosoves (BQK), ndërsa në bankën Procredit mbahen të hapura llogaritë që mbajnë gjysmën e kapitalit themeltar të Ndërmarrjeve të Reja të cilat vendosen në proces të privatizimit me spin off të rregullt.

Prej Korrikut 2003 deri në periudhën raportuese janë hapur 1,635 llogari bankare që kanë të bëjnë me Ndërmarrjet Shoqërore. Prej tyre janë mbyllur 139 llogari dhe 1,496 llogari janë aktive ne BQK.

Lista e te gjitha llogarive ne mirebesim të AKP-së dhe permbledhja e llogarive te privatizimit dhe likuidimit tregohen ne tabela ndarazi (sipas renditjes së paraqitur në tabelën e përmbajtjes së raportit vjetor financiar).

Shiko specifikacionin e llogarive të AKP-së në Bankën Qëndrore të paraqitura në fund të Pasqyrave Financiare.

Marrëveshja e Mirëkuptimit (MeM) në mes të Bankës Qëndrore të Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit mbi urdhërpagesat elektronike është nënshkruar me datën 10 Dhjetor 2009. Kjo marrëveshje ka funksionuar shumë mirë prej momentit të nënshkrimit e deri në fund të periudhës raportuese. Gjatë periudhës raportuese janë kryer 1,535, ndërsa prej nënshkrimit të marrëveshjes e deri më tani janë kryer 54,859 transakcione elektronike.

Objektivë kryesore e AKP-së është automatizimi dhe elektronizimi i urdhërpagesave që kryhen përmes BQK-së, në rastet kur kemi të bëjmë me shumë transfere që duhet ekzekutuar brenda një dite.

Shënim 3: Interesi në llogaritë bankare

Interesi në llogaritë rrjedhëse

Interesi i fituar në BQK në llogaritë rrjedhëse të AKP-së paguhet në fund të çdo muaji. Normat e interesit për periudhat prej vitit 2003 e deri në periudhën raportuese janë paraqitur më poshtë:

Periudha	interesi vjetor	Agjencia
11 Korrik 2003 - 31 Dhjetor 2003	0.50%	ish-AKM
1 Janar 2004 - 31 Dhjetor 2005	1.00%	ish-AKM
1 Janar 2006 - 26 Mars 2006	1.25%	ish-AKM
27 Mars 2006 - 9 Korrik 2006	1.50%	ish-AKM
10 Korrik 2006 - 10 Shtator 2006	1.75%	ish-AKM
11 Shtator 2006 - 30 Nentor 2006	2.00%	ish-AKM
1 Nentor 2006 - 31 Janar 2007	2.25%	ish-AKM
1 Shkurt 2007 - 1 Maj 2007	2.50%	ish-AKM
2 Maj 2007 - 3 Korrik 2007	2.75%	ish-AKM
4 Korrik 2007 - 31 Dhjetor 2007	3.00%	ish-AKM
1 Janar 08 - 30 Qershor 2008	3.00%	ish-AKM
1 Korrik 2008 - 8 Gusht 2008	3.00%	AKP
9 Gusht 2008 - 17 Tetor 2008	3.25%	AKP
18 Tetor 2008 - 10 Dhjetor 2008	2.50%	AKP
11 Dhjetor 2008 - 17 Dhjetor 2008	1.75%	AKP
18 Dhjetor 2008 - 31 Dhjetor 2008	1.25%	AKP
1 janar 2009 - 22 Janar 2009	1.25%	AKP
23 janar 2009 - 19 mars 2009	0.50%	AKP
20 mars 2009 - 12 Korrik 2009	0.25%	AKP
13 Korrik 2009 - 31 Dhjetor 2009	0.10%	AKP

1 Janar 2010 - 31 Dhjetor 2010	0.10%	AKP
1 Janar 2011 - 26 Prill 2011	0.10%	AKP
27 Prill 2011 - 26 Korrik 2011	0.35%	AKP
27 Korrik 2011 – 22 Nëntor 2011	0.60%	AKP
23 Nëntor 2011 – 14 Dhjetor 2011	0.35%	AKP
15 Dhjetor 2011 – 31 Dhjetor 2011	0.10%	AKP
1 Janar - 10 Prill 2012	0.10%	AKP
11 Prill - 11 Korrik 2012	0.05%	AKP
12 Korrik – 31 Dhjetor 2012	0%	AKP
1 Janar 2013 – 30 Shtator 2013	0%	AKP

Investimet në depozitat kohore në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës:

Duke filluar nga 24 gushti i vitit 2010 Departamenti i Financave dhe Buxhetit ka bërë depozita afat shkurtra të fondeve në mirëbesim në periudha të ndryshme të maturitetit prej 1 muaj deri 12 muaj. Në pajtueshmëri me vendimin e Bordit të Drejtorëve, të gjitha transaksionet e depozitave kohor janë autorizuar së bashku nga Zëvendës Drejtori Menaxhues për Koordinimin e Likuidimit dhe Drejtori i Financave dhe Buxhetit.

Depozitat kohore janë depozituar në Bankën Qëndrore të Kosovës.

Prej 24 Gusht 2010 deri më 17 Korrik 2012 (maturimi i depozitit të fundit), Departamenti i Financave dhe Buxhetit ka investuar 44 depozita kohor në Bankën Qendrore të Kosovës, prej të cilave të gjitha kanë maturuar.

Pas datës 27 Mars 2012 (investimi për periudhën 2 muaj me datë të maturitetit 28 Maj 2012) e deri në Shtator 2013 nuk ka pasur investime në depozita kohor për shkak të normave tepër të ulëta të interesit të ofruar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, ndonjëherë edhe me normë negative të kthimit. Kjo ka ardhë si rezultat i krizës financiare botërore që ka prekur dhe tregun e parasë (investimeve afatshkurtra) të Euro Zonës. Ashtu siq tregojnë dhe të dhënat e publikuara nga Banka Qendrore Evropiane "ECB" se shkalla e kthimit të normave të interesit në tregun e parasë ka shkuar përafërsisht deri në ZERO.

Oferta e pranuar nga BQK më 20 Shtator 2013 për të bërë invesitimin e mjeteve në depozitat kohore për periudhën Gjashtë (6) mujore dhe kamata vjetore e ofruar nga BQK (pastaj zbërthehet në ditët e mbajtura në depozit kohor) është 0.12%. Data valutë e transferit 24 Shtator 2013, ndërsa data e maturimit 21 Mars 2014.

Interesi i fituar në depozitimet kohore

Interesi i fituar nga depozitimet kohore nga Gushti 2010 deri më 31 Dhjetor 2012 është 7,083,728:

Periudha	**24 Gusht 2010 - 31 Dhjetor 2012**	Jan - 31 Dhjetor 2012	viti 2011	24 Gusht 2010 - 31 Dhjetor 2010
Kamatat ne depozita	**7,083,728**	2,380,146	4,394,852	308,730

Interesi që do të fitohet nga depozitimi kohor 6 mujor i Shtatorit 2013 që maturon në Mars 2014 është €11,866.67.

Shënim 4: Sqarime lidhur me llojet e llogarive të AKP-së në BQK:

Përveç llogarisë së tarifës administrative të Agjencisë, llogarisë së donatorit, kapitalit themeltar të Agjencisë, fondit rezervë të Agjencisë, të gjitha llogaritë tjera të hapura nga Agjencia kategorizohen si llogari në mirëbesim që kanë të bëjnë me aktivitetet e Agjencisë sipas nenit 6, 8 dhe 9 të ligjit të Agjencisë.

Llogaritë e privatizimit:

Përdoren per te mbajtur paratë nga të shitjet gjatë privatizimit me metodën e spin off-it kur edhe krijohen Ndërmarrjet e Reja (Nevvco).

Llogaritë e likuidimit:

Përdoren per mbajtjen e te ardhurave nga procesi i likuidimit te NSH-ve.

Llogaritë e parave të NSH-ve në mirëbesim:

Mban parate e NSH ne mirebesim te AKP, ne rastet kur AKP vendos se NSH nuk ka kapacitete për të mbajtur këto të holla.

Llogaritë e parave të komercializimit:

Mban paratë e paguara nga qirate e komercializimit për kontratat e komercializimit te nenshkruara gjatë vitit 2000 nga UNMIK.

Llogaritë e parave të punëtorëve në llogaritë në mirëbesim (transferuar prej llog. të privatizimit dhe likuidimit):

Në rastet kur ka ankesa në listat e punëtorëve, mirëpo numri i ankesave është i ultë, AKP e bën shpërndarjen e parakohshme te 75% te 20%-it që u takon punëtorëve dhe pjesën e mbetur e parave që u takojnë punetoreve te NSH-se specifike i mban në këto llogari. Paratë në këto llogari mbahen ndaras për NSH-të në fjalë dhe mund të transferohen prej llogarise se privatizimit apo te likuidimit.

Paratë e mbetura u transferohen punetoreve kur te gjitha ankesat në listat e punetoreve shqyrtohen nga Oda e Veqante e Gjykatës Supreme te Republikës së Kosovës.

Llogaria e depozitave të privatizimit:

Perdoret per te mbajtur depozitat e paguar nga ofertuesit gjate procesit te ofertimit ne privatizim. Kjo eshte nje llogari e perkohshme nga e cila ne i kthejme depozitat ofertuesve të pasuksesshem. Pasi të nënshkruhet kontrata e shitjes, depoziti i ofertuesit te suksesshem transferohet ne llogarine e privatizimit te hapur

veçanerisht per Ndermarrjen e Re që privatizohet. Në rastet kur ofertuesit tërhiqen nga ofertat e tyre (përvec në raste të kërcënimeve), depozitat e këtyre ofertuesve transferohen në llogarinë e fondit rezervë të AKP-së.

Llogaria e tarifave për dorëzimin e ofertave në privatizim:

Përdoret për të mbajtur tarifat për dorëzimin e ofertës të pakthyeshme ndaj ofertuesve gjatë procesit të privatizimit.

Këto të holla llogariten si të ardhura vetanake të AKP.

Llogaria e depozitave të likuidimit:

Përdoret për mbajtjen e depozitave të paguara nga ofertuesit gjatë shitjeve të aseteve të NSH-ve gjatë procesit të likuidimit. Kjo është një llogari e përkohshme nga e cila i kthejmë depozitat ofertuesve të pasuksesshëm. Depoziti i ofertuesit të suksesshëm transferohet në llogarinë bankare të likuidimit e hapur për likuidimin e NSH të veçanta për të cilat ofertuesit janë deklaruar si fitues dhe kontratat e shitjes janë nënshkruar. Në rastet kur ofertuesit tërhiqen nga ofertat e tyre (përveç në raste të kërcënimeve), depozitat e këtyre ofertuesve transferohen në llogarinë e fondit rezervë të AKP-së.

Llogaria e tarifave për dorëzimin e ofertave në likuidim:

Përdoret për mbajtjen e tarifave për dorëzimin e ofertës të pakthyeshme ndaj ofertuesve gjatë procesit të likuidimit. Këto para llogariten si të ardhura vetanake për AKP.

Llogaria për dorzërimin ankesave për shqyrtim nga Komisioni i Shqyrtimit për likuidim:

Mban depozitat e paguar nga kreditorët për shqyrtimin e ankesave që kreditorët i deponojnë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave në procesin e likuidimit.

Llogaria e kapitalit themeltar të AKP-së:

Mbahet kapitali themeltar i AKP-së. Ky kapital është paguar nga Buxheti i Republikës së Kosovës (BRK).

Aktualisht vetëm 1 milion EUR është paguar nga BKK gjatë mandatit të ish-Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Shuma prej 9 milion EUR sipas ligjit mbi AKP-në do të paguhet sipas nevojës dhe kërkesës së AKP-së.

Llogaria e fondit rezervë të AKP-së:

Perdoret per te mbajur depozitet e konfiskuar nga ofertuesit gjate procesit te ofertimit ne privatizim dhe shitjeve gjate likuidimit. Në këtë llogari barten të hyrat vetanake nga:

- Tarifa e dorëzimit të ofertave në privatizim

- Tarifa e dorëzimit të ofertave në shitjet gjatë likuidimit
- Depozitat e konfiskuar ndaj ofertuesve që janë tërhequr nga procesi i ofertimit
- Tarifa e dorëzimit të ofertave në komercializim
- Interesi i fituar në llogarinë e depozitave të privatizimit; dhe
- Interesi i fituar në llogarinë e depozitave të likuidimit.

Llogaria e tarifës administrative të AKP-së:

Në këtë llogari transferohet tarifa administrative e Agjencisë sipas ligjit për themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Në Korrik 2012, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pranuar një garancion bankar lidhur me performancën e kontratës nga Deloitte Central Europe Limited për Ofrimin e Shërbimeve Profesionale për likuidimin e portfolios së NSH-ve (nr. i prokurimit 239-11-068-211). Detajet e garancionit bankar janë si vijon: data e garancionit 9 Korrik 2012, shuma e garancionit €1,992,000, garancioni i vlefshëm deri më 10 Shtator 2016, emri i bankës që ka lëshuar garancionin: ING Bank N.V. PO BOx 350, 1000 Amsterdam, The Netherlands.

Llogaria e parave të donatorit:

Mban paratë e donatorit në raste kur paratë kanalizohen ndërmjet llogarive të AKP-së. Aktualisht është vetëm një llogari bankare që mban të hollat për një projekt të realizuar vite më parë nga ish-AKM-ja. AKP është në proces të identifikimit të raporteve narative dhe kontratës së donatorit që ish-AKM ka pasur me donatorët për këtë projekt.

Llogaritë e depozitimeve kohore:

Mban paratë që AKP transferon nga llogaritë individuale në llogaritë për depozitim kohor. Prej këtyre llogarive bankare, pas autorizimeve me shkrim nga AKP, Banka Qendrore e Kosovës i transferon paratë në depozitime kohore për periudhat e caktuara të maturitetit.

Shënim 5: Shpjegim për llojet e llogarive të AKP në Procredit Bank dhe Raiffeisen Bank:

Llogaritë PAK SOE:

Mban paratë e NSH-ve në mirëbesim të AKP në rastet kur AKP përcakton se një NSH nuk ka kapacitetet për të operuar me këto mjete.

Llogaritë e Ndërmarrjeve të Reja (llogaria që mban gjysmën e kapitalit themeltar):

Llogaria që mban gjysmën e kapitalit të aksionarit (EUR 1,250 apo 1,000 varet prej periudhës kur janë regjistruar Ndërmarrjet) të Ndërmarrjes së Re gjatë procesit të privatizimit. Deri në përfundim të shitjes, aksionar është AKP-ja. Në momentin e përfundimit të shitjes dhe nënshkrimit të kontratës, AKP i bartë aksionet te blerësi i Neëco-s. Pastaj, AKP i shkruan bankës dhe e bën transferimin e së drejtës së nënshkrimit

në llogarinë bankare përkatëse. Prej valës 53 sipas ligjit të ri për shoqëritë tregtare nuk kërkohet pagesa e kapitalit themeltar.

Deri në fund të periudhës raportuese, AKP ka edhe 58 llogari të hapura të Ndërmarrjeve të Reja (Nevvco) të cilat ende priten të transferohen të blerësit pas nënshkrimit të kontratave të shitjes.

Llogaria e likuidimit për para të imta:

Mban mbetjen e parave të imta për qëllime të likuidimit (shërbime postare, fotokopjime etj.) në kohën kur këto shërbime janë paguar përmes bankës Procredit. Gjatë vitit 2013, mbetja në këtë llogari do të transferohet në BKK dhe llogaria do të mbyllet.

Llogaritë në Procredit Bank (PCB) më 30 Shtator 2013:

PËRMBLEDHJE E LLOGARIVE NË PCB	**VLERA**
PAK SOE	294.00
Llogaritë e Ndërmarrjeve të Reja (llogaritë ende pa e transferuar te pronari)	62,254.00
Liquidation	1.70
GJITHSEJ	**62,549.70**

Shiko specifikacionin e llogarive të AKP-së në Procredit Bank të paraqitura në fund të Pasqyrave Financiare.

Llogaritë në Raiffeisen Bank më 30 Shtator 2013:

PËRMBLEDHJE E LLOGARIVE NË Raiffeisen Bank	**VLERA**
Llogaritë e Ndërmarrjeve të Reja (llogaritë ende pa e transferuar te pronari)	2,495
GJITHSEJ	**2,495.00**

Shënimi 6: Pasqyra e faturave (detyrimeve) të papaguara të AKP-së:

Janë paraqitur në Pasqyrën e Detyrimeve e që është pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Shënimi 7: Detyrimet kontingjente

Detyrimet kontigjente që mund të ndikojnë në fondet në mirëbesim të AKP-së janë shpalosur në tabelën e detyrimeve kontigjente si pjesë e këtyre pasqyrave financiare.

Shënimi 8: Të ardhurat e arkëtueshme:

Janë raportuar si pjesë integrale e pasqyrave financiare.

Shënimi 9: Transakcionet e paekzekutuara nga BQK lidhur me depozitimet kohore:

Gjatë periudhës raportuese, nuk ka transakcione të cilat AKP ka dorëzuar në BQK e të cilat nuk janë ekzekutuar lidhur me depozitimet kohore.

Shënimi 10: Kthimi i mjeteve në Buxhetin e Kosovës për shpenzimet në emër të llogarive të likuidimit:

Faza e likuidimit: Është periudha pas fillimit të procesit të likuidimit të NSH-ve.

Pagesa e shpenzimeve të likuidimit nga Buxheti i Kosovës dhe kthimi përkatës në Buxhetin e Kosovës (nga llogaritë e likuidimit) bëhet duhet u bazuar në procedurën e datës 20 Nëntor 2007 për dhënien avans të fondeve të Buxhetit të Kosovës për NSH-të në likuidim si dhe në rezolutën e Bordit të Drejtorëve të ish-Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të datës 9 Prill 2008 e azhurnuar nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në Qershor 2012 për kthimin e këtyre mjeteve në Buxhetin e Kosovës respektivisht në tarifën administrative të Agjencisë pas realizimit të të hyrave nga procesi i privatizimit/likuidimit.

Sipas rezolutës në fjalë, financimi i kostove të likuidimit (nenet 40.1.1.1 dhe 40.1.1.3 të Shtojcës së Ligjit të Agjencisë) bëhet si në vijim:

a) Tarifa fikse e Autoritetit të Likuidimit paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin e caktimit të saktë të kostos fikse proporcionalisht për secilën ndërmarrje shoqërore në likuidim, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompenzohet nga llogaria banker e ndërmarrjes në likuidim;

b) Tarifa variabile (për kërkesat e shqyrtuara) e Autoritetit të Likuidimit dhe kostot tjera të paraqitura në kostot 1.1 dhe 1.3 të nenit 40.1 të shtojcës së ligjit nr. 04/L-034 paguhen nga fondet e ndërmarrjes në likuidim. Në rast se ende nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të likuidimit, atëherë tarifa variabile paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin që do të ketë fonde të mjaftueshme në llogarinë e likuidimit, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompenzohet nga llogaria e ndërmarrjes në likuidim;

Gjatë periudhës raportuese, me rastin e procesit të rishikimit gjysmëvjetor të buxhetit vjetor të Agjencisë për vitin fiskal 2013, Bordi i Drejtorëve ka marrë vendim që buxheti i likuidimit prej €269,360 (nga buxheti vjetor i Agjencisë) i paraparë për shpenzime të likuidimit do të financohen nga fondet në mirëbesim të likuidimit sipas rezolutës së Bordit të Drejtorëve të datës 21 Qershor 2012.

Gjatë vitit fiskal 2013 do të kthehen në Buxhetin e Kosovës ose tarifën administrative respektivisht €24,897.86 varësisht në cilin vit kanë ndodhur shpenzimet si dhe €73,924.21 të cilat do të kthehen nga llogaritë e 155 NSH-ve në likuidim për shpenzimet të cilat gjatë vitit 2013 janë ekzekutuar nga tarifa administrative e Agjencisë në përputhje me rezolutën e Bordit të Drejtorëve të Qershorit 2012. Shpenzimet prej €73,924.21

janë paguar nga tarifa administrative për shkak se fatura e furnitorit për shpallje ka përfshirë më shumë se një NSH dhe rrjedhimisht fatura nuk ka mundur të ndahet.

Shënimi 12: Regjistrimi i avanseve të parave të imta nga llogaritë e likuidimit dhe llogaria e tarifës administrative:

Gjatë periudhës raportuese janë dhënë para të imta në formë të avansit për secilën nga zyret rajonale të Agjencisë. Paratë e imta janë paguar nga llogaria e tarifës së likuidimit dhe pëdoren për të mbuluar shpenzimet e imta gjatë procesit të likuidimit deri në shumën prej 200 EUR ashtu sic përcaktohet me udhëzimin për procedurat e prokurimit me fondet e likuidimit. Kur të shpenzohet një avans I parasë së imtë gjatë mbylljes së avansit, atëherë shpenzimet përkatëse u atribuohen llogarive përkatëse të likuidimit dhe në anën tjetër kompenzohet llogaria e tarifës së likuidimit.

Deri në fund të periudhës raportuese janë në avans para të imta shumat për pesë zyret rajonale: ZR Prishtina EUR 3,000; ZR Mitrovica EUR 2,000; ZR Prizren EUR 2,000; ZR Peja EUR 2,000 dhe ZR Gjilan EUR 3,000. Gjithsej shuma e dhënë në avans për të pesë zyret rajonale është: EUR 12,000. Avanset e pranuara gjatë vitit 2013 nga Zyret Regjionale do të mbyllen në fund të vitit 2013 dhe paratë do të kthehen nga llogaritë përkatëse të likuidimit në llogarinë e tarifës së regjistrimit për likuidim.

Llogaria e tarifës së likuidimit	
	Shuma
Gjendja fillestare 1 Janar 2013	**-**
Pranimet e avanseve	12,000.00
Shpenzimet	0
Kthimet e mjeteve ne llogari	0
Gjendja në fund të periudhës raportuese	**12,000.00**

Prej datës 30 Shtator e deri më 28 Tetor 2013 janë marrë avans edhe €4,500 nga llogaria e tarifës së likuidimit, ndërsa janë raportuar si shpenzime shuma prej €6,233.69, duke pasur gjendjen e parasë avans në €10,266.31.

Shënimi 13: Plani kontabël i fondeve në mirëbesim:

Është paraqitur si pjesë e pasqyrave financiare.

FUND I SHËNIMEVE SHPJEGUESE.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

- Duke u bazuar në nenin 15.2.a dhe nenin 23 të Ligjit nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit; dhe
- Me qëllim të zbatimit të rekomandimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës të paraqitur në raportin final të datës 1 Korrik 2010 lidhur me kornizën rregullative raportuese të pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim:

Bordi i Drejtorëve të AKP-së, më 23 Shkurt 2011 nxjerr këtë:

RREGULLORE PËR KORNIZËN RAPORTUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton mënyrën e raportimit, detyrimet për raportimin dhe prezentimin e pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim për çdo vit fiskal.

Neni 2
Regjistrat Kontabël të Fondeve në Mirëbesim

1. Drejtori i Financave dhe Buxhetit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit do të regjistroj të gjitha transaksionet dhe do të mbaj regjistrat kontabël në përputhje me këtë Rregullore.
2. Regjistrimi i transakcioneve do të bëhet duke u bazuar në planin kontabël të fondeve në mirëbesim që është përgatitur nga Departamenti i Financave dhe Buxhetit. Drejtori i Financave dhe Buxhetit do të azhuroj planin kontabël varësisht prej llojit të transakcioneve.
3. Drejtori Menaxhues AKP dhe Drejtori i Financave dhe Buxhetit AKP tridhjetëenjë (31) ditë pas mbylljes së çdo viti fiskal:
   3.1. Do të nënshkruajnë një deklaratë me shkrim se pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim për vitin fiskal në fjalë, janë një pasqyrim i vërtetë dhe i drejtë i financave dhe transaksioneve financiare të fondeve në mirëbesim për vitin përkatës fiskal; dhe
   3.2. Do të mbyllin Pasqyrat Financiare të Fondeve në Mirëbesim për vitin përkatës fiskal.
4. Dokumentet në pikën 3.1 dhe 3.2 do t'i dorëzohen Bordit të Drejtorëve me rastin e përkthimit të pasqyrave financiare në gjuhët zyrtare.
5. Një kopje e pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim do t'i dorëzohet Drejtorit të

Përgjithshëm të Thesarit MEF dhe këtyre institucioneve: Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ministrit për Ekonomi dhe Financa, Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Drejtorit të Buxhetit Qendror të Kosovës.

6. Një kopje e pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim do t'i dorëzohet edhe Zëvendës Drejtorëve Menaxhues të AKP-së, Departamentit të Likuidimit, Departamentit të Shitjes, Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe Arkivës së AKP-së.
7. Kopja origjinale e pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim do të mbahet në Departamentin e Financave dhe Buxhetit të AKP-së.

Neni 3
Politikat Kontabël - Kontabiliteti sipas Parasë së Gatshme

1. Pasqyrat Financiare të fondeve në mirëbesim duhet të përgatiten sipas kërkesave në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik për raportimin financiar të bazuar në para të gatshme "SNKSP" – ang. "IPSAS".
2. Politikat kryesore kontabël për përgatitjen e pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim janë:
   2.1. pranimet (të hyrat) njihen atëherë kur janë nën kontroll të AKP-së. Kjo do të thotë paratë të cilat janë transferuar në llogari të AKP-së në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), paratë të cilat janë transferuar në llogaritë e AKP-së në bankat komerciale, paratë që qëndrojnë në llogari nëpër banka komerciale në pritje për t'u transferuar në llogarinë e AKP-së në BQK dhe paratë e grumbulluara nga zyrtarët e AKP-së në pritje për tu transferuar në llogaritë e AKP-së në BQK;
   2.2. pagesat (shpenzimet) njihen atëherë kur ato paguhen nga llogaritë e AKP-së;
   2.3. shpenzimet e parave të imëta dhe avanseve njihen në momentin e arsyetimit të llogarisë së parave të imëta dhe udhëtimit zyrtar.
3. Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit për Sektorin Publik të bazuar në para të gatshme "SNKSP" thekson:
   3.1. kontabiliteti i parave të gatshme i njeh transaksionet dhe ngjarjet vetëm kur entiteti pranon apo paguan para (apo ekuivalentë të parasë).
   3.2. Raportet financiare që përgatiten në bazë të këtij standardi u sigurojnë shfrytëzuesve informata mbi burimet e parave të gatshme të krijuara gjatë periudhës vijuese dhe qëllimin për të cilën është përdorë paraja e gatshme.
   3.3. Shpalosjet e pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim duhet të përfshij edhe: detyrimet e papaguara, të arkëtueshmet dhe detyrimet kontigjente.

Neni 4
Raportimi i Transaksioneve përmes Llogarive të AKP-së

1. AKP-ja udhëheq dhe menaxhon shpenzimet dhe të hyrat e fondeve në mirëbesim përmes llogarive në mirëbesim të hapura në Bankën Qendrore të Kosovës. AKP-ja bën transferin e pagesave pasi të jetë bërë autorizimi i urdhër-transfereve bankare sipas Procedurave Bankare të AKP-së.

Neni 5
Struktura e Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim

Pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim duhet të strukturohen si më poshtë:

1. Faqja e parë;
2. Tabela e përmbajtjes;
3. Deklarata e Drejtorit Menaxhues dhe Drejtorit të Financave dhe Buxhetit
4. Gjendja e llogarive bankare në BQK sipas llojit të fondeve në mirëbesim dhe sipas klasifikimit se a janë llogari rrjedhëse apo depozita me afat;
5. Përmbledhja e të hyrave dhe daljeve nga llogaritë e privatizimit (raporti gjeneruar sipas llojit të "spin offit");
6. Përmbledhja e të hyrave dhe daljeve nga llogaritë e privatizimit (raporti gjeneruar sipas numrit të valës dhe kontratave të nënshkruara dhe kontratave në pritje);
7. Përmbledhja e pagesave për 20%-in e punëtorëve nga fondet e privatizimit dhe likuidimit;
8. Të dhënat e fondeve për raportin MIS;
9. Numri i llogarive aktive dhe të mbyllura sipas llojit të llogarisë në mirëbesim;
10. Interesi i akumuluar/paguar nga BQK sipas llojit të llogarisë në mirëbesim;
11. Përmbledhja kryesore e të hyrave/pranimeve dhe daljeve/shpërndarjeve në likuidim (për të gjitha Ndërmarrjet në likuidim);
12. Raporti sipas kodeve detaje të të hyrave/pranimeve dhe të daljeve/shpërndarjeve në likuidim (për të gjitha Ndërmarrjet në likuidim);
13. Raporti MIS – Menaxhimi i Informatave për Menaxhmentin për vitin aktual dhe krahasimet me periudhat paraprake;
14. Raporti i depozitimeve kohore në baza akruale (raporti gjeneruar sipas interesit që është paguar gjatë vitit aktual dhe interesit që do të paguhet gjatë vitit të ardhshëm fiskal - për shkak se disa depozita mund të maturojnë në vitin e ardhshëm fiskal);
15. Raporti i depozitimeve kohore sipas kontabilitetit në baza të parasë së gatshme (raporti gjeneruar sipas interesit që është paguar dhe interesit që është fituar por që do të paguhet pas maturitetit – për shkak se disa depozita mund të maturojnë në vitin e ardhshëm fiskal);
16. Raporti i depozitimeve kohore sipas kategorisë dhe maturitetit;
17. Analiza e të hyrave të privatizimit sipas valëve dhe sipas statusit të kontratës (të nënshkruar dhe në pritje);
18. Analiza e të hyrave të privatizimit sipas valëve dhe "spin off-it" të rregullt;
19. Analiza e të hyrave të privatizimit sipas valëve dhe "spin off-it" special;
20. Pasqyra përmbledhëse e Rrjedhës së Parasë së Gatshme sipas kategorisë së llogarive dhe kodeve të planit kontabël për periudhën 2003 deri në vitin aktual;
21. Detajet e Rrjedhës së Parasë së Gatshme sipas kategorisë së llogarive dhe kodeve të planit kontabël për periudhën 2003 deri në vitin aktual;
22. Pasqyra përmbledhëse e Rrjedhës së Parasë së Gatshme sipas kategorisë së llogarive dhe kodeve të planit kontabël për vitin aktual;
23. Detajet e Rrjedhës së Parasë së Gatshme sipas kategorisë së llogarive dhe kodeve të planit kontabël për vitin aktual;
24. Pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim për të gjitha (momentalisht 14) llojet e llogarive – raporti për periudhën 2003 deri në vitin aktual;

25. Pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim për të gjitha (momentalisht 14) llojet e llogarive – raporti për vitin aktual;
26. Numri i transakcioneve për periudhën 2003 deri në vitin aktual;
27. Numri i transakcioneve për vitin aktual;
28. Raporti i detyrimeve;
29. Raporti i detyrimeve kontigjente;
30. Raporti i të Ardhurave të Arkëtueshme;
31. Plani kontabël i fondeve në mirëbesim;
32. Gjendja e secilës llogari bankare të AKP-së pas harmonizimit me shënimet e BQK-së;
33. Lista e llogarive të AKP-së në bankat komerciale (p.sh. llogaritë e Ndërmarrjeve të Reja);
34. Raporti mbi veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të raportit të fundit të Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës; dhe
35. Shënimet Shpjeguese.

Format e raporteve përbërëse të pasqyrave financiare janë të paraqitura në shtojcë.

Neni 6
Raportet Plotësuese

Drejtori i Financave dhe Buxhetit mund të paraqet edhe raporte tjera plotësuese varësisht sipas nevojës raportuese.

Neni 7
Faqja e Parë e Raportit Vjetor

Faqja e parë duhet të përmbaj:
1. logon e Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
2. emrin e Agjencisë;
3. titullin e dokumentit;
4. periudhën raportuese; dhe
5. datën e nënshkrimit të deklaratës së pasqyrave financiare.

Neni 8
Deklarata për Prezantimin e Pasqyrave Financiare të fondeve në mirëbesim

Bazuar në këtë Rregullore dhe në përputhje me "praktikat më të mira", nga Agjencia Kosovare e Privatizimit kërkohet konfirmim me shkrim se deklaratat financiare të AKP-së për vitin fiskal, janë pasqyrim i vërtetë dhe i drejtë i transaksioneve financiare të AKP-së për vitin përkatës fiskal lidhur me fondet në mirëbesim.

Deklaratën në emër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit e nënshkruajnë kolektivisht Drejtori Menaxhues AKP dhe Drejtori i Financave dhe Buxhetit AKP.

Forma e deklaratës do të jetë e ngjashme me deklaratën që nënshkruhet për pasqyrat financiare të Buxhetit të Kosovës.

Neni 9
Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare të fondeve në mirëbesim

1. Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare duhet të paraqiten:
   1.1. informata të përgjithshme për AKP-në (veprimtaria, legjislacioni që e rregullon aktivitetin e saj, etj),
   1.2. baza e përgaditjes së pasqyrave financiare:
   1.3. përmbledhja e politikave të rëndësishme të kontabilitetit,
   1.4. shpalosja e shënimeve lidhur me llojet e llogarive bankare në mirëbesim,
   1.5. detyrimet
   1.6. avanset e paarsyetuara,
   1.7. të ardhurat e arkëtueshme,
   1.8. detyrimet kontingjente,
   1.9. raport mbi veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.
2. Aty ku është e mundshme, shënimet e Pasqyrave Financiare duhet të jenë të krahasueshme me vitin paraprak.
3. Në raste kur ka ndryshime të politikave organizative dhe të kontabilitetit, shënimet duhet të shpalosen dhe të komentohen në mënyrë të veçantë.

Neni 10
Raporti i Veprimeve të Ndërmarra për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës

Sipas nenit 44.4, pika (c) të LMFPP, Organizatat Buxhetore duhet të shpalosin veprimet e ndërmarra ose ato që do të ndërmerren për zbatimin e rekomandimeve të përfshira në raportin e fundit të auditimit për vitin paraprak.

Neni 11
Pasqyrat Financiare të Audituara

Nëse pas pranimit të raportit të Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, nevojiten korigjime të pasqyrave financiare, atëherë Drejtori Menaxhues dhe Drejtori i Financave dhe Buxhetit duhet t'i dorëzojnë Bordit të Drejtorëve të AKP-së pasqyrat financiare të audituara në afatin prej 30 ditëve pas korigjimit të pasqyrave financiare.

Neni 12
Masat për mosrespektim të kësaj Rregulloreje

Agjencia Kosovare e Privatizimit duhet të respektoj afatet e dorëzimit të pasqyrave financiare, në pajtim me këtë Rregullore, në të kundërtën do të zbatohen masat disiplinore ndaj atyre zyrtarëve të AKP-së shkaku i të cilëve nuk dorëzohen me kohë pasqyrat financiare.

Neni 13
Ruajtja e Pasqyrave Financiare

1. Pasqyrat financare të fondeve në mirëbesim duhet:
   1.1. të dorëzohen në formë të shkruar;
   1.2. të shtypen në formë të libërlidhjes;
   1.3. të mbahen në formë elektronike në CD të ruajtura në zyren e Drejtorit Menaxhues, Departamentin e Financave dhe Buxhetit
   1.4. të ruhen edhe në formatin "pdf" me përmbajtjen e njëjtë si në të shtypur dhe të dorëzohen në Arkivën e AKP-së në CD format.
2. Në rast të mospërputhjes në mes të ndonjë kopje të pasqyrave financiare dhe kopjes origjinale të mbajtur në Departamentin e Financave dhe Buxhetit, mbizotëron kopja origjinale e mbajtur në Departamentin e Financave dhe Buxhetit.

Neni 14
Nënshkrimi i Deklaratës dhe raporteve përbërëse të pasqyrave financiare

1. Deklaratën e prezentimit të pasqyrave financiare e nënshkruajnë kolektivisht Drejtori Menaxhues dhe Drejtori i Financave dhe Buxhetit. Me këtë nënshkrim, përveç deklarimit në përmbajtjen e deklaratës, vërtetojnë se i kanë lexuar, kuptuar qartë dhe mbështesin të gjitha raportet përbërëse të pasqyrave financiare si dhe shënimet shpjeguese.
2. Raportet përbërëse të pasqyrave financiare të cekura në këtë Rregullore nënshkruhen apo inicializohen sipas rastit nga Drejtori i Financave dhe Buxhetit dhe Zyrtari i Lart Financiar.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Bordit të Drejtorëvë të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Bordi i Drejtorëve

Dino Asanaj
Kryetar

FUNDI I PASQYRAVE FINANCIARE.